VOLFGANG LIBAL (WOLFGANG LIBAL)

KRISTIN FON KOL (CHRISTINE VON KOHL)

BALLKANI FAKTOR QËNDRUESHMËRIE APO PËSHTJELLIMI NË EVROPË

Ballkani faktor qëndrueshmërie apo pështjellimi në Evropë

Përmbajtja:

Hyrje
Fundi i komunizmit - ndikimet e kësaj dukurie mbi Ballkanin
Të drejtat e njeriut - një kapitull plot keqkuptime
Sulmet e Nato-s kundër Jugosllavisë së cunguar
Pakti i Qëndrueshmërisë (Stabilitetit)
Etapat e "idesë së madhe"
Programi
Siguria
SI E SHEH PERËNDIMI BALLKANIN
Si e shohin vetveten popujt e Ballkanit
MBAS DY LUFTËRAVE BOTËRORE:
PROBLEMI KYÇ SERBIA
Republika Federale e Jugosllavisë - arrogancë dhe mashtrim
Marrëdhëniet ndërmjet republikave
Marrëdhëniet midis Serbisë dhe Malit të Zi - guri i provës
Mali i Zi
Pafuqishmëria e opozitës serbe
SHTETET E "BALLKANIT PERËNDIMOR"
Kroacia - në rrugën drejt Evropës
Bosnje-Hercegovina - fli dhe e flijuar
Maqedonia - shtet mbi një kreshtë të ngushtë
Shqipëria - rrëmujë dhe shpresë
Kosova - nga qëndresa pasive tek ajo aktive
SA ËSHTË "PJEKUR PËR EVROPËN" "BALLKANI LINDOR"?
Rumania e dyzuar - ndërmjet Evropës Qëndrore dhe Detit të Zi
Bullgaria e zellshme - midis shpresës për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe nostalgjisë
VËSHTRIM PERSPEKTIV: QËNDRUESHMËRI - PREMTIM APO ILUZION?

Hyrje

Nuk ka dyshim se në Perëndim të gjithë janë të një mendimi mbi domosdoshmërinë e "evropianizimit" të vendeve të Ballkanit dhe kryesisht të shteteve të pavarura në territorin e Jugosllavisë së dikurshme. Mirëpo, ç'kuptohet me "evropianizim"? A bëhet fjalë në këtë rast thjesht për pranimin formal të këtyre vendeve në Bashkimin Evropian (BE)?

Dy vende ballkanike, Rumania dhe Bullgaria, janë pranuar tashma në grupin e dytë të shteteve, me të cilat është paraparë fillimi i bashkëbisedimeve për përfshirjen e tyre në BE. Ky zgjerim megjithatë është i kushtëzuar nga kushte të rrepta paraprake të karakterit demokratiko-politik, të shtetit të së drejtës dhe të ekonomisë së tregut, të cilat këto vende nuk i përmbushin ende. Pra, deri në anëtarësimin e tyre në BE do të kalojë një kohë e gjatë.

Çfarë po ndodh ndërkohë me shtetet e dala nga Jugosllavia e dikurshme, dmth me Kroacinë, Bosnje-Hercegovinën, Republikën Federale të Jugosllavisë (Serbinë dhe Malin e Zi) dhe Maqedoninë? Po me Kosovën, statusi i ardhshëm i së cilës vazhdon të jetë ende krejtësisht i papërcaktuar? Po së fundi me Shqipërinë, qëndrueshmëria e brendshme e së cilës kurrsesi nuk mund të cilësohet ende e mirëqenë.

Të gjitha këto vende duhet të vendosen fillimisht mbi një bazë solide nëpërmjet "Paktit të Qëndrueshmërisë (Stabilitetit) për Evropën Juglindore". Kjo nënkupton kryerjen e një punë të pashembullt Sizifi, mbasi në fakt Ballkani në fillim të mijëvjeçarit të tretë ndodhet në një gjendje, të cilën përsa u përket përmasave rrënimtare nuk e ka përjetuar asnjëherë gjatë gjithë historisë së tij. Kurrë ndonjëherë popujt e tij nuk e kanë luftuar njeri-tjetrin me një urrejtje dhe me një tërbim të tillë shkatërrimtar, siç ndodhi gjatë luftërave ndërjugosllave. Në këtë rast nuk bëhej fjalë për nënshtrimin e "armikut", me të cilin ata gjithsesi kishin jetuar bashkërisht për shekuj me radhë, por për dëbimin prej trevave të ngulimeve të tij të trashëguara dhe asgjësimin e tij, për shkatërrimin e rrënjëve të tij historike dhe kulturore.

Një dukuri e tillë nuk kishte ndodhur asnjëherë në Evropën Juglindore, as gjatë pushtimit romak dhe bizantin, as në periudhën e shteteve feudale bullgare dhe serbe të mesjetës, as gjatë sundimit 500 vjeçar osman dhe as atëhere kur Fuqitë e Mëdha evropiane siguruan sferat e tyre të ndikimit në gadishullin ballkanik.

Suksesi i Paktit të Qëndrueshmërisë (Stabilitetit), dmth fakti nëse mbi bazën e tij mund të ndërtohet një rend i qëndrueshëm, do të varet, nga njëra anë, prej

mënyrës sesi do t'a administrojë Perëndimi këtë instrument, por, në anën tjetër, edhe nga fakti nëse këta popuj, në kushtet e rrënimeve të shkaktuara nga luftërat ndërjugosllave dhe krijimit të shteteve të pavarura e përkatësisht, në rastin e serbëve, në kushtet e disfatave të pësuara, do të jenë në gjendje të gjejnë veten dhe të arrijnë të krijojnë një shëmbëlltyrë të re. Po ashtu do të varet edhe nga krijimi i marrëdhënieve të reja midis njëri-tjetrit.

Kroacia duhet t'a begatojë pavarësinë e fituar rishtas mbas 900 vjetësh fillimisht edhe me një përmbajtje të re shpirtërore dhe politiko-shtetërore.

Bosnje-Hercegovina duhet të vendosë, nëse marrëveshja e Dejtonit mund të përbëjë një bazë të mirëfilltë për të ardhmen e vendit apo nëse duhet ecur në drejtimin e rishqyrtimit të saj.

Republika Federale e Jugosllavisë mund të vazhdojë të ekzistojë si e tillë, vetëm në qoftë se marrëdhëniet midis dy pjesëve të saj do të ndërtohen mbi një bazë të re. Të mos harrojmë gjithashtu diçka tjetër akoma më të rëndësishme: Serbia, shteti më i fuqishëm në territorin e Jugosllavisë së dikurshme, si pasojë e politikës agresive serbomadhe të Sllobodan Millosheviçit ka pësuar katastrofën më të madhe të historisë së saj. Në këto rrethana Serbia duhet të gjejë një përkufizim të ri për pozicionin e saj në radhët e shteteve të dala nga Jugosllavia e dikurshme.

Në Kosovë shtrohet pyetja: pushtim apo çlirim, protektorat i përkohshëm në kuadrin e Republikës Federale të Jugosllavisë apo pushtim dhe administrim ndërkombëtar në rrugën drejt pavarësisë shtetërore të kësaj province të banuar në një masë më të madhe se 90 për qind prej shqiptarëve.

Maqedonia, i vetmi prej shteteve të Jugosllavisë së dikurshme, që nuk është krijuar si pasojë e luftrave ndërjugosllave, nuk është aq e qëndrueshme, siç shëmbëllen nga njëherë. Nga njëra anë, grupi etnik shqiptar, i cili përbën të paktën 25 përqind të popullësisë së saj, kërkon njohjen e pozitës së popullit të dytë shtetformues, ndërsa, në anën tjetër, vetë maqedonasit siç duket nuk e kanë gjetur ende rrugën e tyre midis Serbisë, Bullgarisë dhe Greqisë.

Së fundi, Shqipëria ka nevojë për struktura shtetërore, të cilat do të jenë në gjendje të sigurojnë interesat e gjithë vendit, pavarësisht nga dy partitë e mëdha që luftojnë njera-tjetrën dhe klanet e ndryshme.

Pra, në rastin e Paktit të Qëndrueshmërisë (Stabilitetit) nuk bëhet fjalë vetëm për ndihma ekonomike dhe përkrahje në drejtim të ndërtimit të strukturave të reja ekonomike dhe rrjedhimisht për krijimin e kushteve paraprake materiale për udhën, të cilën duhet të ndjekin shtetet e dala nga Jugosllavia e dikurshme dhe fqinjët e tyre, për të shkuar drejt Evropës. Këtu kemi të bëjmë gjithashtu edhe me një orientim të ri shpirtëror-politik, të cilin këto vende duhet t'a gjejnë kryesisht vetë, por për të cilin edhe Evropa mund të japë ndihmesën e saj, me kusht që t'u përshtatet mentaliteteve të ndryshme të njerëzve dhe të mos përpiqet t'i qethë të gjithë me një gërshërë e të bëjë vlerësimin e tyre sipas kallëpeve evropiane.

Të gjitha këto probleme dëshirojmë t'i shtjellojmë në këtë libër. Duke patur parasysh rëndësinë që popujt e Ballkanit u kushtojnë historisë dhe miteve historike, do të jemi të detyruar që bashkë me lexuesit të ndërmarrim disa shtegëtime në analet e historisë. Në fund të fundit, siç dihet, pa hedhur një vështrim mbi të kaluarën nuk mund të vështrohet as drejt së ardhmes. Dhe këtu bëhet fjalë shì për këtë gjë.

Fundi i komunizmit - ndikimet e kësaj dukurie mbi Ballkanin

Në Poloni dhe Bullgari, në Çeki dhe Rumani, në Hungari dhe Shqipëri përmbysja e sundimit komunist shënoi fundin e një sistemi politik. Integriteti i këtyre shteteve nuk u vu në pikëpyetje dhe kufijtë e tyre shtetëror nuk pësuan ndryshime. Identiteti kombëtar i qytetarëve të tyre mbeti i pacënuar.

Mirëpo në Jugosllavi ngjarjet nuk ndoqën këtë rrjedhë. Atje fundi i sundimit komunist u shoqërua njëkohësisht me shpërbërjen e shtetit. U krijuan shtete të veçanta kombëtare, të pavarura dhe sovrane; popujt, prej të cilëve përbëheshin ato, u detyruan të vihen në kërkim të një identitet të ri. Ky identitet mund të mbështetej vetëm mbi nacionalizmin. Kështu duke filluar me shpërthimin e nacionalizmave të veçantë dhe kryesisht të atij serb, me mëtimet (pretendimet) e tij për shtrirjen e sundimit mbi të gjitha trevat ku banonin serbë, ngjarjet u rrokullisën deri tek luftrat brendajugosllave.

A mund të ishte gjetur mbas fundit të komunizmit edhe në truallin e Jugosllavisë së dikurshme një alternativë demokratike? A kanë ekzistuar kushte të tilla paraprake në kulturën politike të popujve të veçantë, si edhe në shëmbëlltyrën e tyre qytetare?

Juristi i ri i të drejtës kushtetuese Edin Sarcevic nga Sarajeva është shprehur kështu mbi individin dhe bashkësinë: "Njeriu (në Evropë) e ka përjetuar qysh nga shekulli i XVIII-të, dmth qysh nga periudha e Fihtes, Humboldit dhe Kantit, veten si qendrën e botës dhe lirinë e tij si një vlerë të pakundërshtueshme, të cilën shteti nuk duhet t'a vërë kurrë në dyshim. Pra, njeriu vetë, qytetari abstrakt në kuptimin evropian, përbën bazën dhe synimin e shtetit. Parimi i sovranitetit të popullit, i demokracisë përfaqësuese dhe i të drejtave të njeriut e verifikon këtë fakt në kushtetutat dhe praktikën ligjore të shteteve evropiane. Por në këtë pjesë përbërëse antropologjike të konceptit botëror eurocentrik përfshihet edhe diçka tjetër më e rëndësishme. Ajo ngërthen në vetvete shoqëri multikulturore, mbasi nuk veçon asnjë etni njerëzore, asnjë racë apo besim fetar: ajo vlerëson në radhë të parë njeriun, përkatësisht njeriun si qytetar i një shteti ...."

Kështu ai na lë të nënkuptojmë se kjo mënyrë të menduari është e huaj për botën e Ballkanit. Pesëqind vjetët e " zgjedhës turke" - ky është përkufizimi popullor për sundimin e Perandorisë Osmane mbi pjesën më të madhe të Ballkanit nga shekulli

i XIV-të deri në fillim të shekullit të XX-të - e kanë izoluar këtë rajon nga rrjedhat dhe zhvillimet kulturore dhe shpirtërore të Perëndimit. Mbas një qeverisje të përkohëshme vendore të shkurtër dhe dy luftërave botërore, pasuan 30, 40 madje edhe 70 vjetët "e zgjedhës komuniste". Gjithsesi e përbashkëta e këtyre dy epokave qëndron në faktin se njerëzit kanë qenë objekt i qeverive dhe e kanë pranuar një gjë të këtillë.

"Liria individuale" është një koncept me përmbajtje të diferencuar. Në Perëndim, për shembull, gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë mbizotëronte mendimi se njerëzit, që jetonin në vendet e qeverisura prej komunistëve, mbaheshin në kushtet "e mungesës së lirisë" dhe vuanin nga kjo gjë. Mirëpo mbas normalizimit të komunikimeve ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, u vu re se në shumë drejtime kjo tabllo kishte qenë tepër e thjeshtëzuar. Kush nuk kishte një ideal politik të caktuar dhe kush nuk kishte kërkesa të posaçme për jetën e tij individuale mund të mbetej pak a shumë i pacënuar nga anët negative të regjimit, i cili nuk pranonte asnjë lloj opozite.

Një qytetar i tillë mund të siguronte ekzistencën e tij, duke përmbushur deri diku nevojat e tij jetësore modeste dhe të përshtatura ndaj rrethanave. Ai nuk u binte në sy për të keq udhëheqësve të tij politikë, përkundrazi, një qytetar i tillë i kënaqur u shërbente si miratim i përçapjeve të tyre në drejtim të ruajtjes së qetësisë kolektive në vend. Në vija të përgjithshme këtë qytetar shteti e linte në qejf të vet, madje i siguronte një ekzistencë shoqërore, ndonëse modeste por gjithsesi të pakërcënuar. Çdo qytetar kishte vendin e tij të punës, që nuk vihej në rrezik edhe atëhere kur ndërmarrja shtetërore, ku ai punonte, dilte me humbje. Kishte një shërbim shëndetësor, i cili vërtetë ishte i ngathët dhe shpesh funksiononte me rezultate të dyshimta, por nga ana tjetër pjesëmarrja në jetën kulturore, hyrja në teatër dhe koncerte, si edhe blerja e librave të lira ishin gjëra të thjeshta. Kultura përkrahej në rrugë shtetërore.

Mbas shëmbjes së komunizmit qytetari i thjeshtë e humbi këtë siguri. Lufta dhe mjerimi ekonomik në trajtën e papunësisë krijoi tek shumë njerëz ndjenjën e pasigurisë, u grabiti atyre perspektivën dhe i shndërroi në qenie apatike. Periudha e qeverisjes komuniste u shëmbëllente atyre si "periudha e vjetër e mirë".

Kjo përbën një paradoks të veçantë, po të kihet parasysh se në vendet e Ballkanit sundimtarët përkatës kurrë nuk janë udhëhequr nga interesat e qytetarëve. Dhe anasjelltas: asnjëherë shteti e sundimtarët e tij nuk kanë gëzuar besimin e qytetarëve. Në rastin më të mirë ata u janë përshtatur sundimtarëve të tyre, duke pranuar të trajtoheshin si nënshtetas të përunjur.

Qëndrimi i mbajtur nga njerëzit në Shqipëri më 1989/90 mbas përmbysjes përfundimtare të regjimit të Enver Hoxhës dhe të pasardhësve të tij të drejtpërdrejtë është një tregues i qartë i pasojave psikologjike, me të cilat mund të shoqërohet përvoja kolektive e të qenurit objekt i përpunueshëm dhe i përpunuar i shtetit.

Sapo u shpall "liria", dmth kur u bë e ditur hapja e kufijve të vendit, me mijëra shqipëtarë u larguan spontanisht nga banesat, vendet e punës dhe familjet e tyre dhe sulmuan jo vetëm ambasadat e shteteve perëndimore, por vërshuan drejtpërsëdrejti në anijet që ndodheshin në portet detare, për t'u larguar nga atdheu e për të shkuar drejt Italisë apo diku tjetër në "Perëndimin e artë". Pjesës më të madhe të këtyre njerëzve as që u shkonte ndërmend se për këtë qëllim nevojitej një pasaportë, të cilën ata gjithsesi nuk e kishin marrë ende dhe se më parë duheshin përfunduar marrëveshje ndërshtetërore, që të mundësonin ardhjen së tyre si turistë, emigrantë apo refugjatë; pra, me një fjalë, ata ishin krejtësisht të paditur përsa u takon funksioneve që ka shteti në rrafshin ndërkombëtar.

Fakti që pushtetarët mund dhe duhet "të kontrollohen" dhe që këto kontrolle janë detyrë e shoqërisë dhe e qytetarëve, përbën një dukuri të re, që do të përvetësohet shumë ngadalë nga njerëzit, qytetarët dhe politikanët e rajonit tä Ballkanit vetëm me kalimin e kohës. Procesi mësimor nuk duhet të zhvillohet vetëm nga "poshtë lart" dhe në fakt duhet filluar në drejtimin e përkundërt.

Mirëpo bash këtu fshihen tinëzitë. Në disa vende të Ballkanit, ç'është e vërteta, pushtetin nuk e kanë më pushtetmbajtësit e vjetër, por prapëseprapë shokët e tyre të rreshtit të dytë e këta tregohen të zellshëm vetëm përsa i përket përdorimit të një fjalori demokratik. Ose, siç e ka formuluar një filozof polak: "Politikanët kanë ndërruar mbas përmbysjes fjalorin e gjuhës së tyre, por jo gramatikën."

Kjo mund të shprehet ndryshe edhe kështu: është e vërtetë se ata flasin për pluralizëm politik dhe sistem shumëpartiak, por në fakt partitë e tyre i shndërrojnë në parti shtetërore, që mbajnë fort në duart e tyre frenat e pushtetit. Ata lejojnë zhvillimin e zgjedhjeve të përgjithshme, por kur "partisë shtetërore" i kërcënohet humbja, veprohet thjesht në drejtim të fallsifikimit të rezultatit të zgjedhjeve. Kështu ka ndodhur në Serbi; në fakt atje është lejuar shumëllojshmëria e mediave, por frekuencat, me anën e të cilave mund kapen e emisionet e radios dhe të televizionit në të gjithë vendin, u rezervohen vetëm institucioneve radiotelevizive të dirigjuara nga shteti. Atje ka gjithashtu një numër të madh gazetash dhe revistash, por regjimi e di, se këto duke qenë opozitare, lexohen vetëm në qytetet deri diku të mëdha dhe nuk gjejnë asnjë lloj jehone në fshat. Në rastet kur bëhen të bezdisshme nga pikëpamja politike, atyre u vihen gjoba të mëdha monetare, të cilat rrënojnë ekzistencën e tyre ekonomike. Edhe këtu vlen për t'u marrë si shembull Serbia.

Gjithsesi të gjitha vendet e Ballkanit ose ato të dala nga Jugosllavia e dikurshme nuk mund të futen në një kallëp. Në Slloveni vazhdon të jetë në pushtet si President i shtetit shefi i dikurshëm i partisë komuniste vendore Milan Kuçan, mirëpo institucionet demokratike funksionojnë relativisht pa të meta dhe jeta publike ka një prerje, ku spikasin qartësisht tiparet demokratiko-perëndimore. Në anën tjetër, regjimi i Tuxhmanit në Kroaci me orientimin e tij antikomunist ka qenë një regjim nacionalisto-autoritar me një kryetar shteti që gëzonte pushtet të

pakushtëzuar dhe një parti qeveritare (HDZ), e cila ka patur të gjitha tiparet e një partie-shtet, dmth që e konsideronte shtetin thjesht si pronën e saj vetiake dhe me një pushtet të pakufizuar jo vetëm në rrafshin politik, por edhe në atë ekonomik. Megjithatë, mbas vdekjes së Tuxhmanit në vjeshtën e vitit 1999 dhe zgjedhjeve parlamentare dhe presidenciale në fillim të vitit 2000, pushteti mbizotërues i HDZ-së pësoi një thyerje.

Shëmbulli i Shqipërisë tregon se me çfarë absurditetesh mund të shoqërohet "liria e papritur e shtypit" në një vend, ku nuk janë krijuar ende kushtet paraprake politike. Mbas përmbysjes atje mbinë menjëherë në të gjitha skajet e vendit disa qindra gazeta me tirazhe minimale, të cilat i kishin vënë vetes të njëjtin qëllim, dmth larjen e hesapeve me personalitetet e së kaluarës, përkatësisht ballafaqimin e aktorëve politik me të kaluarën e tyre. Të gjitha këto gazeta paraqitnin të njëjtat dobësi; me sa duket, dhënia thjesht e njoftimeve nuk paraqiste në vetvete interes për to. Në këtë drejtim ato gjithsesi nuk dalloheshin nga gazetat "e mëdha" të Tiranës. Politikanët udhëheqës u mbrurreshin vizitorëve perëndimorë me këtë "shumëllojshmëri të shtypit".

Megjithatë, edhe në Shqipëri ka patur një rreth të vogël gazetarësh të angazhuar dhe me orientim kritik, që ishin plotësisht të bindur se në këtë kohë e tanishmja ishte shumë më e rëndësishme sesa e kaluara dhe që jo rallë u bënë viktima të sulmeve fizike ose dënimeve financiare marramendëse gjoja për mungesë korrektese. Vetëkuptohet që gjatë bisedave zyrtare gjëra të tilla nuk ziheshin me gojë.

Për të treguar se çfarë vështirësish paraqet në Ballkan mënjanimi në rrugë demokratike i strukturave të pushtetit që kanë lëshuar rrënjë të thella, le t'i drejtohemi më së fundi një ngjarjeje të përjetuar në Serbi. Në Shumadi, në krahinën e mirëfilltë serbe në jug të Beogradit, "Lëvizja Serbe për Ripërtëritje" organizoi një tubim zgjedhor me udhëheqësin e saj Vuk Drashkoviç, gjatë të cilit ky i fundit ngjalli me fjalimin e tij një stuhi të vërtetë entuziazmi. Më pas, bashkëpuntorët e tij në një sondazh të bërë, për të parë nëse pjesëmarrësit e këtij tubimi gjatë zgjedhjeve të ardhëshme do t'ia jepnin po ashtu votën e tyre politikanit të opozitës, përjetuan një zhgënjim të hidhur. Njerëzit pohuan se do të votonin rishtas për Sllobodan Millosheviçin. Kur i pyetën këta persona, pse kishin mbështetur plotësisht atëhere me duartrokitjet e tyre Drashkoviçin, ata morën këtë përgjigje: "Ne do të votojmë për të, sapo ai të marrë pushtetin ...."

Të drejtat e njeriut - një kapitull plot keqkuptime

Kur nisi bashkëbisedimin me shtetet e Evropës Juglindore Perëndimi foli në radhë të parë për "demokracinë", por edhe për "të drejtat e njeriut". Përfaqësuesit e vendeve demokratike perëndimore për një kohë të gjatë nuk vunë re se edhe nocioni i "të drejtave të njeriut" binte në veshin e shurdhër të bashkëbiseduesve të tyre. Për një kohë mjaft të gjatë njëri i binte gozhdës, ndërsa tjetri patkoit, ndonëse komunistët "e konvertuar" kishin mësuar shumë shpejtë të flisnin jo vetëm për demokracinë, por edhe për të drejtat e njeriut dhe, madje, si në Shqipëri dhe Serbi kishin krijuar ministri për të drejtat e njeriut ose komisione zyrtare të të drejtave të njeriut. Megjithatë, përfaqësuesit e të drejtave të njeriut të OJQ-ve (organizatave joqeveritare) vetëm në raste të rralla mirëpriteshin me kënaqësi.

Perëndimi e di më së miri, se çfarë kupton ai me të drejta të njeriut. Ato përbëjnë jo vetëm një imperativ moral të njohur përgjithësisht dhe, gjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar, edhe një instrument politik kundrejt regjimeve totalitare - për shembull në kuadrin e Konferencës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (KSBE, më vonë OSBE) - por njëkohësisht një visar kulturor. Në lidhje të ngushtë me të drejtat qytetare, me mirëkuptimin për dinjitetin e njeriut dhe me shprehjen e të drejtës për qëndresë kundrejt superpushtetit shtetëror në Anglinë e shekullit të XVII-të, gjatë luftës për pavarësi të Amerikës dhe gjatë Revolucionit Francez u mbrujt mirëkuptimi për barazinë parimore të të gjithë njerëzve. Dy luftërat botërore, tragjeditë e çifutëve në Gjermaninë e Hitlerit dhe armenëve në Turqi gjatë viteve 1914-1915, ndaj të cilave "Perëndimi" mbajti një qëndrim pasiv, mprehën përfundimisht ndërgjegjen e popujve dhe sollën më 1948 Deklaratën mbi të Drejtat e Njeriut të Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Megjithatë deri sot, pavarësisht nga gjithë këto arritje, nuk ka qenë e mundur që këto mendime të shndërrohen në një element të së drejtës në të gjitha shtetet e sferës kulturore perëndimore, në mënyrë që përkatësisht rastet e cënimit të tyre të ndiqeshin penalisht. Por sidoqoftë - jo vetëm që këtu punohet në shumë rrafshe, por po shumohen edhe përfytyrimet mbi një të drejtë qytetare ndërkombëtare të ardhme, që duhet të burojë nga idetë themelore morale mbi të drejtat e njeriut - rruga për të arritur atje është ende shumë e gjatë.

Ç'kuptim ka për njerëzit që nuk njohin asnjë të drejtë qytetare koncepti i "të drejtave të njeriut" ? Ç'kuptim mund të ketë ky nocion në kushtet e një mënyre jetese tradicionale fetare, në të cilën individi si i tillë nuk luan asnjë rol, ose shprehur ndryshe çdo njeri ka vendin e tij, detyrat e tij dhe kompetencat e tij në një kuadër plotësisht të ngurtë të familjes me struktura patriarkale - ose matriarkale - dhe të bashkësisë lokale, si objekt i interesave të sundimtarëve? Një vëzhgues i jashtëm pa përgatitjen e duhur teologjike, mund të mendojë ndoshta që as islami dhe as kisha ortodokse nuk interesohen për individualitetin e besimtarit, por çdo qenie të veçantë e rendisin vetëm si një anëtar të bashkësisë, rregullave të së cilës ai duhet t'u përshtatet. Megjithatë, shpeshherë kur përfaqësuesit e Perëndimit çuditen për mungesën e marrjes së nismave ose për ndjenjën e mangët të përgjegjësisë në shtetet e Evropës Juglindore, shpjegimin duhet t'a kërkojnë në radhë të parë tek fakti që përgjegjësia vetiake po ashtu si edhe nisma vetiake përbëjnë dukuri që duhen mësuar më parë.

Format tradicionale të jetesës nënkuptojnë - gjë e vështirë për t'u përfytyruar sot nga njeriun modern i Perëndimit - jo vetëm nënshtrimin, por njëkohësisht edhe mbrojtjen dhe gjetjen e një strehe të ngrohtë. Kjo gjë vlen, veç të tjerash, në një kuadër të caktuar edhe për gratë. Është e vërtetë se ato nuk kanë gëzuar

pothuajse asnjë të drejtë, por gjithsesi kanë zënë një vend të qëndrueshëm e të caktuar në shoqëri, i cili, duke ndryshuar nga krahina në krahinë, u siguronte autoritet në situata të caktuara. Në këtë tabllo bën pjesë edhe një dukuri, që vihet re në rajonet e Ballkanit deri në ditët e sotme dhe sipas së cilës djemtë ruajnë një lidhje të veçantë me nënën e tyre, që vazhdon gjatë gjithë jetës e shumë shpesh, sa kohë që nuk janë martuar, vazhdojnë të jetojnë në shtëpi, pra nën kujdestarinë e nënës. Shpeshherë ata mbeten hë për hë edhe mbas martesës në shtëpi dhe në këto raste nusja e re vendoset pranë familjes së burrit. Deri vonë, kryesisht në zonat fshatare, nusja keqpërdorohej nga vjehrra për kryerjen e punëve më të rëndomta, pa qenë e mundur të kundërshtojë apo të merret në mbrojtje nga burri. Çdo lloj kritike apo kundërshtimi kundrejt nënës përbënte diçka të papranueshme. Sidoqoftë bashkëshortja e re e dinte se një ditë do t'i vinte edhe asaj radha dhe ajo vetë do të ushtronte pushtetin e saj në shtëpi.

Ndryshimet e shumta dhe të mëdha në jetën e grave ndoshta nuk kanë qenë aq shumë pasojë e shembjes së komunizmit dhe as vetëm e ballafaqimit vendimtar të "punëtorëve sezonal" - në shumicën e rasteve pa familjet e tyre - me mënyrën e jetesës së Perëndimit, por para së gjithash e krizave dhe luftërave të dhjetëvjeçarëve të fundit të shekullit të XX-të, për shkak se burrat ndodheshin larg shtëpisë dhe ishin "ushtarë të fundjavës" (që vinin në shtëpi në fundjave). Ata kthehesin nga fronti në shtëpi vetëm për disa ditë dhe kështu marrëdhëniet brenda familjes pësonin të çara të vazhdueshme dhe të rënda. Në kushtet e këtij sfondi një numër i madh grash ndërmorrën nisma shoqërore. Së pari, për të ndihmuar njëra-tjetrën dhe, së dyti, për të ndihmuar fëmijët dhe të rinjtë. Kështu lindën numra telefoni "SOS" për gratë dhe fëmijët e përdhunuar e të keqtrajtuar, shtëpi për gra, ku ato mund të gjenin mbrojtje, si edhe nisma ekonomike, për të mundësuar pavarësinë e tyre. Gratë filluan t'i mësojnë njëra-tjetrës bërjen e punëve, që burrat nuk mund t'i kryenin më për shkak të luftës apo arratisë së tyre, si për shembull drejtimin e traktorëve, punimet e zdrukthëtarisë dhe farkëtarisë, etj. Mirëpo, në anën tjetër, edhe të arratisurit nga rajonet e ndryshme të luftës krijuan situata, në të cilat shoqëritë e mbizotëruara nga burrat dështuan plotësisht. Këto veprimtari zgjuan tek shumë gra një mënyrë të re konceptimi të lidhjeve të ndërsjellta shoqëroro-politike, e cila jo rrallë i vendosi ato në pozita opozitare kundrejt politikës zotëruese. Këto dukuri janë vënë re në një masë të madhe në Bosnje-Hercegovinë, Kroaci, Serbi dhe Kosovë.

Me këtë rast vlen të përmendet edhe një përvojë nga Rumania, ku kohëve të fundit disa gra protestuan kundër nismave dashamirëse të ndërmarra nga vendi dhe bota e jashtme, të cilat synonin nxitjen e emancipimit të gruas tradicionalisht të nënshtruar ndaj burrit. "Na lini të qeta", thanë këto gra, "për aq kohë sa gjendja jonë ekonomike do të vazhdojë të jetë kaq e pakëndëshme, do të kemi nevojë që në familje të ketë një solidaritet absolut ndërmjet burrit dhe gruas, përndryshe nuk mund të mbijetojmë..."

Sulmet e Nato-s kundër Jugosllavisë së cunguar

Natën e 24 marsit 1999 avionët e Nato-s sulmuan me bomba dhe raketa pozicionet ushtarake, vendkomandat dhe linjat e komunikacionit të Republikës Federale Jugosllave. Kjo ishte përgjigjja e Natos-s dhe e Bashkimit Evropian për dështimin e bashkëbisedimeve mbi një zgjidhje politike të konfliktit të Kosovës dhe për thellimin e dhunës nga ana e policisë serbe dhe ushtrisë jugosllave në provincën e ndodhur në jug të vendit e të banuar në 90 përqind prej shqiptarëve, si edhe për dëbimin e tyre masiv në Maqedoni e në Shqipëri.

Nato-ja i ndërpreu sulmet e saj ajrore më datë 10 qershor 1999, dmth kur kishin kaluar afro tre muaj dhe vetëm mbasi ishte arritur më parë një marrëveshje për tërheqjen me etapa të forcave të armatosura serbe nga Kosova. Përveç kësaj, nëpërmjet rezolutës nr. 1145 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë u formua një Qeveri Civile Kalimtare (UNMIK - United Nations Interim Administration Mission in Kosovo) dhe u përcaktua pushtimi i kësaj province nga një kontigjent ndërkombëtar ushtarak (KFOR - Kosovo Force) nën udhëheqjen e Nato-s si edhe çarmatosja e formacioneve të armatosura shqiptare (UÇK). Qysh atëhere Kosova është shndërruar praktikisht në një protektorat të Kombeve të Bashkuara, teorikisht ende në kuadrin e Republikës Federale Jugosllave.

Mbi ndërhyrjen ushtarake të Nato-s në konfliktin e brendshëm jugosllav ndërmjet Qeverisë së Beogradit dhe afro 2 milionë shqiptarëve të Kosovës janë shkruar tashma biblioteka të tëra me libra. Në kryeqendër të mendimeve të ndryshme kanë qëndruar dhe vazhdojnë të qëndrojnë ende pyetjet e mëposhtme: A kishte të drejtë Nato-ja të ndërhynte ushtarakisht pa mandatin e Kombeve të Bashkuara në konfliktin etniko-politik brenda një shteti sovran? Qoftë edhe pse në fund të fundit qëllimi ishte humanitar, dmth të ndalonte shtypjen e mëtejshme të popullatës shqiptare nga regjimi serb, i cili me anën e policisë dhe ushtrisë së tij synonte "spastrimin etnik" të provincës? Luftën e armatosur kundër serbëve, e cila zhvillohej me një brutalitet të skajshëm prej të dyja palëve, e kishte filluar UÇK-ja si organizata ushtarake e shqiptarëve. Sulmet ushtarake të Nato-s synonin gjithashtu t'i jepnin fund edhe kësaj lufte, e cila, nëpërmjet shkatërrimit të fshatrave të tëra dhe vrasjes së banorëve të tyre, e kishte sjellë këtë provincë në zgrip të humnerës.

Nuk është vendi këtu për të trajtuar aspektet e së drejtës ndërkombëtare dhe ato humanitare të ndërhyrjes ushtarake të Nato-s, të cilën Jyrgen Habermasi (Jürgen Habermas) e ka cilësuar si "lufta në kufijtë midis të drejtës dhe moralit". Megjithate, data 24 mars 1999 përbën padyshim një datë historike. Në pragun e mijëvjeçarit të tretë kjo datë vuri në lëvizje debatin rreth një pyetjeje fatale: A mund të quhet e përligjur ndërhyrja ushtarake e Nato-s edhe pa mandantin e OKB-së, në rast se instancat ndërkombëtare si Kombet e Bashkuara për shkak të mekanizmave të tyre të trashëguara nuk janë në gjendje të pengojnë një shtet që të shkelë në mënyrë masive të drejtat e njeriut, duke arritur deri në shfarosjen e popullatës pakicë?

Në radhë të parë duhet të trajtojmë këtu pyetjen: a janë shterur plotësisht të gjitha mundësitë, për të zgjidhur politikisht krizën e Kosovës. Edhe për këtë çështje ka pikëpamje të ndryshme; sipas vlerësimit tonë, këto dështuan qartazi për shkak të qëndrimit të ngurtë të palës serbe, apo për t'u shprehur më saktë, të Presidentit jugosllav Sllobodan Millosheviç. Rezultati i bisedimeve për zgjidhjen e krizës së Kosovës në shkurt 1999 në Rambuje (Rambouillet) dhe në mesin e muajit mars në Paris në fakt u pranua më në fund prej shqiptarëve të Kosovës, por u hodh poshtë prej regjimit të Beogradit. Ndërmjetësit ndërkombëtarë, Kristofer Hill (Christopher Hill) i Sh.B.Amerikës, Volgang Petriç (Wolfgang Petrisch) i Bashkimit Evropian dhe diplomati rus Boris Bajorski, u përpoqën për herë të fundit në mbasditen e 22 marsit t'a nxisin Millosheviçin për të pranuar marrëveshjet mbi një autonomi të zgjeruar të Kosovës në kuadrin e Republikës Federale Jugosllave - por më kot. Ai hodhi poshtë si projekt-marrëveshjen ashtu edhe ndërprerjen e sulmeve të policisë dhe ushtrisë serbe kundër popullatës shqiptare në Kosovë. Po ashtu nuk u pranuan, disa orë më vonë, edhe përpjekjet për paqe të të dërguarit amerikan për bisedime Riçard Hollbruk (Richard Holbrooke). Mandej më datë 23 mars u zhvillua takimi "i fundit i të fundmëve" midis Hollbrukut dhe Millosheviçit, gjatë të cilit amerikani u përpoq t'a sqaronte Presidentin jugosllav për pasojat ushtarake të dështimit të bashkëbisedimeve. Më së fundi u shkëput nga trojka me Hillin e Petriçin edhe i dërguari rus për bashkëbisedime Bajorski, i cili ndërmori pa ndihmën e kurrkujt një përpjekje diplomatike në favor të zgjidhjes paqësore. Por edhe kjo mëkot.

Çfarë duhet t'a ketë shtyrë Presidentin jugosllav të rrezikojë një konflikt të armatosur me aleancën më të fortë ushtarake të botës? Pse nuk pranoi ai një zgjidhje për Kosovën, e cila do të siguronte jo vetëm sovranitetin e Republikës Federale Jugosllave mbi provincën e saj jugore, por edhe ekzistencën e pjesës serbe të popullësisë (rreth 10%)? A ka besuar ai se Nato-ja po bënte thjesht kërcënime? A ka llogaritur ai ndoshta një mbështetje ushtarako-politike nga ana e Rusisë dhe një përkrahje masive politike nga ana e Kinës në kuadrin e Kombeve të Bashkuara? Këto janë pyetje, përgjigjet e të cilave mund të gjenden ndoshta vetëm në arkivat e Beogradit dhe të Moskës, në qoftë se do të hapen ndonjëherë.

Sidoqoftë, diplomati austriak dhe i ngarkuari i Bashkimit Evropian për bashkëbisedimet mbi Kosovën Volfgang Petriç është shprehur përsa i takon bisedës së tij të fundit me Millosheviçin (bashkë me Hillin dhe Bajorskin), se nuk kishte gjetur tek Presidenti jugosllav "as edhe shenjën më të vogël të gatishmërisë për kompromise". Në një bisedë private ai ka shtuar, se kishte patur përshtypjen që Millosheviçi kishte humbur çdo lidhje me realitetin, sikur të jetonte në një botë përfytyrimesh joreale.

Megjithatë, duke lënë mënjanë këto shtjellime (shoshitje), shtrohet pyetja: a ishin vallë të pashmangshme sulmet me bomba e raketa të Nato-s, të cilat gjithsesi nuk godisnin vetëm ushtrinë jugosllave dhe pajisjet e saj, por i shkaktonin dëm edhe popullsisë civile, si edhe gjithë vendit? Në fund të fundit, a nuk kishte vallë mundësi të tjera për të mënjanuar luftën pa dyshim shfarosëse të regjimit të Beogradit kundër popullsisë shqiptare në Kosovë? Henri Kisingeri (Henry Kissinger) është i mendimit se çdo politikë, alternativa e vetme e së cilës është ndërhyrja ushtarake, është e gabuar; në rastin e Kosovës nuk ishte shterur ende plotësisht rezervuari i mjeteve të trysnisë politike.

Mandej, mbas pothuajse katër muaj goditjesh ushtarake, i erdhi radha sërish nismave diplomatiko-politike. Fillimisht, në Petersberg pranë Bonit shtetet e Nato-s dhe Rusia ranë në ujdi në fillim të qershorit për një plan paqeje mbi Kosovën, bazën e të cilit e përbënte nisma e Ministrit gjerman të punëve të Jashtme Joshka Fisher (Joschka Fischer). Ajo parashikonte ndërhyrjen e Kombeve të Bashkuara. Më 8 qershor shtetet e G-8-tës u morën vesh në Këln lidhur me tekstin e rezolutës së Këshillit të Sigurtimit të OKB-së, e cila u pranua më 10 qershor me numrin 1244. Një natë më parë Nato-ja kishte arritur me ushtrinë jugosllave marrëveshjen për një tërheqje me etapa nga Kosova. Për pasojë Nato-ja ndërpreu sulmet ajrore në territorin jugosllav dhe popullsia shqiptare e dëbuar dhe e arratisur nga Kosova - ishin rreth 800'000 njerëz - filloi të rikthehej në atdheun e saj të shkretuar.

Menjëherë mbas ndërprerjes së sulmeve të Nato-s në Kosovë u krijua edhe njëherë një gjendje kërcënuese. Më 11 qershor trupat ruse të kontigjentit të SFOR-it në Bosnje Herecegovinë pushtuan në formën e një kundërgoditje të shpejtë aeroportin e Prishtinës, kryeqytetit të Kosovës, për të siguruar atje zbarkimin e kontigjenteve të tjera të trupave ruse. Kanosej një ndeshje me forcat e armatosura të Nato-s, të cilat po përparonin duke ardhur nga Maqedonia, me pasoja të rrezikshme për paqen në të gjithë Evropën. Mirëpo gjendja u shtendos, për shkak se Hungaria, Rumania dhe Bullgaria nuk u dhanë leje mjeteve transportuese të trupave ruse të fluturonin mbi territoret e tyre.

Pra, këta shtete i bënë kështu një shërbim shumë të vyer paqes evropiane, duke kërkuar të shpërbleheshin për këtë gjë nga bashkësia ndërkombëtare. Çfarë pasojash politike dhe ekzistenciale kanë patur për Kosovën dhe popullsinë e saj në shumicë shqiptare goditjet e Nato-s? Për këtë çështje do të bëjmë fjalë në një kapitull të veçantë. Më tej, çfarë ndihmese kanë dhënë këto goditje në drejtim të "çështjes globale" të sigurimit të të drejtave të njeriut dhe të drejtave qytetare të popujve dhe të grupeve të popujve, ekzistenca e të cilëve është e kërcënuar politikisht dhe ushtarakisht? Në këtë vështrim goditjet e Natos-s kundër Jugosllavisë për t'i ardhur në mbrojtje shqiptarëve të Kosovës kanë hapur padyshim rrugën e një procesi, i cili në rrafshin ndërkombëtar në të ardhmen do të ketë për pasojë që në sistemin e së drejtës së bashkësisë të popujve të përfshihen detyrimisht edhe parimet morale. Për të siguruar kështu paqen, jo vetëm në pjesët qendrore të botës, por edhe në ato periferike.

Pakti i Qëndrueshmërisë (Stabilitetit)

"Pakti i Qëndrueshmërisë (Stabilitetit) për Evropën Juglindore" përbën padyshim një ide të shkëlqyer, sepse përveç të tjerash i ofron Evropës, apo për të qenë më të saktë Bashkimit Evropian, mundësinë për të njëmendësuar bashkërisht një ide

të përbashkët. Ky është i pari projekt i madh që mund të demonstrojë një bashkim dhe njësim të tillë. Në kuadrin ushtarak është vepruar tashma njëherë "në mënyrë evropiane" së bashku me Shtetet e Bashkuara të Amerikës; mirëpo Pakti i Qëndrueshmërisë (Stabilitetit) i shërben paqes.

Mund të shtrohet pyetja: mos vallë kjo ide e shkëlqyer është ndoshta një pasojë e ndërhyrjes ushtarake në Serbinë e Millosheviçit dhe në Kosovë? Në fakt, nga njëra anë, opinioni publik i shteteve anëtare të Bashkimit Evropian ka kundërvepruar në mënyrë shumë të diferencuar ndaj rrjedhës së bombardimeve dhe përgjithësisht ndaj konceptit të Nato-s e, nga ana tjetër, kjo luftë shkaktoi shkatërrime të jashtëzakonshme materiale jo vetëm në rajonet që përbënin synimet e saj. Edhe shtetet kufitare si Hungaria, Rumania, Bullgaria, Shqipëria, Maqedonia dhe Mali i Zi u prekën po ashtu nga vargjet e ikanakëve që largoheshin dhe riktheheshin në Kosovë, kështu që rindërtimi i gjithë rajonit përbënte si të thuash një "conditio sine qua non" për ardhmërinë Evropës.

Bashkimi Evropian ndodhej - në se na lejohet të bëjmë një krahasim të tillë, që çalon si gjithë të tjerët - afërsisht në po atë situatë në të cilën janë ndodhur Shtetet e Bashkuara mbas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore përkundruall Gjermanisë së shkatërruar nga bombardimet dhe shteteve të tjera evropiane, në të cilat lufta kishte shkaktuar rrënime të mëdha, dmth pa një Evropë dhe bash në mesin e saj një Gjermani funksionale nga pikëpamja ekonomike, e gjithë fuqia e Evropës do të mbetej diçka lehtësisht e thyeshme. Atëhere u vendos të zbatohej një program zemërgjërë: Plani Marshall. Plani në fjalë, që u zbatua shpejt dhe në mënyrë joburokratike, ndihmoi rindërtimin në të gjitha rrafshet dhe çdo njeri të veçantë për të kapërcyer katastrofën e Luftës së Dytë Botërore. Ai i bëri reklamë Amerikës dhe kjo përbënte një efekt anësor tepër të qenësishëm. Plani Marshall prodhoi një mirënjohje të thellë.

Etapat e "idesë së madhe"

Hapi i parë ishte vendimi i marrë në kuadrin e Këshillit të Evropës për përvetësimin e një strategjie të përbashkët në lidhje me të ashtuquajturin Ballkan Perëndimor. Kjo ndodhi në fund të vitit 1998. Ky projekt gjeti konkretizim në "Planin Joshka Fisher për një Pakt Qëndrueshmërie (Stabiliteti) për Evropën Juglindore", i cili u parashtrua në Këshillin e jashtëzakonshëm të Ministrave të Jashtëm në fillim të prillit 1999. Synimi i tij didaktik është i qartë. Shtetet përkatëse jo vetëm do të ndihmohen në drejtim të zhvillimit të tyre të përgjithshëm, por atyre do t'u vihen - si të thuash - kushte në rrafshin e demokracisë dhe të drejtave të njeriut. Nismat për njëmendësimin e tyre do të vijnë nga Bashkimi Evropian, ndërsa zbatimi do të kryhet "nën kujdestarinë e OSBE-së". Në projektin e përgjithshëm janë përfshirë nga pala perëndimore 27 shtete ("Formati Royamont" (?), i quajtur kështu sipas emrit të një qyteze në rrethinat e Parisit, ku në dhejtor 1995 gjatë Konferencës së Parisit për Paqen në Bosnje-Hercegovinë, përfaqësuesit e këtyre shteteve propozuan gjetjen e mjeteve dhe udhëve për të nxitur në të ardhmen qëndrueshmërinë dhe fqinjësinë e mirë në Evropën Juglindore) dhe përveç këtyre edhe një seri organizatash dhe nismash ndërkombëtare si FMN-ja (Fondi Monetar Ndërkombëtar), NEJB-ja (Nisma e Evropës Juglindore për Bashkëpunim) e shumë të tjera. Synimet e Paktit të Qëndrueshmërisë (Stabilitetit) nuk vihen në dyshim, por vështirësia qëndron në njëmendësimin e tyre.

Nismëtarët e shumtë kanë paraparë një administratë mjaft të ndërlikuar. Instanca më e lartë përbëhet nga një "tryezë rajonale", detyra thelbësore e së cilës është bashkërenditja e veprimtarive të ndryshme. "Zot i tryezës" është ministri i dikurshëm i Zyrës Gjermane të Kancelarit, Bodo Hombah (Bodo Hombach), i Partisë Socialdemokrate Gjermane (SPD). Kjo zgjedhje u kontestua menjëherë fuqimisht dhe kështu, për të kundërshtuar kandidaturën e Hombahut, u theksua se ai vërtet gëzon namin e një drejtuesi të shkëlqyer, por nuk është marrë më parë asnjëherë në ndonjë farë mënyre me problemet e Ballkanit. Tri tryeza - në projektet e para ishin katër - duhet të përqëndrojnë veprimtarinë e tyre në lëmenjtë e demokracisë, të ekonomisë dhe të sigurisë. Një zyrë bashkërënditëse ndodhet në Bruksel, ndërsa tjetra në Selanik.

Për herë të parë titujt kryesorë të gazetave të shkruara me germa të mëdha iu kushtuan Paktit të Qëndrushmërisë (Stabilitetit) me rastin e rreshtimit ceremonial pompoz në Sarajevë të kryetarëve të shteteve, kryeministrave, presidentëve dhe drejtorëve të përgjithshëm të institucioneve dhe organizatave pjesëmarrëse më 30 qershor 1999. Lista shumë e gjatë e oratorëve përfshinte një numër të madh miqsh emërmëdhenj. Secilit prej tyre i ishin rezervuar tri minuta, mbasi pothuajse të gjithë kishin shprehur dëshirën për t'u larguar po atë ditë nga kryeqyteti i Bosnje-Hercegovinës. Kjo i vinte për shtat padyshim edhe mikpritësit, mbasi qyteti i Sarajevës që vuante akoma pasojat e shkatërrimeve të luftës, nuk ishte ende në gjendje të ofronte një numër kaq të madh shtretërish në hotele dhe pensione të cilësisë së lartë. Kjo "fotografi familjare më e kushtueshmja e të gjitha kohërave", siç e kanë quajtur disa gazetarë, gllabëroi shuma përrallore dhe u kundërshtua fuqishmisht jo vetëm prej vendeve të mundshme pritëse. Vallë sa projekte të tjera me rëndësi jetike mund të ishin financuar me mjetet e shpenzuara me këtë rast!

Qysh atëhere janë zhvilluar një sërë konferencash të vogla, të cilat duhet të synonin, veç të tjerash, në sqarimin dhe shpjegimin e faktit që Pakti i Qëndrueshmërisë (Stabilitetit) duhej kuptuar jo si financues i një programi ndihmash për investime të mëdha, por më tepër si një motor politik, i cili duhet të mobilizojë dhe kanalizojë paratë, në mënyrë që ato të derdhen në kanalet e duhura dhe të mos treten në moçalet e korrupsionit. Të dyja këto detyra janë të përmasave të jashtëzakonshme dhe lehtësisht mund të mos arrijnë synimin e tyre. Në fund të marsit 2000 u zhvillua një e ashtuquajtur konferencë e dhuruesve (donatorëve), ku u miratuan shumat e para të parave dhe u krijuan mundësitë e përcaktimit të projekteve të para. Në sferat e larta të vendeve pritëse u reagua në mënyrë të njëzëshme me entuziazëm, ndërsa në radhët e popullit vazhdon të mbizotërojë mosbesimi dhe apatia.

Programi

Pakti i Qëndrueshmërisë (Stabilitetit) përfshin një program të plotë, i cili nuk parasheh vetëm ndihmën materiale për ndërtimin dhe zhvillimin e një ekonomie moderne, "të aftë për të qenë evropiane", por edhe edukimin demokratiko-politik, si edhe një sistem të përbashkët sigurie që duhet të përjashtojë në mënyrë profilaktike grindjet e armatosura në rajon dhe të luftojë kriminalitetin e përgjithshëm e që tejkalon kufijtë shtetërorë. Të tre këto drejtime kryesore të programit do të përpunohen në veçanti, duke filluar nga koncepti e deri në njëmendësimin e tyre, nga "tryezat" e përmendura tashmë më sipër. Të gjitha këto aspekte përbëjnë një kusht paraprak të domosdoshëm për qëndrueshmërinë e Evropës. Në fakt - dhe kjo njohuri përbën edhe bazën e gjithë këtij projekti - për aq kohë sa jo çdo shtet i veçantë i rajonit të Ballkanit do të jetë i "qëndrueshëm", nga secili prej këtyre shteteve mund të shpërthejë një zjarr i madh i gjithmbarshëm.

Ngritja e rajonit në një nivel ekonomik, politik e kulturor të atillë që të jetë i aftë - siç thuhet shprehimisht - "për t'u integruar mbi baza individuale në strukturat evroatlantike", përbën po ashtu një synim tashmë të shpallur. Fakti që ky synim ngjall shpresa të mëdha qëndron jashtë çdo dyshimi, po aq sa edhe fakti që koha e pritjes deri në njëmendësimin e tij do të jetë shumë më e gjatë, sesa e përfytyrojnë sot këtë gjë shtetet e Evropës Juglindore.

Bashkësia ndërkombëtare e shteteve, në kuadrin e konceptit të përgjithshëm, quan njërën nga detyrat e saj më thelbësore "zbutjen e situatave të acaruara vendimmarrëse mbi të drejtën e popujve për vetëvendosje dhe ruajtjen e njësisë së shteteve multietnike". Kësaj teme tepër komplekse e tepër delikate, që, përpos të tjerash, në disa prej shteteve pasardhëse të Jugosllavisë mund të keqkuptohet edhe si një nekrologji nostalgjike, do t'i rikthehemi rishtas. Shtetet e Evropës Juglindore - në kuadrin e rregullave kushtëzuese dhe të një sistemi dënimesh e shpërblimesh - marrin përsipër detyrimin për një bashkëpunim gjithëpërfshirës në frymën e këtij pakti mbi baza shumëpalëshe dhe dypalëshe. Kjo kërkesë ndeshet gjithsesi me kushte paraprake tejet të diferencuara në të gjithë lëmenjtë, pra në ato të ekonomisë, të jetës shoqërore e të sigurisë, për të mos bërë fjalë fare për kulturën, e cila si e tillë nuk përmendet fare në programin e Paktit të Qëndrueshmërisë (Stabilitetit).

Kështu, për shembull, nga pikëpamja ekonomike ka një ndryshim të dukshëm përvoje ndërmjet shteteve, të cilat si partnere të KNER-it (Këshillit të Ndihmës Ekonomike Reciproke) në kushtet e një ekonomie rreptësisht të planifikuar kanë qenë të detyruara të bashkëpunojnë ngushtësisht mbi bazën e një organizimi të centralizuar me Bashkimin Sovjetik me shtetet pasardhëse të Jugosllavisë së dikurshme. Njëra palë, falë këtij sistemi mbirajonal, nuk ka patur vetëm përvojë pozitive, asaj i mbetej një fushë veprimi e kufizuar për marrjen e nismave vetiake shtetërore, po ashtu cilësia e prodhimeve të saj shpeshherë mbetej në nivele mesatare, mbasi mungonte konkurrenca e mirëfilltë dhe shtysa për të ndërmarrë përpjekje më të mëdha. Për këtë palë përmbysja politike në fillimet e viteve nëntëdhjetë ka përbërë edhe në këtë vështrim një tronditje të rëndë, që nuk është kapërcyer ende e prandaj kërkesat e Paktit të Qëndrueshmërisë (Stabilitetit) marrin një rëndësi të jashtëzakonshme. Pra, vallë a duhet filluar në këtë kuadër dhënia e ndihmave të mirëfillta për rindërtim, të cilat shtetet e dikurshme komuniste - me të drejtë apo pa të drejtë - i presin qysh mbas përmbysjes, apo pritet prej tyre të vënë tashti në jetë reformat, që gjatë dhjetë vjetëve të kaluara për arsye nga më të ndryshmet nuk kanë mundur t'i vënë në jetë në mënyrë të njëzëshme e të suksesshme?

Shtetet pasardhëse të Jugosllavisë, në anën tjetër, është e vërtetë se kanë përjetuar po ashtu një ndërthurje të ngushtë ekonomike midis republikave lindore dhe atyre perëndimore, por ata kanë gëzuar një liri shumë më të madhe në drejtim të koncepteve të tyre ekonomike dhe kanë patur kërkesa më të larta në vështrim të cilësisë së produkteve të tyre. Marrëdhëniet tregtare ku më shumë e ku më pak të përbashkëta, në krahasim me vendet e KNER-it, ishin drejtuar më tepër kah vendet perëndimore e mbështeteshin më tepër në marrëveshje Joint-venture (shoqërish të përbashkëta). Këto përvoja, që ushtronin një ndikim thellësisht pozitiv mbi ekonomitë përkatëse rajonale, u çrregulluan dhe më pas u shkatërruan nga konflikti ndërjugosllav i viteve tetëdhjetë dhe kryesisht nga lufta e viteve nëntëdhjetë. Fillimet e "bashkëpunimit të ngushtë" që kërkohet nisen kështu nga nivele të ndryshme. Pra më parë duhen kapërcyer disa pengesa që burojnë nga përvojat e së kaluarës.

Demokratizimi përbën gjithashtu një temë të vështirë. Në këta shtete cili është ai, qoftë ky politikan apo qytetar, që e di ç'është demokracia? Në fund të fundit nga mund t'a kishin mësuar ata, qofshin politikanë apo qytetarë, këtë gjë? Në Kroacinë e parë të pavarur pas tetë shekujsh partia shtetmbartëse e themeluesit të saj Presidentit Franjo Tuxhman quhej "Bashkësia Demokratike Kroate", ndonëse regjimi nuk kishte sesi të ndodhej më larg kuptimit të mirëfilltë të demokracisë.Kjo parti me anën e këtij emërtimi ndiqte kështu traditën e pothuajse të gjitha udhëheqjeve komuniste, të cilat nuk e heqin kurrë nga goja fjalën "demokraci".

Njerëzve të vendeve të Ballkanit ua vështirëson rrugën drejt kuptimit perëndimor të këtij nocioni jo vetëm kjo përvojë e shtrembëruar që ata kanë patur me "demokracinë" gjatë periudhës së komunizmit. Ata nuk kanë qenë asnjëherë qytetarë, dmth subjekte me mundësinë për të kërkuar që të merren parasysh "të drejtat" e tyre. Nga ana tjetër, duke mos e njohur shtetin e së drejtës, ata në të njëjtën kohë nuk dinin asgjë mbi detyrat - dmth mbi detyrat ndaj shtetit në interesin vetiak të qytetarëve - për ta shteti përfaqsonte diçka të ngjashme me përfytyrimin e armikut. Gjatë epokave më të ndryshme të historisë së tyre ata me fjalën "liri" kanë kuptuar e shumta mënjanimin, ose të paktën, pakësimin e autoritetit shtetëror. Fakti që shteti ekziston për t'u shërbyer qytetarëve të tij dhe që këta nga ana e tyre ushtrojnë funksione të ligjshme kontrolluese kundrejt pushtetarëve, përbën një përvojë krejtësisht të panjohur për ta. Kushdo që merret me Ballkanin, do të duhej t'i kishte parasysh këto premisa.

Siguria

Midis fqinjëve, të cilët kanë qenë lidhur me njeri-tjetrin si në Paktin e Varshavës kundër armikut të përbashkët "në Perëndim", ç'është e vërteta është zhdukur përfytyrimi i armikut, por kjo nuk do të thotë se është krijuar një solidaritet i ri. Për më tepër zhvillimet e dhjetë vjetëve të fundit të shekullit XX kanë bërë të mundur që nga mosbesimi ndaj organizatave kriminale të shtrira tej kufijve shtetërorë (kontrabanda me droga, armë dhe njerëz), të lindin armiqësi të reja (para së gjithash midis shteteve të reja) dhe acarime latente (për shembull ndaj Shqipërisë). Sidoqoftë duhet pranuar se përfundimi i marrëveshjeve të dyanshme për çështjet e sigurisë, si edhe bashkëpunimi policor dhe ushtarak kundër "kriminelëve" dmth kundër "agresorëve" nuk do t'i krijojë vështirësi asnjërit prej partnerëve. Interesat e përbashkëta janë të qarta dhe në rast se do të ndryshonin kushtet paraprake, dokumentet e nënshkruara nuk do të kishin pothuajse asnjë lloj vlere. Edhe në këtë vështrim tradita nuk mungon.

Kërkesa për bashkëpunim midis fqinjëve, si edhe në rrafshin rajonal, përbën për njëmendësimin e Paktit të Qëndrueshmërisë (Stabilitetit) një pengesë shumë të lartë dhe të vështirë për t'u kapërcyer. Po ashtu shtrohet edhe pyetja: a duhet kuptuar Bashkimi Evropian si një sistem pushteti qendror kundrejt shteteve të vogla, ose thënë ndryshe: a do të jenë vallë të gatshme shtetet e reja të Ballkanit të pranojnë që vija e politikës së tyre të brendshme e të jashtme të përcaktohet nga Bashkimi Evropian? Nga përvoja e tyre me Fuqitë e Mëdha Qendrore të gjitha këto shtete janë "përvëluar njëherë" dhe po të cungohej sovraniteti i tyre i freskët (dhe deri diku ende i pa vënë në provë), do të kundërvepronin si luanët.

Nuk duhet harruar kurrsesi që Bashkimi Evropian, ashtu siç është sot, nuk është krijuar me një të rënë të lapsit. Për disa dhjetëvjeçarë me radhë janë zhvilluar me emërtime dhe synime të ndryshme diskutime në nivele të ndryshme. Duhet patur gjithashtu parasysh se të gjitha shtetet e mëdha anëtare identitetin e tyre kombëtar e kanë siguruar prej kohësh, dmth qysh prej njëqind vjetësh ose disa shekujsh. Vendimi për të hequr dorë nga pjesë të caktuara të sovranitetit në favor të këtij Bashkimi mbikombëtar është pranuar prej qytetarëve të pjekur politikisht që i kanë përmbushur plotësisht nevojat e tyre themelore ekonomike e shoqërore. Nuk duhet harruar se këto shtete të Evropës Perëndimore nuk kanë zhvilluar më prej pesëdhjetë vjetësh luftëra midis tyre.

Të gjitha këto nuk vlejnë në rastin e shteteve të Evropës Juglindore. Kjo është edhe arsyeja pse dëshirën e tyre për të qenë sovranë dhe për të mbetur të tillë ata e theksojnë në një mënyrë shumë më emocionale. Këto shtete nuhasin me mosbesim - shpeshherë me të drejtë - pothuajse tek secili fqinj një rrezik potencial për kufijtë e tyre, për sovranitetin e tyre, për ekzistencën e tyre shtetërore si edhe për paqen e brendshme.

Shqipëria mund të na shërbejë këtu sërish si shembull. Shqiptarët, mbas gjithë atyre gjërave që i kanë shkaktuar vetvetes gjatë 60 vjetëve të fundit të shekullit të kaluar, nuk kanë siguruar as në aspektin e brendshëm të drejtën e ekzistencës së shtetit të tyre. Nxitja e brendshme për t'u larguar nga vendi vazhdon të ketë ende përmasa të jashtëzakonshme, ndërsa besimi në të ardhmen është i barabartë me zero.

Nuk është shumë më e ndryshme edhe gjendja në Bosnje-Hercegovinë dhe në Serbi. Kushdo që gjen një gjasë (shans) për veten në Perëndim e kjo ka të bëjë kryesisht me njerëzit me kualifikim të lartë profesional, nxitohet t'a shfrytëzoj ate.

Kjo përbën njërin prej aspekteve që duhen patur parasysh kur parashtrohen kërkesa për bashkëpunime maksimale dykombëshe dhe shumëkombëshe në rajon. Tjetri ka të bëjë me të kaluarën e drejtpërdrejtë. Mosbesimi midis fqinjëve është shumë më i madh, nga sa mund të merret me mend këtu në Perëndim. Ai është pasojë e "përfytyrimit të armikut" të përcjellë tradicionalisht dhe e përvojës politike. Në Perëndim armiqësitë ndërmjet popujve dhe shteteve fqinje kapërcehen atëhere kur në kushtet e një farë qëndrueshmërie krijohet mundësia e marrëdhënieve të reja dhe kur marrëveshjet ndërshtetërore e garantojnë këtë siguri, si edhe kur nuk ka ndryshime rrënjësore në gjendjen ekonomike të të dyja palëve. Mandej, falë një farë racionalizmi, krijohet mundësia e zhvendosjes në prapaskenë të kujtimeve të luftës, si edhe të armiqësive të ndërsjellta e të shkatërrimeve.

Në Ballkan zhvillime të tilla nuk përbëjnë një dukuri të rëndomtë. Vrasja individuale në rastin konkret të një grindjeje ndodh ndoshta pak "më lehtë" - këtu njerëzit i rrëmbejnë më shpejt armët - se tek ne. Për pjesën më të madhe të burrave të Ballkanit mbajtja e një arme është po aq e vetëkuptueshme, sa është për ne larja e dhëmbëve. Kushdo që mban një armë vetëkuptohet se është menjëherë i gatshëm t'a përdorë ate. Kjo përbën njërën anë të traditës, ndërsa tjetra është mungesa e "kulturës" së konfliktit. "Tek ne nuk ka ende diskutime të tilla si tek ju në Perëndim", ka thënë Ramiz Alia, pasardhësi i Enver Hoxhës, në vitin 1990 në Tiranë gjatë një bisede mbi "demokracinë" të zhvilluar me një delegacion të FNH-së (Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit, në Vjenë), "kush nuk ka të njejtin mendim me mua, është armik dhe armiku pushkatohet - ju duhet t'a kuptoni, për ne rruga drejt kuptimit të demokracisë ndodhet ende tepër larg ...."

Poeti kroat Miroslav Kërlezha (Miroslav Krleza) ka thënë njëherë: "Kur shuhen dritat në një pijetore të Ballkanit, atëherë klientët zgjasin duart drejt thikave...." - një vrojtim ky tejet realist. Kjo tregon se shkaqet e dhunës nuk duhen kërkuar tek urrejtja dhe as tek mosmarrëveshjet ndërfetare e ndërkulturore, por tek një mosbesim i rrënjosur thellë, i cili mund të rrëkëllehet dhe instrumentalizohet lehtësisht për t'u shndërruar në urrejtje. Mosbesimi është pjesë e atmosferës themelore të Ballkanit dhe shqyrtimit e analizimit të tij i kushtohet shumë më pak vëmendje nga sa duhet. Prapa tij fshihen tabu dhe natyra të mbyllura, gënjeshtra dhe dëshira për t'u mburrur, frika dhe mungesa e aftësisë për të mëshiruar. Gjendja e pakënaqshme sociale dhe ekonomike që vihet re kudo jep gjithashtu

ndihmesën e saj në drejtim të nxitjes së mosbesimit dhe smirës.

Së fundi duhet theksuar se Bashkimi Evropian dhe në përgjithësi Perëndimi gjatë viteve nëntëdhjetë nuk kanë vepruar në Evropën Juglindore në një mënyrë të atillë që ndaj tyre të mund të tregohej një besim i pakushtëzuar. Po ashtu edhe gjatë dy shekujve të kaluar Perëndimi nuk e ka dëshmuar veten si një "mik" të besueshëm, por është mjaftuar vetëm në ndjekjen e interesave të tij të ngushta politike pushtetmbajtëse, si edhe atyre ekonomike, në dëm të shteteve të vogla. Është e vërtetë se kohëve të fundit po ky Perëndim është treguar aktiv në drejtimin paqësor - dhe prandaj ndaj tij është shfaqur edhe mirënjohje -, por në të njejtën kohë nuk ka përmbushur shumë prej premtimeve të dhëna. Deri tashti Perëndimi nuk ka përcaktuar ende një koncept të qartë mbi ndihmesën që duhet të japë për perspektivën e ardhshme të rajonit. Prandaj Pakti i Qëndrueshmërisë (Stabilitetit) do të ballafaqohet jo vetëm me probleme konkrete, por edhe me faktorë të paparashikueshëm, drejt njohjes së të cilëve duhet të përqëndrohen përpjekjet e protagonistëve të tij. Në rast se ai do të kufizohej vetëm në përkrahjen e zhvillimeve ekonomike, atëhere ndoshta mund të krijoheshin më lehtë mirëbesimi dhe perspektivat. Mirëpo, duke qenë se Perëndimi parashtron njëkohësisht kërkesa politike dhe moralo-ideologjike, jemi tepër kurreshtarë për të parë, nëse do të mund të arrijë ndonjërin prej synimeve të tij

SI E SHEH PERËNDIMI BALLKANIN

Në Ptuj, Petaun (Pettau) e dikurshëm në verilindje të Sllovenisë në vitin 1992 u organizua një ekspozitë që përbënte një sensacion të vogël. Në kështjellën që ndodhet mbi qytezën mesjetare pranë Draus (Drau) specialistë të ndryshëm nga Sllovenia dhe Karincia (Kärnten?) kishin grumbulluar eksponate pikturash, armësh, objektesh artistike e të përdorimit të përditshëm si edhe rrobash të kushtueshme, të cilat duhet të shërbenin për të konkretizuar pikëtakimet e shumëllojshme midis Lindjes dhe Perëndimit gjatë shekujve XVII dhe XVIII. Kjo ekspozitë është quajtur edhe "Turquerie e Ptujit", për shkak se strumbullari i saj përbëhej nga 47 piktura të muzeumeve të Ptujit dhe Mariborit (gjerm: Marburg), të cilat në historinë e artit evropian janë emërtuar si "turquerie". Në kuadrin e turquerie-s evropiane ato të Ptujit e Mariborit zënë vendin e parë.

Në Francën e shekullit XVII fillimisht janë emërtuar si "turquerie" pjesët teatrale, pikturat dhe krijimet muzikore, në të cilat kishte diçka "turke" (për shembull "Borgjezi fisnik" i Molierit), ndërsa më vonë janë quajtur si të tilla artikujt e modës dhe në përgjithësi ato ekzotike nga Lindja. Të dyja, si objektet e artit ashtu edhe ato të përdorimit të përditshëm në shtëpitë e aristokracisë, pasqyronin interesimin e madh që tregonin shtresat e larta, si edhe kleri i lartë i periudhës së asokohshme për Lindjen misterioze dhe për "Imperium terrible et admirable" (perandorinë e tmerrshme e të adhurueshme) të turqve të mëdhenj në Bosfor.

Për një kohë të gjatë janë bërë hamendësime për të përcaktuar periudhën, së cilës i përkasin turqueriet (?), që janë gjetur në disa kështjella të Sllovenisë së sotme si edhe për të saktësuar kush i ka porositur e kush i ka pikturuar ato. Arsyeja është se në asnjërën prej këtyre pikturave, të cilat paraqesin ofiqarë osmanë dhe tartarë, ushtarë të ushtrisë turke si jeniçerë dhe spahinj, por edhe gra turke, greke e armene, si edhe zonja të tjera nga Perandoria Osmane, që siç dihet shtrihej nga Azia e Afërme deri pothuajse tek portat e Vjenës, nuk gjendet nënshkrimi i autorit.

Sot hamendësohet me mjaft siguri që këto piktura janë porositur nga konti Johan Jozef fon Herbershtajn (Johann Joseph von Herberstein) (1630 - 1692). Ky aristokrat gjatë gjysmës së dytë të shekullit XVII ka bërë një karrierë shumë të larmishme si oficer në luftërat kundër turqve si komandat i kufirit luftarak që ndante Perandorinë Osmane nga ajo e Habsburgve, por edhe si diplomat dhe shtegtar i përkushtuar. Madje ai arriti të bëhej edhe epror i lartë i flotës së maltezëve. Në vitin 1665 shoqëroi kontin Valter Lesli (Walter Leslie) gjatë "misionit të lartë" perandorak të Stambollit për zhvillimin e bashkëbisedimeve me Sulltan Mehmetin IV. Megjithëse, ç'është e vërteta, nuk mori pjesë vetë në bisedimet diplomatike, ai tregoi haptazi një interesim të madh për kulturën dhe jetën e përditshme të kësaj perandorie krejtësisht të huaj për të. Sidoqoftë, mbas rikthimit të tij, duhet të ketë qenë pikërisht ai që ka porositur këto turquerie (?), të cilat tashma mund të soditen në kështjellën e Petaut (Ptuj), e cila asokohe ishte pronë e Leslit.

Në këto rrethana lind pyetja: vallë a mund të vlerësohen turqueriet (?) e Ptujit dhe artikujt e modës nga Turqia si xhaketat, rripat, kasketat apo jorganët e qilimat, të ardhura përmes Ballkanit dhe Adriatikut në Evropën Qe ndrore e Perëndimore, si hapi i parë i interesimit të treguar nga opinioni publik evropian për Ballkanin? Vështirë të ketë qenë kështu. Më saktësisht duhet thënë se ato pasqyrojnë ndikimin magjepës që ushtronte "Orienti (Lindja)" mbi shtresat e larta, jo vetëm në Perandorinë e Habsburgëve, por edhe në Francë. Perandorinë e Padishahut në të vërtetë e kishin frikë dhe e përçmonin, por njëkohësisht e admironin për organizimin e saj të rreptë dhe sendet e saj të vyera, të cilat lakmoheshin prej tyre. Ballkani si pjesë e Perandorisë Osmane me popujt e tij të krishterë joturq vetëm në shekullin XIX filloi të tërhiqte dalëngadalë vëmendjen e evropianëve. Në këtë vështrim kanë ndikuar kryesisht kryengritjet e këtyre popujve, të cilët po përpiqeshin tashma të hiqnin qafe "zgjedhën turke" 500-vjeçare.

Kryengritjet e viteve 1804 dhe 1817 të fshatarëve dhe rritësve të derrave serbë në "Shumadi", në zonën pyjore në jug të Beogradit, patën vetëm një jehonë të dobët në Evropën Qendrore e Perëndimore. Vëmendja e Evropës ishte përqëndruar asokohe tek Napoleoni dhe, mbas largimit të tij nga skena evropiane, tek rendi i ri politik.

Ndryshe ndodhi disa vjet më vonë me kryengritjen dhe luftën për liri të grekëve. Madje mund të thuhet se ajo elektrizoi opinionin publik të Evropës Qendrore e Perëndimore e kryesisht ate të Anglisë. Tekembramja, në luftën për lirinë e Greqisë Anglia humbi poetin e saj më të madh të epokës së re: lordin Bajron (Byron). Në dimrin e viteve 1823-1824 Bajroni u përpoq të furnizonte kryengritësit grekë me para dhe armë. Ai pajtoi për këtë qëllim në Itali një anije, me të cilën

zbarkoi në Greqinë perëndimore, në Mesollogji. Mirëpo, duke mos qenë i përgatitur për të përballuar rropatjet e një jetese në kushtet kaotike të një vendi në pështjellim, ai u sëmur dhe vdiq më së fundi në prill të vitit 1824, me sa duket nga malarja.

Fakti që jeta e krijuesit të veprës së pavdekshme "Shtegtimet e Çajlld Haroldit" (Childe Harold's Pilgrimage) u shua në portin e një qyteze të fëlliqur të Ballkanit zgjoi në një mënyrë pothuajse të befasishme interesimin e përgjithshëm për këtë pjesë të Evropës. Në të vërtetë vëmendja u përqëndrua kryesisht tek grekët heroikë e gjithkund në Evropë hodhën shtat shoqata filohelenike, mirëpo edhe Ballkani në përgjithësi nuk u la mënjanë dhe nuk u konsiderua më thjesht si "Orient" (Lindje).

Në pjesët ballkanike të Turqisë kishin spikatur edhe më herët ngjarje, të cilat duhet të kishin ndikuar për t'a kundruar Evropën Juglindore jo më thjesht si Orient (Lindje), por si diçka të veçantë. Sa më tepër që dobësohej pushteti qëndror në Perandorinë Osmane, aq më arbitrarisht silleshin pushtetarët vendorë, të cilët nuk ndiqnin më interesat e Portës së Lartë, por interesat e tyre vetiake. Ata zotëronin ushtritë e tyre, nuk përfillnin udhëzimet që vinin nga Stambolli, ndiqnin praktikisht një politikë shkëputjeje (sezesioniste) dhe nuk u frikoheshin ekspeditave ndëshkimore të pushtetit qendror. Në radhët e tyre spikat para së gjithash legjendari "luan i Epirit", Ali Pashë Tepelena.

Ai tërhoqi vëmendjen e Evropës gjatë luftrave napoleonike, kur me një shkathtësi të jashtëzakonshme dredhoi midis englezëve, francezëve, rusëve dhe turqve. Viktor Hygoi (Victor Hugo) shprehet për të i mahnitur dhe e cilëson si "të vetmin kolos dhe të vetmin gjeni të kohës së tij, që vlen për t'u krahasuar me Napoleonin".

Ali Pasha kishte tërhequr me kohë vëmendjen e lord Bajronit të ri, i cili në vitin 1809 mbas një kalërimi disaditor nëpër malësitë e Ballkanit e vizitoi në selinë e tij në Tepelenë që ndodhet në territorin e Shqipërisë së sotme. Mbasi u kthye në Janinë të Epirit, Bajroni njëzetenjëvjeçar hodhi atje në letër vargjet e para të "Shtegtimeve të Çajlld Haroldit", të cilat i sollën atij famë botërore.

Për Ali Pashën, pavarësisht nga lord Bajroni, qysh në njëzetvjeçarin e parë të shekullit XIX kishin filluar të qarkullonin në opinionin publik evropian histori tejet të çuditshme. Ai konsiderohej si "përbindëshi më romantik i historisë" dhe kështjella e tij, e ngritur mbi shkëmbinj që shtriheshin deri në liqenin e Janinës, ishte shndërruar në fantazinë e evropianëve si vendi i vrasjeve dhe babëzisë për para si edhe i të gjithë veseve të tjera të mundshme, por njëkohësisht edhe i shkapërderdhjeve bujare dhe i një jete të re shpirtërore.

Ali Pasha arriti të shndërrohej nga një udhëheqës cubash në vezir dhe të sundonte për një periudhë të caktuar mbi një territor, i cili shtrihej nga Maqedonia e Shqipëria jugore në veri deri në Peloponez në jug. Ai ishte një njeri i dhunshëm, që nuk dinte as shkrim e as lexim, por njëkohësisht edhe një politikan i shkathët e një përkrahës i arteve dhe shkencës, i cili e kishte shndërruar Janinën qysh para fillimit të kryengritjes greke në njërën prej qendrave kulturore të Greqisë. Pra, në fund të fundit ishte një figurë, tek e cila njerëzit e Evropës Perëndimore gjenin të njësuar të gjitha ato gjëra që në sytë e tyre përbënin të fshehtat e Orientit, pra: mizori dhe shpirtmadhësi, arbitraritet dhe urtësi, makutëri dhe finesë.

Në kapërcyell të shekujve XVIII/XIX Ballkani nxori në pah edhe Osman Pashë Pashvantoglun nga Vidini i Bullgarisë së sotme, një figurë tjetër, e cila ishte shquar po ashtu në radhët e ofiqarëve osmanë, duke tërhequr kështu vëmendjen e Perëndimit. Ky kishte të përbashkët me Ali Pashë Tepelenën prirjen për t'u bërë sa më i pavarur nga Porta e Lartë. Mirëpo prirjet e tij për pavarësi paraqisnin për Portën e Lartë një rrezikshmëri të një shkalle akoma më të lartë, në krahasim me ato të Ali Pashës, mbasi territori i sunduar prej tij me qendër në Vidin pranë Danubit në skajin veriperëndimor të Bullgarisë së sotme ndodhej bash në strumbullarin politik midis Serbisë, Hungarisë, Rumanisë dhe Bullgarisë. Sulltani u përpoq tri herë të nënshtronte pashain e pabindur, ndërsa Pashvantoglu nga ana e tij iu kundërvu tri herë me sukses ushtrive të padishahut falë talentit të tij ushtarak.

Ky personazh kokëshkretë në Vidinin e largët tërhoqi në këtë mënyrë vëmendjen e kancelerive shtetërore evropiane dhe Direktorati i Revolucionit Francez mori madje në shqyrtim mundësinë që me ndihmën e vet të përmbyste sulltanin e Bosforit dhe të sillte ate, dmth Pasvantoglun, në fronin e pallatit të Topkapisë.

Pasvantoglu, në krahasim me despotin ortiental Ali Pashë Tepelenën përbënte, si të thuash, një personazh iluminist. Ai u përpoq të fitonte besimin e popullatës së krishterë në territorin që ndodhej nën sundimin e tij e që për një kohë të caktuar shtrihej nga Danubi deri në Adrianopojë. Ai u mundua gjithashtu të vinte në jetë reforma sipas shëmbëlltyrës së Perëndimit dhe disa historianë bullgarë janë të mendimit se sipas të gjitha gjasave ai ka qenë nën ndikimin e frankmasonëve. Gjithsesi mbi kubenë dhe minaren e xhamisë së vogël të ngritur prej tij në Vidin e që ekziston edhe sot e kësaj dite, nuk shihet gjysmëhëna, por një zemër. Mos vallë zemra, e cila është karakteristike për gjithë njerëzit, përbën simbolin e një qëndrimi njerëzor? Këtë nuk e di askush, por megjithatë Bullgaria e sotme ruan të gjallë kujtimin e Pasvantoglus dhe mirëmban xhaminë e tij së bashku me bibliotekën e ngritur prej tij.

Ndonëse është e vërtetë se në fillim të shekullit XIX evropianët janë mrekulluar nga figura të tilla si Ali Pashë Tepelena dhe Osman Pasvantoglu, do të ishte teprim të mëtohej se për pasojë tashma edhe Ballkani ishte përfshirë në fushëpamjen e tyre. Për ta këta personalitete vazhdonin të ishin ende një pjesë e Orientit me të fshehtat e tij, sa kërcënuese aq edhe joshëse.

Sidoqoftë, në këtë interesim u përzie edhe një element i ri. Nëpërmjet kryengritjeve të serbëve dhe, para së gjithash, të grekëve vëmendja e Evropës u drejtua kah prirjet liridashëse të popujve të krishterë të pjesës evropiane të

Perandorisë Osmane dhe rrjedhimisht edhe në drejtim të Ballkanit.

Deri në fillimin e kryengritjes së bullgarëve gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe të luftës ruso-turke të kushtëzuar prej saj, Fuqitë evropiane nuk janë marrë me problemet e Ballkanit, por kanë vazhduar të merren me "çështjen lindore (orientale)". Po ashtu qeveritë evropiane nuk janë përpjekur që, nëpërmjet marrëveshjeve të ndërsjellta, të zgjidhin mosmarrëveshjet dhe problemet ekzistuese në Evropën Juglindore, madje në shumicën e rasteve kanë qenë vetë monarkët, të cilët janë takuar me njëri-tjetrin për zhvillimin e bisedimeve të fshehta në lidhje me rrëmujat ballkanike, siç ka ndodhur në vitin 1876 në Rajhshtad (Reichstadt) në rastin e perandorit Fran Jozef dhe carit Aleksandër II.

Kjo gjendje pësoi ndryshime mbas luftës ruso-turke të viteve 1877/78, mundjes së Turqisë dhe depërtimit të rusëve drejt detit Marmara e përpjekjeve të tyre që me anën e Paqes së Shën Stefanit të krijonin një perandori të madhe bullgare të varur prej tyre. Jo vetëm monarkia e Danubit, por as Anglia, Franca e Italia nuk ishin të prirura të vështronin qetësisht sesi Rusia po e përzinte Perandorinë Osmane nga Evropa dhe po shtrohej këmbëkryq në Ballkan si një Fuqi e pushtetshme. Para së gjithash, anglezët kishin frikë se Rusia do të zinte vend në ngushticat detare midis Detit të Zi dhe Mesdheut dhe do të rrezikonte prej andej lundrimin e lirë në këtë zonë.

Këtyre u shtoheshin edhe lakmitë ekspansioniste të principatave të Serbisë e të Malit të Zi së bashku me kryengritjet dhe trazirat në Bosnje-Hercegovinë, si pasojë e të cilave ishin arratisur në territorin austriak 200'000 njerëz. Nga ana tjetër, princi Milan i Serbisë kërcënonte se do të pushtonte Bosnjen.
Në këto rrethana ministri i jashtëm i Austro-Hungarisë, konti Gyula Andrassy (?), propozoi thirrjen e një konference të Fuqive Evropiane, gjatë së cilës tashma nuk do të kishim të bënim vetëm me një përpjekje tjetër për zgjidhjen e "çështjes lindore" - ndonëse vetëkuptohet se do të debatohej edhe lidhur me pozicionin e Turqisë në Juglindje - por kryesisht për Rendin e Ri në Ballkan. Princi fon Bismark (von Bismarck) nuk e la të binte përtokë këtë nismë, u ofrua të lozë rolin e një "ndërmjetësi të ndershëm" dhe propozoi Berlinin si vend për zhvillimin e këtij tubimi.

Më 13 qershor 1878 shtatë Fuqitë - Rusia dhe Turqia deklaruan gjithashtu më së fundi gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë - u takuan në kryeqytetin e Perandorisë Gjermane. Plot një muaj më vonë kancelarët, ministrat e jashtëm dhe ambasadorët u morën vesh midis tyre për një ndarje të re të pushtetit në territoret ndërmjet Danubit dhe Egjeut si edhe ndërmjet Adriatikut dhe Detit të Zi. Projekti i një perandorie të madhe bullgare nën patronazhin e Rusisë nuk gjeti miratim dhe kështu u krijuan dy njësi shtetërore bullgare në veri dhe në jug të maleve të Ballkanit. Turqia ruajti territoret e saj në Maqedoninë e sotme dhe Serbinë e lashtë, Kosovën e sotme. U njoh ndërkombëtarisht pavarësia shtetërore e principatave të Serbisë e Malit të Zi dhe Austro-Hungarisë iu ngarkua "të pushtojë dhe administrojë" Bosnje-Hercegovinën, e cila mbeti nën sovranitetin turk. Dëshirat e shqiptarëve për një autonomi në kuadrin e Perandorisë Osmane mbetën të shpërfillura.

Po të lihen mënjanë Luftërat Ballkanike të viteve 1912/13, gjatë të cilave Serbia fitoi Kosovën, Serbia, Bullgaria dhe Greqia ndanë midis tyre Maqedoninë dhe Turqia, me përjashtim të një territori të vogël përrreth Adrainopojës, u zhvendos krejtësisht nga Evropa, mund të thuhet se ky Rend është ruajtur në vija të përgjithshme deri në Luftën e Parë Botërore.

Mirëpo rëndësia e Kongresit të Berlinit qëndron kryesisht në faktin se përfshiu përfundimisht Ballkanin në politikën e Fuqive evropiane, dmth jo aq të Fuqive të veçanta, të cilat vepronin secila për llogari të vet, por të një "concert européen", të "një koncerti evropian", pra të një sistemi këshillimesh dhe bashkëpunimi për kapërcimin e krizave dhe për mënjanimin apo dhënien fund të luftërave.

Nuk ka dyshim se koncepti "concert européen" është përmendur qysh në fillim të shekullit XVIII, por megjithate bashkëpunimi i fuqive evropiane në kuptimin e vendosjes së një rendi të qëndrueshëm në zonat e krizave arrin pikën e tij kulmore me Kongresin e Berlinit. Gjatë kësaj periudhe edhe koncepti i Ballkanit zë përfundimisht vendin e tij në ndërgjegjen politike evropiane. Mjafton të kujtojmë shprehjen e Bismarkut, se Ballkani nuk vlen as sa kockat e një grenadieri të veçantë nga Pomerania.

Përveç kësaj, gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX Ballkani filloi të paraqesë interes edhe për shtëpitë princërore gjermane. Hapin e parë në këtë drejtim e hodhën Vitelsbahët (Wittelsbacher), të cilët qysh në vitin 1832, mbas njohjes ndërkombëtare të Greqisë së pavarur, dërguan në Greqi princin ende të mitur Oto fon Bajern (Otto von Bayern), i cili sundoi atje fillimisht si regjent dhe pastaj me titullin mbreti Oto I deri në shkurorëzimin e tij më 1862. Ai u pasua nga princi Vilhelm i Danimarkës, i quajtur Gjergji I, "mbret i helenëve".

Në fronin e Rumanisë, së krijuar në vitin 1859 nga dy principatat e Vllahisë dhe Moldavisë, është ngjitur qysh në vitin 1866 Karl fon Hohencoler-Sigmaringen fillimisht si princ e mbas vitit 1881 si mbreti Karol I. Princit gjerman froni në fjalë nuk i kishte rënë për hise si pasojë e makinacioneve të Fuqive të Mëdha, mbasi vetë rumunët e kishin zgjedhur ate si sundimtarin e tyre me anën e një referendumi.

Më e ndërlikuara nga të gjitha ka qenë zgjedhja e sundimtarit të Bullgarisë. Fillimisht rusët caktuan si princ të Bullgarisë Aleksandër fon Batenbergun, një nip të car Aleksandrit II, por hoqën dorë prej tij kur vunë re se ai kërkonte pavarësi të madhe. Ai u detyrua të abdikojë dhe të dërguarit bullgarë nuk e patën të lehtë për të gjetur pranë oborreve mbretërore evropiane një kandidat, i cili të ishte i pëlqyeshëm si për rusët ashtu edhe për Fuqitë Evropiane. Së fundi princi Ferdinad fon Sahsen-Koburg-Gota u tregua i gatshëm të ngjitej në fronin bullgar, në fillim si princ e pastaj mbas vitit 1908 si mbret, përkatësisht si car.

Fuqitë Evropiane deshën të vendosnin edhe në Shqipëri si sovran të pavarur nga forcat politike të vendit pinjollin e një shtëpie princërore gjermane. Përzgjedhja e tyre i takoi princit hesian Vilhelm Vid (Wilhelm zu Wied), i cili pak para shpërthimit të Luftës së Parë Botërore e braktisi këtë vend të vështirë për t'u qeverisur, pothuajse menjëherë mbas ardhjes së tij.

Kështu pra, edhe në përzgjedhjen e dinastive për pjesën më të madhe të shteteve kombëtare që fituan pavarësinë, gjen pasqyrim interesi evropian për Ballkanin, këtë oborr të përparmë të Evropës.

Si e shohin vetveten popujt e Ballkanit

Në vjeshtën e vitit 1999 bëri bujë të madhe një libër me titullin "Shpikja e Ballkanit - paragjykimi komod i Evropës". Vallë a do t'a ketë miratuar autorja, historiania bullgare Maria Todorova që jeton dhe studjon në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, këtë titull në gjuhën gjermane? Zor se mund të pranohet një gjë e tillë, mbasi titulli i veprës së saj tepër të pëlqyeshme të shkruar në anglisht është "Imagining the Balkans" dhe kjo është diçka krejtësisht tjetër nga "shpikja". Përveç kësaj në asnjë vend të këtij libri nuk mund të ndeshesh me mendimin, se Ballkani përbën një shpikje dhe një paragjykim komod të Evropës. Për përkthimin dhe redaktimin nga botuesi gjerman, me sa duket, nuk duhet të jetë aktivizuar ndonjë njohës i problemeve të Ballkanit. Gjithsesi libri përmban këtë fjali: "Megjithë faktin që disa e pranojnë ballkanësinë e tyre, edhe pse në mënyrë të druajtur, ndërsa të tjerët mohojnë aktivisht çdo lidhje me te, të gjitha kombet e Ballkanit kanë të përbashkët konsensusin e qartë se Ballkani ekziston, se ka diçka që mund të përkufizohet si Ballkan, ndonëse mund të përbëjë një kategori apo rajon të padëshiruar."

Kjo çështje tregon se sa të vështirë e kemi ende ne në pjesën tjetër të Evropës për të kuptuar Ballkanin, shtetet e tij, popujt e tij dhe njerëzit e tij. E një gjë e tillë ngjet megjithë bollëkun e librave të udhëtimeve dhe atyre me temë politike të botuara në Perëndim, e kryesisht në vendet anglosaksone qysh në gjysmën e dytë të shekullit XIX. Ndonëse jo të gjithë autorët i janë përmbajtur me këtë rast fjalëve lapidare të Moltkes: "Udhëtari i përkryer duhet të ndjekë një rrugë të mesme midis teprisë dhe mangësisë së entuziazmit". Feldmarshalli i ardhshëm prusian dinte çfarë fliste, mbasi qysh në vitet e rinisë së tij, në cilësinë e inspektorit të ushtrisë turke, kishte qenë i interesuar për të udhëtuar nëpër Ballkan, i cili asokohe ndodhej ende nën sundimin osman.

Këtu mund të shtrohet tani pyetja: si shpjegohet atëhere çështja e tablosë që ka krijuar Perëndimi për Ballkanin? Vallë a është e vërtetë që kjo tablo është imponuar prej klisheve dhe çfarë lidhjesh ekzistojnë midis këtyre klisheve dhe njëmendësisë? Duke patur parasysh shumëllojshmëritë etnike, historike, fetare e të qytetërimeve të Evropës Juglindore, a ekziston vallë diçka, që mund të cilësohet si njëmendësi e përgjithshme ballkanike? Klishetë e rëndomta janë: "ballkanasit" janë të prapambetur, përtacë, të paparashikueshëm, arrogantë, dinakë dhe dhelpërakë, brutalë ndaj më të dobtëve dhe ndaj tyre nuk duhet patur besim. Nuk ka dyshim që në Perëndim ndeshesh shpeshherë me një tablo të tillë të Ballkanit dhe të njerëzve të tij, por a është kjo një "shpikje" e Perëndimit? Kurrësesi. Mjafton të kujtojmë vetëm figurat e krijuara prej shkrimtarëve për të tipizuar Ballkanin, si ate të Baj Ganos së bullgarit Aleko Konstandinov, apo figurën satirike të oligarkisë së re të babëzitur të rumunit Jon Lluka Karaxhale, si edhe ate të parvenysë së paskrupullt të një shteti kombëtar të pavarur të serbit Branko Nushiç.

Këto figura, që e kanë zanafillën në fantazinë dhe vrojtimet e shkrimtarëve kombëtarë e kozmopolitë të Sofies, Bukureshtit e Beogradit, na japin një tablo të larmishme të veçantive kombëtare të popujve të Ballkanit. Analiza psikologjike e vetvetes nuk përbën sigurisht pikën e tyre të fortë. Në këtë vështrim bën përjashtim filozofi dhe etnopsikologu serb Vladimir Dvornikoviç, i cili ka shkruar në vitet tridhjetë të shekullit të kaluar një "karakterologji të jugosllavëve". Ky shkim ishte lënë në harresë për një kohë të gjatë dhe është ribotuar vetëm para dhjetë vjetësh.

Në këtë vepër Dvornikoviçi, një mendimtar kokëshkretë, mbështetur në situatën e asokohshme të vendit të tij, flet në mënyrë të përmbledhur për "jugosllavët" duke mos bërë dallim ndërmjet serbëve e kroatëve si edhe ndërmjet boshnjakëve e maqedonasve. Ai dallon e shumta Jugosllavinë e Veriut nga ajo e Jugut dhe i përshkruan të gjithë si heroikë, luftarakë, me humor dhe të nënshtruar ndaj një kulture patriakale fisnore. Në anën tjetër, thotë se ata janë kryeneç e të vetëkënaqur, të prirur ndaj ligësisë dhe etjes për shpagim. Në thellësinë e shpirtit të tyre rëndon një vetëdije melankolike, falë së cilës ata janë të aftë të ndryshojnë befasisht gjendjen e tyre shpirtërore, duke kaluar nga depresionet në ekstim dhe nga një egocentrizëm brutal në një lëndueshmëri të skajshme, pra të hidhen nga një ekstrem moral në tjetrin.

Në këto rrethana shtrohet pyetja: a mund të quhet e mjaftueshme kjo tablo e njeriut të Ballkanit siç na e paraqesin klishetë dhe shkrimet socialkritike të intelektualëve të Sofies, Bukureshtit e Beogradit, si edhe disa studime të pakta etnopsikologjike?

Kjo është e pamundur dhe e padëshirueshme, mbasi njëmendësia e Ballkanit është shumë më e ndërlikuar nga sa besohet përgjithësisht. Në vetë qëndrimin që mbahet ndaj konceptit "Ballkan" spikasin dallime të jashtëzakonshme në trekëndëshin midis Zagrebit, Bukureshtit e Athinës. Kroatët nuk pranojnë kurrsesi të jenë pjesë e Ballkanit dhe e vendosin veten në Evropën Qendrore. Rumunëve u vjen zëri vetëm kur flitet për rrënjët e tyre latino-romane dhe kur u duhet të bëjnë fjalë për Ballkanin në përgjithësi, i shmangen këtij termi dhe flasin për studime e institucione të Evropës Juglindore. Serbët mbajnë ndaj konceptit të Ballkanit një qëndrim që i afrohet më tepër neutralitetit, ndërsa grekët e gjejnë identitetin e tyre kulturor dhe historik në zonën e Egjeut. Vetëm bullgarët pranojnë pa asnjë mëdyshje se janë pjesë e Ballkanit dhe ç'është e vërteta përmes territorit të tyre shtrihet nga perëndimi në lindje ai masiv malor që i jep emrin e tij gjithë

gadishullit. Bullgarët, gjithsesi, nuk e thërrasin këtë masiv me emrin që buron nga koha e Turqisë, por e quajnë Stara-Planina, dmth malet e lashta dhe, në anën tjetër, linja e tyre e fluturimit, pa iu trembur asociacioneve që mund të dëmtonin veprimtarinë e saj profesionale, mban emrin "Balkanair", ndërsa organizata e tyre turistike quhet "Balkan-Turist". Shqiptarët, së fundi, mbajnë një qëndrim të diferencuar ndaj Ballkanit; nga njëra anë, pohojnë me krenari se janë pasardhësit e ilirëve dhe për pasojë edhe populli më i vjetër i Ballkanit dhe, në anën tjetër, i kushtojnë rëndësi mospërzjerjes së tyre me popujt sllavë të Ballkanit dhe kërkojnë të kundrohen si një popull tejet i lashtë evropian.

Ne mund t'a thellojmë akoma më tepër këtë temë, duke u përpjekur të nxjerrim në pah, se deri në çfarë shkalle dallohen popujt e veçantë nga pikëpamja e karakterit dhe qëndrimit të tyre social. Kjo do të ishte shumë joshëse, por do të na largonte më shumë sesa duhet prej temës sonë, dmth tablosë së Perëndimit për Ballkanin. Në fakt këtu bëhet fjalë për konsolidimin e Ballkanit mbi bazën e Paktit të Qëndrueshmërisë (Stabilitetit); pra, praktikisht për të sjellë më afër Bashkimit Evropian dhe vlerave të tij demokratiko-politike, të shtetit të së drejtës, të ekonomisë së tregut dhe të të drejtave qytetare të njeriut, shtetet e reja kombëtare të dala nga shpërbërja e Jugosllavisë së bashku me fqinjët e tyre. Shì për këtë arsye këtu duhet bërë fjalë më tepër mbi veçoritë e tyre të përbashkëta në raport me botën joballkanike.

Ballkanasit, për shembull, janë të prirur t'a kundrojnë botën në prizmin e skemës mik-armik. Ata e kanë të vështirë të tregojnë mirëkuptim ndaj kritikës që u bëhet prej një pale, të cilën deri atëhere e kanë kundruar si mike të tyre; fillimisht ata bëjnë sikur nuk ka ndodhur asgjë dhe, në rast të vazhdimit të saj e konsiderojnë ate si një qëndrim armiqësor. Këtë gjë e ka vënë re tek shqiptarët para një shekulli udhëtarja e guximshme angleze Meri Edit Durham, ndonëse në një farë kuptimi do të ishte e vlefshme edhe për popujt e tjerë të Ballkanit.

Një veçori e përbashkët e gjithë njerëzve të Ballkanit është, gjithashtu, se nuk i vënë vesh me vëmendje të tjerëve. Ata janë të gjithë egocentristë dhe vetëm në raste të veçanta tregohen të gatshëm të dëgjojnë argumentet e palës kundërshtare. Në qoftë se kjo do të ndërlidhet edhe me një cilësi tjetër të tyre, dmth për të mos e kundërshtuar mikun, atëhere nuk është vështirë të merret me mend se sa keqkuptime mund të lindin gjatë kontakteve dhe bashkëbisedimeve. Në kuadrin e Paktit të Qëndrueshmërisë (Stabilitetit), si edhe të anëtarësimit të vendeve të Ballkanit në Bashkimin Evropian negociatorët perëndimorë do të kenë rast të vënë re edhe diçka tjetër: shpeshherë ata do të ballafaqohen me partnerë shumë të kulturuar, të zgjuar e jashtëzakonisht kompetentë në lëmin profesional.

Mirëpo, kur rezultatet e bashkëbisedimeve përkatëse duhen mbartur në rrafshin brendashtetëror, në ingranazhet burokratike ballkanase fillojnë të futen kokërriza rëre. Kjo ndodh për dy arsye. Shpërbërja e Perandorisë Osmane dhe tërheqja e turqve nga Ballkani pati për pasojë prerjen e urave me traditën shekullore perandorake osmano-bizantine në të cilën nuk ishin përfshirë popujt e krishterë të Ballkanit. Mbasi krijuan shtetet e tyre kombëtare ata duhet të ngrinin fillimisht strukturat e tyre administrative, duke u mbështetur tek shtetet e Evropës Qendrore dhe Perëndimore. Mirëpo për këtë gjë ata patën në dispozicion vetëm disa dhjetëvjeçar të pakët. Më pas erdhi komunizmi, i cili shkatërroi burokracinë dhe e zëvëndësoi atë me strukturat e funksionarëve të tij që punonin duke u mbështetur në parime krejtësisht të tjera. Këtë cen të dyfishtë shtetet e Ballkanit ende nuk e kanë kapërcyer kurrsesi. Për këtë arsye aparatet e tyre burokratike në pjesën më të madhe janë jokompetente, të plogështa dhe të korruptueshme.

MBAS DY LUFTËRAVE BOTËRORE:

Lufta e Parë Botërore e ka zanafillën e saj në Ballkan, bash tek të shtënat vdekjeprurëse të shkrehura më 28 qershor 1914 në Sarajevë nga i riu serb Gavrilo Princip mbi trashëgimtarin e fronit austriak Franc Ferdinandin dhe bashkëshorten e tij.

Mbas mbarimit të luftës, pothuajse katër vjet më vonë, nga skena politike e Ballkanit ishin zhdukur tri Fuqi të Mëdha: Austro-Hungaria qe shpërbërë, në Rusi bolshevikët kishin hequr qafe carin dhe rrëmbyer për vete pushtetin, ndërsa në Bosfor nuk mbretëronte më një sulltan dhe republika qemaliste epiqendrën e saj e kishte zhvendosur në Anadoll. Nuk ekzistonte më një "Koncert evropian", rendi i mbasluftës, duke përfshirë edhe Ballkanin, përcaktohej nga Antanta ngadhnjyese me në krye Francën nëpërmjet traktateve të lagjes periferike të Parisit. Në qendër të rendit të ri shtetëror të Ballkanit ndodhej një krijesë e re shtetërore: shteti shumëpopujsh i Jugosllavisë.

Fillimisht ky shtet nuk quhej Jugosllavi, por "Mbretëria e Serbëve, Kroatëve e Sllovenëve" (SHS). Ai mori emrin Jugosllavi më vonë në janar të vitit 1929, kur mbreti Aleksandër shfuqizoi kushtetutën e deriatëhershme dhe shpalli diktaturën mbretërore. Për t'i hedhur mbi shpatulla autokracisë së shtëpisë mbretërore serbe, ushtrisë serbe dhe burokracisë serbe në shtetin e ri një mantel sllavojugor? Dhe për t'u treguar kështu dashamirës ndaj serbëve, kroatëve e sllovenëve të territoreve të Monarkisë së dikurshme të Danubit?

Arsyeja qëndronte në faktin që tek këto të fundit, në kundërshtim me serbët e Mbretërisë së Serbisë, "jugosllavizmi" kishte hedhur rrënje të thella qysh në mesin e shekullit XIX. Kokat e tyre më të shquara ëndërronin për një bashkim shtetëror të të gjithë popujve sllavojugor (me përjashtim të bullgarëve). Por vetëm me kusht që ky t'a kishte epiqendrën e tij në territoret relativisht të zhvilluara sllavojugore të Monarkisë së Danubit dhe jo në Serbinë "ballkanase" të prapambetur nga pikëpamja e qytetërimit. Përveç kësaj, këta përfaqësues të "jugosllavizmit" e mendonin shtetin e ardhshëm të përbashkët si një shtet federal kombtarisht të barazpeshuar dhe jo si një shtet unitar të qeverisur në mënyrë të centralizuar nga Beogradi e të mbizotëruar prej serbëve.

Në Jugosllavi nuk kishin gjetur zgjidhje shumë çështje të qenësishme të

bashkëjetesës së ardhshme të popujve sllavojugorë, të cilët, ç'është e vërteta, kanë patur veçori të përbashkëta etnike, por njëkohësisht edhe fate të ndryshme historike, kulturore e fetare. Vetë kushtetuta e shtetit të ri ishte hedhur poshtë nga partia më e fuqishme kroate, Partia Fshatare e udhëheqësit karizmatik Stjepan Radiç.

E drejta e ekzistencës së kësaj Jugosllavie, me që ra fjala, ishte vënë qysh në fillim në pikëpyetje nga shumë drejtime të ndryshme. Një gjë e tillë kërkohej nga shumica e kroatëve për shkak të mbizotërimit serb, por edhe prej komunistëve, të cilët deri në vitin 1935, duke i mbetur besnikë udhëzimeve të Moskës, kërkonin shpartallimin e "Jugosllavisë së Versajës" dhe shkrirjen e saj në shtete të veçanta kombëtare. Vetëm mbas marrjes së pushtetit në Gjermani nga Hitleri ata, duke i mbetur rishtas besnikë udhëzimeve të Moskës, e drodhën në drejtim të një vije "jugosllave".

Tashti shtrohet pyetja: si qëndronin punët me këtë Jugosllavi të krijuar prej Antantës gjatë periudhës midis viteve 1918 e 1941? Cilat ishin lidhjet e saj evropiane?

Ato ishin mjaft të ngushta. Kjo Jugosllavi krijoi së bashku me Rumaninë e Çekosllovakinë një Antantë të Vogël, synimi i së cilës ishte, para së gjithash, t'i vinte llozin derës së revizionizmit hungarez. Nëpërmjet traktateve të dyanshme, të lidhura nga Mbretëria e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve (SHS), përkatësisht Jugosllavia, si edhe Rumania dhe Republika Çekosllovake me Francën, Antanta e Vogël ishte lidhur fuqimisht me fitimtarët e Luftës së Parë Botërore.

A përbënte kjo lidhje në rastin e Jugosllavisë një dukuri "evropianizuese"? Në kuptimin e përshtatjes së strukturave të saj të brendshme ndaj demokracisë, shtetit të së drejtës, lirive qytetare dhe tolerancës? Vështirë! Dhe arsyeja është se qeverisja në Jugosllavi, po ashtu si në Rumani e në Bullgari, megjithë ekzistencën e një demokracie formale dhe një sistemi shumëpartiak, kishte një karakter pak a shumë autoritar. Fakti që asnjë nga 23 qeveritë jugosllave që kanë ushtruar funksionet e tyre gjatë periudhës midis viteve 1918 dhe 1929 (shpallja e diktaturës mbretërore), nuk është rrëzuar nëpërmjet një votimi të bërë në Parlament, por të gjitha kanë qenë të detyruara të japin dorëheqjen si pasojë e intrigave të oborrit e të mbretit, përbën një tregues të qartë të gjendjes së vërtetë politike të vendit. Pa përmendur me këtë rast format e ndryshme të zënkave në Parlament, të cilat arritën më së fundi pikën e tyre kulmore me pushkatimin e udhëheqësit të fshatarëve kroatë Stjepan Radiç dhe të deputetëve të tjerë kroatë nga deputeti malazez Punisha Raçiç.

Mbas vrasjes së mbretit Aleksandër në tetor të vitit 1934 në Marsejë nga terroristë kroatë e bullgarë, si edhe si pasojë e marrjes së pushtetit nga Hitleri në Gjermani, lidhjet me sistemin e mbasluftës të Fuqive ngadhnjyese të Luftës së Parë Botërore u dobësuan. Me "Rajhun e Tretë" u vendosën në radhë të parë lidhje të ngushta tregtare. Në fillim të Luftës së Dytë Botërore Gjermania zinte vendin e parë në tregtinë me Jugosllavinë.

Edhe në rrafshin e politikës së brendshme u bënë përçapje për t'u shkëputur nga metodat e sundimit të mbretit Aleksandër dhe para së gjithash për të arritur një paqtim me kroatët. Në gushtin e vitit 1939, nën patronazhin e regjentit Paul, u mundësua arritja e të famshmit "sporazum", "pajtimit", nëpërmjet të cilit serbët dhe kroatët ndanin midis tyre sundimin e shtetit po ashtu, siç kishin vepruar edhe shtëpia mbretërore e Habsburgëve dhe hungarezët me "barazimin" e vitit 1867.

Ky "sporazum" është përmbushur prapëseprapë vetëm në fazat e tij fillestare. Menjëherë mbas nënshkrimit të tij plasi Lufta e Dytë Botërore dhe shqetësimet e udhëheqjes jugosllave iu kushtuan problemeve të tjera më të ngutshme. Veç kësaj, kjo marrëveshje nuk është ratifikuar asnjëherë nga ndonjë instancë parlamentare.

Në pranverën e vitit 1941 personave përgjegjës të Beogradit iu desh të pozicionoheshin midis Fuqive të Boshtit dhe Aleatëve. Më 25 mars Jugosllavia, duke iu përkulur trysnisë së Hitlerit, u antarësua në Paktin e Tri Fuqive. Dy ditë më vonë një përbetim i përgjithshëm rrëzoi regjentin dhe Qeverinë Cvetkoviç, kurorëzoi trashëgimtarin e fronit Peter si mbret me emërin Pjetri II dhe vendosi në krye të qeverisë gjeneralin e forcave ajrore Simoviç.

Ky grusht shteti i ndërmarrë në bashkëpunim të ngushtë me kundërzbulimin britanik e rrokullisi Jugosllavinë në luftë. Hitleri, kur pa se kështu po i rrezikoheshin qoftë edhe përkohësisht planet e tij për mësymjen e Bashkimit Sovjetik, sulmoi papritur më 6 prill Jugosllavinë dhe shpartalloi brenda njëmbëdhjetë ditëve ushtrinë e saj e bashkë me te edhe shtetin jugosllav.

Jugosllavia u ngjall rishtas nga hiri i Luftës së Dytë Botërore brenda kufijve të saj të vjetër, madje e zgjeruar me territoret buzë Adriatikut, të cilat në periudhën midis dy luftërave botërore i kishin takuar Italisë. Mirëpo nga pikëpamja politike kjo Jugosllavi e dytë nuk kishte më lidhje me të parën. Komunistët nën udhëheqjen e Titos e përzunë dinastinë e Karagjergjoviçve, mënjanuan fizikisht dhe politikisht shtresat udhëheqëse të Jugosllavisë së vjetër dhe hë për hë e integruan vendin fuqimisht në "kampin socialist". Ky fat i takoi, me përjashtim të Greqisë, edhe vendeve të tjera të Ballkanit, Shqipërisë, Bullgarisë e Rumanisë, po ashtu si edhe Hungarisë. Midis këtyre shteteve dhe Evropës u lëshua Perdja e Hekurt.

Kjo Perde u shpua gjithsesi në një farë mase nga konflikti i viteve 1948/49 midis Stalinit dhe Titos dhe përjashtimi i Jugosllavisë nga bashkësia e shteteve komuniste. Jugosllavia në të vërtetë mbeti edhe më tej nën sundimin komunist, por u përpoq t'i shmangej bllokadës ekonomike të Bllokut të Lindjes nëpërmjet një afrimi me Fuqitë Perëndimore dhe mori gjatë viteve pesëdhjetë, kryesisht nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ndihma ekonomike dhe ushtarake, të cilat kishin për qëllim t'a mbronin vendin nga ndonjë mësymje e sovjetikëve ose t'i pritnin rrugën vënies së tij nën presion. Mandej, duke filluar nga mesi i viteve pesëdhjetë, Tito ndoqi rrugën e shkëputjes nga Blloqet dhe së bashku me vendet më të

rëndësishme të Afrikës dhe pjesërisht edhe të Azisë krijoi një kamp të tretë midis Blloqeve të mëdha. Jugosllavia luajti një rol të rëndësishëm midis këtyre vendeve të papërfshira në Blloqet edhe pse ky "kamp" nuk paraqiste në rrafshin e politikës botërore atë fuqi, për të cilën kishin ëndërruar krahas Titos edhe presidentët e shteteve të Indisë, Egjyptit e Indonezisë.

Jugosllavia e qeverisur prej komunistëve realizoi, megjithate, duke filluar nga gjysma e dytë e viteve gjashtëdhjetë deri mbas vdekjes së Titos në vitin 1980, një farë afrimi me Evropën, ndonëse ky afrim kishte më tepër karakter ekonomik sesa politik. Ajo hapi kufijtë e saj, ç'është e vërteta, me një synim të dyfishtë, dmth për turistët që vinin nga Perëndimi, të cilët e shndërruan, para së gjithash, Dalmacinë në një vend të pëlqyer udhëtimi e pushimi dhe në drejtimin e anasjelltë për dhjetra mijëra jugosllavë të papunë, të cilët gjetën punë dhe mëditje si "punëtorë emigrant" në botën e jashtme perëndimore.

Këto ishin në fakt caqet maksimale të "evropianizimit" të shtetit të Titos, mbasi megjithë ndihmën ushtarake të dhënë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbas konfliktit me Stalinin, megjithë politikën e mospërfshirjes në Blloqe dhe të një afrimi të përllogaritur të vendit ndaj Perëndimit e të një farë liberalizmi kulturor të kushtëzuar prej tij, Jugosllavia mbetej një shtet me një qeverisje të rreptë komuniste. Shmangiet nga vija e përgjithshme politike e Partisë ishin të palejuara, ekonomia megjithë vetadministrimin punëtor vazhdonte të ishte fuqimisht në duart e Partisë dhe policia shtetërore (UDBA) edhe mbas rrëzimit të Ministrit të plotfuqishëm e të frikshëm të policisë, Aleksandër Rankoviç, në qershor të vitit 1966 vazhdonte të përligjte plotësisht praninë e saj.

Në Jugosllavinë e Titos nuk mund të bëhej fjalë për një afrim ndaj vlerave demokratike të Perëndimit e ndaj pluralizmit politik, si edhe për një respektim të të drejtave qytetare e të njeriut. Nuk mund të bëhej fjalë edhe gjatë dhjetëvjeçarit që pasoi vdekjen e tij, si edhe atëhere kur u përmbys sistemi komunist në Evropën Lindore, Qëndrore dhe Jugore. Meqenëse në Serbi, në republikën më të rëndësishme dhe më të madhe jugosllave, sundimtarët komunistë mbetën në pushtet dhe u bashkuan në një "aleancë të kobshme nacionaliste" me antikomunistët dhe disidentët. Parulla e ditës ishte: më parë zgjidhja e çështjes serbe, pastaj demokratizimi;+ sepse, siç mendonin në radhë të parë nacionalistët serbë madje deri në qarqet më të ngritura intelektuale, Serbia dhe serbët ishin lënë pasdore në Jugosllavinë e Titos, për faktin se vetëm Republika e Serbisë kishte patur dy provinca autonome, Vojvodinën dhe Kosovën.

Mënjanimi i autonomisë së tyre dhe zgjidhja e "çështjes serbe", dmth bashkimi i të gjithë serbëve në një shtet ("Serbi është atje ku ndodhet qoftë edhe një varr i vetëm serb"), ishte synimi që i vuri vetes Presidenti serb dhe më vonë jugosllav, Sllobodan Millosheviç, qoftë duke përdorur edhe dhunën dhe luftën, siç pati rast t'a dëshmojë në Kroaci, Bosnje-Hercegovinë e Kosovë.

Kjo solli për pasojë shkatërrimin e Jugosllavisë, mbasi popujt e tjerë nuk deshën t'i nënshtroheshin Millosheviçit dhe politikës së tij serbomadhe dhe parapëlqyen pavarësinë.

Pra, mos vallë Jugosllavia nuk ka përbërë gjithsesi një faktor qëndrueshmërie, madje, më saktësisht, ka qenë një gabim i historisë? Jo, sipas mendimit të Mirko Tepavacit, Ministrit të Jashtëm jugosllav të periudhës nga 1969 deri më 1972, i cili dha dorëheqje me nismën e tij, mbasi nuk qe në gjendje të ndiqte Titon. "Jugosllavia nuk ka qenë një gabim i historisë", i ka thënë ai gjatë një bisede kryeredaktorit të mëparshëm të gazetës "Politika" Aleksander Nenadoviç, "ajo ka qenë historia e gabimeve të bëra ndaj qytetërimit, tolerancës e kulturës. Çështja serbe, qoftë edhe sikur të kishte qenë kaq akute, nuk duhej shtruar si një çështje shtetërore e territoriale, por si një çështje e demokracisë dhe qytetërimit. Në qoftë se Jugosllavia do të kishte qëndruar mbi këmbë më të shëndetshme, nuk do të ishte shpërbërë deri në themelet e saj dhe madje në gërmadha e gjak.

Jugosllavia nuk ka vdekur nga një vdekje natyrore, atë e kanë vrarë". Dhe më tej: "Bashkësia ndërkombëtare nuk ka patur detyrim të shpëtojë Jugosllavinë, por duhet të kujdesej për të përmbushur në forma të qytetëruara vendimet e popujve jugosllavë mbi udhët e tyre të mëtejshme. Kjo nuk ka qenë një gjë e lehtë, por të gjitha zgjidhjet e tjera kanë rezultuar më të vështira e më të shtrenjta, si për Jugosllavinë ashtu edhe për botën."

PROBLEMI KYÇ SERBIA

Në rast se dëshirojmë që Paktit i Qëndrueshmërisë (Stabilitetit) të jetë i suksesshëm - dhe në Perëndim ekziston një përputhje e përgjithshme mendimesh për këtë çështje - atëhere duhet zgjidhur problemi i Serbisë. Në fund të fundit Serbia e përkatësisht Republika Federale Jugosllave me 8'300'000 banorët e saj (pa llogaritur Kosovën) është shteti më i madh në trevën e Jugosllavisë së dikurshme. Potenciali i saj ekonomik e kalon ate të shteteve të tjera postjugosllave.

Serbia zë, përveç kësaj, një pozitë të rëndësishme gjeostrategjike në Ballkan. Ajo kontrollon si rrugën ujore të Danubit nga Evropa Qendrore në drejtim të juglindjes (Bullgaria e Rumania) ashtu edhe rrugën tokësore (hekurudhë e autostradë), nga njëra anë, prej Evropës Qëndrore në drejtim të Bullgarisë e Turqisë dhe, në anën tjetër, nëpërmjet Maqedonisë drejt Egjeut.

Mirëpo Serbia ose Republika Federale e Jugosllavisë (RFJ) nuk mund të përfshihet në Paktin e Qëndrueshmërisë (Stabilitetit) pa zgjidhur më parë të paktën tre probleme të rëndësishme. I pari: ose RFJ-ja do të vihet mbi baza të reja, ose do të shpërbëhët përfundimisht. Me këtë është i lidhur pazgjidhmërisht edhe, i dyti, dmth raporti Serbi - Mali i Zi, i cili ka një domethënie pothuajse ekzistenciale për të dy palët. Së fundi, Serbia nuk mund të përfshihet në Paktin e Qëndrueshmërisë (Stabilitetit) e të përbëjë kështu një bazë të qëndrueshme për Rendin e Ri në Ballkan, sa kohë që në Beograd do të vazhdojë të qeverisë Sllobodan Millosheviçi,

të cilin Gjykata për të Drejtat e Njeriut në Hagë kërkon t'a arrestojë si kriminel lufte të hamendësuar. Askush nuk mund të zhvillojë traktativa me të dhe bashkësia ndërkombëtare nuk ka mundësi t'i shfuqizojë sanksionet e saj, sa kohë që ai ndodhet në pushtet. Duke qenë se Millosheviçi nuk tërhiqet vullnetarisht e regjimi i tij për më tepër po përforcon dhunën në vend dhe opozita, nga ana tjetër, është tepër e dobët për t'a detyruar të japë dorëheqje, instancat e BE-së të Paktit të Qëndrueshmërisë (Stabilitetit) do të jenë sigurisht të detyruara t'a lënë përkohësisht mënjanë këtë çështje.

Republika Federale e Jugosllavisë - arrogancë dhe mashtrim

Republika Federale e Jugosllavisë (Savezna Republika Jugoslavije) përbënte qysh në fillim një krijesë arrogante e një mashtrim politik. Ajo ka qenë një krijesë arrogante, mbasi mëtonte të mbetej në vazhdimësinë e Republikës Federale Socialiste të Jugosllavisë së shpërbërë dhe për pasojë të ruante vendin e saj në OKB, në OSBE, në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në organizatat e tjera ndërkombëtare. Kështu, në qoftë se një gjë e tillë do të ishte pranuar prej këtyre organizatave, atëhere shteteve të tjera të pavarura të dala nga strukturat e Jugosllavisë do t'u vihej damka e "sezecionisteve" (?). Megjithate pushtetarët e Beogradit nuk ia arritën qëllimit, ndonëse Perëndimi në periudha të caktuara kohe është treguar tepër jokonsekuent, duke pranuar përfaqësuesit e Republikës Federale Jugosllave si partnerë në bashkëbisedime, siç ka ndodhur, për shembull, me presidentin e RFJ-së, shkrimtarin e njohur Dobrica Kosiç dhe kryeministrin e saj Milan Paniç. Fakti që këta nuk kanë qenë gjë tjetër veçse kukulla në duart e Presidentit të asokohshëm të Serbisë Millosheviç u dëshmua kur ai i largoi të dy nga postet e tyre, sapo u treguan të prirur për veprime të pavarura.

Ajo ka qenë një mashtrim, mbasi kjo RFJ-ë nuk ka patur dhe nuk ka në vetvete asgjë "jugosllave" edhe pse ka qenë përbërë dhe përbëhet nga dy republika të Jugosllavisë së dikurshme, dmth nga Serbia dhe Mali i Zi. Mali i Zi është trajtuar qysh në fillim thjesht si një shtojcë e Serbisë, institucionet federale kanë funksionuar vetëm formalisht dhe në të gjithë shtetin kurrkush nuk ka guxuar as edhe të pipëtijë pa miratimin e Millosheviçit. Kjo përbënte edhe arsyen pse Mali i Zi i vogël nën udhëheqjen e Presidentit të tij të ri Milo Gjukanoviç qysh nga dimri i viteve 1997/98 ka treguar një kryeneçësi gjithnjë në rritje, gjë që u pasua nga largimi gjithnjë e më i madh i këtyre dy republikave nga njëra-tjetra.

RFJ-ja nuk ka patur asgjë "jugosllave", po të kihet gjithashtu parasysh fakti se pushtetarët e Beogradit qysh në fillim janë përpjekur t'i shtypin popujt josllav dhe joserb. Ata fshinë autonominë e provincave të Kosovës e Vojvodinës dhe, në rastin e Kosovës, u përpoqën, madje, t'a përzënë nga kjo provincë popullsinë shqiptare që përbënte shumicën. Atyre iu vu kufiri tek thana vetëm falë ndërhyrjes ushtarake të Nato-s.

Në rastin e Vojvodinës shfuqizimi i autonomisë nuk është shoqëruar nga zhvillime aq dramatike, mbasi në këtë provincë serbët përbëjnë shumicën në veri dhe në lindje të Danubit. Nga dy milionë banorët e saj ata përbëjnë 54,4 për qind. Përveç kësaj në Vojvodinë jetojnë edhe grupe të ndryshme të vogla kombëtare, si rumunë, sllovakë, kroatë, etj.

Megjithatë fakti që serbët e krahinave të Sremit, Banatit dhe Baçkas, të cilat formojnë Vojvodinën, qoftë edhe për shkaqe historike, kulturore e politike i kushtojnë rëndësi pavarësisë nga Beogradi, ka rëndësi vendimtare. Në fund të fundit, midis popujve të Ballkanit kanë qenë ata që u "evropianizuan" të parët, duke qenë se perandorët e Habsburgëve në fund të shekullit XVII mbas eksodit të tyre nga territoret e Serbisë Jugore që sundoheshin prej turqve u ofruan një vend të për të futur kryet.

Autonomi kërkojnë tekembramja edhe myslimanët e të ashtuquajturit Sanxhak. Ky është problem i ndërlikuar, mbasi Sanxhaku - një krijesë e Kongresit të Berlinit të vitit 1878 për të ndarë nga njeri-tjetri Serbinë dhe Malin e Zi të dikurshëm - nuk përbën sot një njësi administrative të veçantë. Qysh prej Luftës së Parë Botërore ai është ndarë midis Serbisë dhe Malit të Zi. Myslimanët që banojnë atje - qendra e tyre është Novi Pazari - përbëjnë 60 deri 70 për qind të 500'000 banorëve të kësaj treve. Ata e quajnë veten e tyre boshnjakë. Serbët dhe malazezët i trajtojnë ata si një trup të huaj prandaj, qysh nga lufta ndërjugosllave, ata kanë rënë pre të rapresaljeve të shumta. Edhe sot e kësaj dite, megjithë ndërhyrjet e shumta, nuk është sqaruar ende zhdukja e dy grupeve të myslimanëve nga kjo krahinë. Njëri prej tyre është grabitur me një autobus në afërsi të kufirit me Bosnjen, ndërsa tjetri është zbritur nga treni i linjës Beograd-Bar në një stacion që ndodhet në territorin boshnjak. Me sa duket ata janë dërguar në mënyrë të dhunshme në Republikën e sotme Srbska dhe janë vrarë pastaj atje; gjithsesi deri sot mungon çdo gjurmë e tyre.

Megjithatë këto probleme në krahasim me Malin e Zi mund të cilësohen thuajse të një rëndësie më të vogël. Në qoftë se midis Serbisë dhe Malit të Zi nuk do të arrihet një rregullim i ri ndërjugosllav i qëndrimeve të ndërsjellta, atëhere fati i RFJ-së edhe formalisht mund të quhet i vulosur.

Marrëdhëniet ndërmjet republikave

Autonomi kërkojnë tekembramja edhe myslimanët e të ashtuquajturit Sanxhak. Ky është problem i ndërlikuar, mbasi Sanxhaku - një krijesë e Kongresit të Berlinit të vitit 1878 për të ndarë nga njeri-tjetri Serbinë dhe Malin e Zi të dikurshëm - nuk përbën sot një njësi administrative të veçantë. Qysh prej Luftës së Parë Botërore ai është ndarë midis Serbisë dhe Malit të Zi. Myslimanët që banojnë atje - qendra e tyre është Novi Pazari - përbëjnë 60 deri 70 për qind të 500'000 banorëve të kësaj treve. Ata e quajnë veten e tyre boshnjakë. Serbët dhe malazezët i trajtojnë ata si një trup të huaj prandaj, qysh nga lufta ndërjugosllave, ata kanë rënë pre të rapresaljeve të shumta. Edhe sot e kësaj dite, megjithë ndërhyrjet e shumta, nuk është sqaruar ende zhdukja e dy grupeve të myslimanëve nga kjo krahinë. Njëri

prej tyre është grabitur me një autobus në afërsi të kufirit me Bosnjen, ndërsa tjetri është zbritur nga treni i linjës Beograd-Bar në një stacion që ndodhet në territorin boshnjak. Me sa duket ata janë dërguar në mënyrë të dhunshme në Republikën e sotme Srbska dhe janë vrarë pastaj atje; gjithsesi deri sot mungon çdo gjurmë e tyre.

Megjithatë këto probleme në krahasim me Malin e Zi mund të cilësohen thuajse të një rëndësie më të vogël. Në qoftë se midis Serbisë dhe Malit të Zi nuk do të arrihet një rregullim i ri ndërjugosllav i qëndrimeve të ndërsjellta, atëhere fati i RFJ-së edhe formalisht mund të quhet i vulosur.

Marrëdhëniet midis Serbisë dhe Malit të Zi - guri i provës

Duke gjykuar nga mënyra sesi janë zhvilluar qysh prej vitit 1998 marrëdhëniet midis Beogradit dhe Podgoricës, mund të thuhet se sot në rrafshin shtetëror nuk ka më gjëra të përbashkëta ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi. Qeveria e Beogradit e ka bllokuar praktikisht Malin e Zi nga Serbia dhe i ka shndërruar kufijtë e deritanishëm administrativë në kufij shtetërorë. Forcat e armatosura jugosllave kanë përforcuar praninë e tyre në Malet e Zeza dhe para së gjithash kanë krijuar një njësi të posaçme të policisë ushtarake, e cila në rast nevoje mund të vihet në veprim si kundërpeshë kundrejt policisë malazeze, që është përforcuar nga Presidenti Gjukanoviç dhe është betuar për besnikëri ndaj tij. Pra, "ushtritë e luftës civile" ndodhen tashma potencialisht përkundruall njëra-tjetrës.

Republika e Malit të Zi, nga ana e saj, është shkëputur prej strukturave të Republikës Federale Jugosllave falë futjes së markës gjermane si monedhë e dytë, si edhe falë një politike të pavarur të tregtisë së jashtme dhe forcimit të marrëdhënieve të saj me Perëndimin.

Megjithatë raporti Serbi-Mal i Zi i tejkalon në një masë të ndieshme lidhjet shtetërore. Ky raport nuk mund të shqitet me të vërtetë as nëpërmjet përdorimit të dhunës nga Serbia dhe as nëpërmjet një shkëputje të Malit të Zi. Nga ana tjetër lidhjet kulturore, fetare e politike midis Malit të Zi dhe Serbisë janë tepër të shumanshme dhe tepër të ngushta. Goja e popullit malazez i ka vendosur këto lidhje në një emërues të thjeshtë: "Gjithnjë me serbët, asnjëherë nën serbët."

Historikisht nuk duhet harruar se fiset malore të malësive të djerra karstike përreth Lovcenit, "malit të shenjtë" të tyre, kanë patur një lloj krijese shtetërore qysh atëhere kur serbët rënkonin ende nën "zgjedhën turke". Ata qeveriseshin qysh në shekullin XVII prej "vladikas-ve", ipeshkëve në rang princi, dhe turqit e pranonin pak a shumë këtë pavarësi. Mali i Zi u bë mbretëri dhe u njoh ndërkombëtarisht nga fundi i shekullit XIX.

Mbas mbarimit të Luftës së Parë Botërore ky vend i vogël u përfshi prej mbretit Aleksandër Karagjergjoviç në të porsakrijuarën "Mbretëri të Serbëve, Kroatëve e Sllovenëve", dmth në Jugosllavinë e mëvonshme, pa marrë më parë mendimin e malazezve mbi fatin e tyre të ardhshëm shtetëror. Kjo dukuri u përsërit edhe mbas Luftës së Dytë Botërore me të vetmin ndryshim që Titoja, duke vlerësuar ndihmesën e madhe të dhënë nga malazeztë gjatë luftës partizane të komunistëve, u krijoi atyre një republikë të tyre të veçantë (me plot 630'000 banorë) në kuadrin e federatës jugosllave të stampës komuniste. Pra, në raport me Serbinë, malazeztë kanë qenë të pavarur nga pikëpamja shtetërore deri në fund të Luftës së Parë Botërore.

Edhe sot e kësaj dite në rrafshin kulturor ka shumë gjëra të përbashkëta serbo-malaziase. Petar Petroviç Njegosha që ka qeverisur shtetin e vogël malor gjatë gjysmës së parë të shekullit XIX, çmohet për eposin e tij "Kurora e maleve" dhe veprat e tij të tjera si poeti më i madh serb. Për cilësimin e raporteve të tyre kulturore vlen sigurisht thënia: serbët dhe malazeztë janë si dy sy të së njëjtës kokë.

Milovan Gjilasi, bashkëpunëtori më i ngushtë i Titos gjatë dhe menjëherë mbas luftës e më vonë kritikuesi më i rreptë i regjimit të tij, duke qenë vetë një "serb nga Mali i Zi", në biografinë e tij të Njegoshës, kur flet për njerëzit e malësive karstike malaziase, thotë se ata duken sikur të ishin krijuar prej guri, "pa as më të voglën gjurmë butësie e të drejtuar kah sendet me një anë të mprehtë". Këtë karakter "të dhunshëm" të malazezve e kanë pikasur dhe etnografë të shquar serb. Ata e shpjegojnë këtë gjë me "njëanshmërinë" e malazezve, të cilët i përkushtohen gjithnjë plotësisht një ideje, duke qenë të pamëshirshëm si ndaj kundërshtarëve ashtu edhe ndaj vetes.

Pra edhe lufta kundër fuqive pushtuese gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe lufta civile e kushtëzuar prej saj janë zhvilluar në Malet e Zeza me një mizori të jashtëzakonshme. Babai luftonte kundër djalit dhe vëllai kundër vëllait e asnjëri nuk i lëshonte rrugë tjetrit. Të gjitha këto mund të lexohen në kujtimet e Gjilasit "Lufta e partizanëve". Ai di çka thotë, mbasi edhe vetë ka qenë thellësisht i ngatërruar në këto luftime.

Rreziku i përsëritjes së këtyre grindjeve të përgjakshme, në rast të mos arritjes së një kompromisi midis pushtetarëve të Beogradit dhe të Podgoricës, nuk mund të lihet thjeshtë mënjanë. Prandaj edhe protagonistët e të dy kampeve po bëjnë përkatësisht lëvizje taktike të kujdesshme. Presidenti i Malit të Zi Milo Gjukanoviç ka ngurruar deri tashti të zhvillojë një referendum në lidhje me largimin e vendit të tij nga Republika Federale Jugosllave, thjesht mbasi nuk ishte i sigurtë, a do ta ndiqnin vallë me të vërtetë shumica e ndieshme e popullit. Nga ana tjetër, Sllobodan Millosheviçi ngurron të vërë në përdorim dhunën e hapët, mbasi i njeh malazeztë e tij dhe e di se ata do t'i kundërviheshin me të gjitha mjetet.

Deri në vitin 1996 midis Serbisë dhe "vëllait të vogël" ka zotëruar një harmoni e plotë. Pushtetarët e rinj të Podgoricës, të sjellë më 1989 nga Millosheviçi në mënyrë puçiste në krye të vendit, fillimisht u treguan vegla të nënshtruara të Presidentit serb. Ata ndoqën madje politikën e tij serbomadhe në luftën kundër

Kroacisë dhe në Bosnje-Hercegovinë. Ka qenë bash korparmata e Ushtrisë Popullore Jugosllave (JNA) e përbërë kryesisht prej malazezve, ajo që në dimrin e viteve 1991/92 bombardoi Dubrovnikun, pa marrë parasysh thesaret historike artistike të këtij qyteti.

Mali i Zi

Mbas vitit 1996 Milo Gjukanoviçi, asokohe kryetar i qeverisë malaziase, filloi të ngrejë krye kundër politikës së dhunshme të Millosheviçit dhe mungesës së vullnetit për kryerjen e reformave. Ai e kritikoi Presidentin serb, duke pohuar se ishte "një politikan me koncepte të tejkaluara". Tendosjet midis Podgoricës dhe Beogradit u ashpërsuan akoma më tepër në nëntor 1997 kur Gjukanoviçi u bë President i Malit të Zi. Çështja arriti deri në një prishje publike, kur qëndrimi i ngurtë i Millosheviçit në konfliktin e Kosovës provokoi më së fundi ndërhyrjen ushtarake të Nato-s.

Në marrëdhëniet me jashtë Gjukanoviçi filloi të ndjekë rrugët e tij vetiake dhe arriti të marrë nga kryeqytetet e Perëndimit edhe ndihma financiare për të qenë sa më i pavarur nga Beogradi. Megjithatë deri tashti bashkësia ndërkombëtare ka ngurruar të premtojë dhënien e ndihmës eventualisht edhe ushtarake për një shkëputje (secesion?) të Malit të Zi. Përkrahja morale e Perëndimi forcon pozitën e brendshme politike të Gjukanoviçit, por ashpërson edhe konfliktin me Beogradin.

Afrimi i Malit të Zi me Perëndimin nuk përbën, veç të tjerash, vetëm një kundërveprim aktual politik, ai ka edhe rrënjët e tij të thella historike. Shteti i vogël i Maleve të Zeza ka mbajtur gjithnjë një dritare të hapur në drejtim të Evropës. Ai ka përfituar në këtë rast nga rrethanat gjeografike; Cetina, kryeqyteti i atëhershëm, nuk ndodhej larg Kotorit (Cattaro), që shtrihej në gjirin e Adriatikut të zotëruar nga Venediku. Që këndej vladikët mund të ndërmirrnin udhëtimet e tyre drejt Venedikut e Vjenës dhe po të ishte e volitshme edhe për në Shën Petersburg, pa rrezikuar të pengoheshin prej turqve. Kontaktet e Malit të Zi me Evropën gjejnë pasqyrim edhe në faktin që në kapërcyellin midis shekullit XIX dhe XX mbreti Nikolla kishte martuar vajzat e tij të shumta pranë oborreve mbretërore evropiane, gjë që i kishte siguruar nofkën e "vjehrrit të Evropës".

Pafuqishmëria e opozitës serbe

Më 10 janar 2000 partitë më të rëndësishme opozitare u ulën në një tavolinë në Beograd dhe vendosën të ndërmarrin bashkërisht hapa kundër regjimit të Millosheviçit. Ata kërkuan rishtas zgjedhje të reja të parakohshme në të gjitha nivelet, dmth prej komunave deri tek Presidenti i Republikës, si edhe shpalljen e tyre deri në fund të prillit. Në rast të kundërt, duke filluar nga data 9 mars, ata do t'u bënin rishtas thirrje qytetarëve për të dalë në demonstrata.

Risia e këtij tubimi të 10 janarit qëndronte posaçërisht në faktin që arriti të realizohej dhe që në te mori pjesë edhe Vuk Drashkoviçi, i cili kishte ndjekur udhët e tij tekanjoze dhe kohë më kohë kishte bashkëpunuar madje edhe me Millosheviçin.

Partitë opozitare u morën vesh për herë të parë midis tyre edhe përsa i takon një blloku kërkesash, të cilat i drejtoheshin nga njëra anë regjimit dhe në anën tjetër bashkësisë ndërkombëtare. Partitë opozitare kërkonin nga Millosheviçi ndërprerjen e "terrorit shtetëror", dmth të masave arbitrare dhe shfuqizimin e ligjeve represive që kishin të bënin me informimin dhe universitetet. Nga shtetet e Bashkimit Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës kërkohej heqja e menjëhershme e sanksioneve të transportit ajror dhe embargos së naftës, si edhe e të gjitha sanksioneve të tjera, menjëherë mbas shpalljes së zgjedhjeve të reja nga regjimi i Millosheviçit. Mandej duhej rivendosur gjithashtu antarësia e Republikës Federale Jugosllave në organizatat ndërkombëtare dhe mundësuar rikthimi i ushtrisë jugosllave dhe i policisë serbe në Kosovë.

Partitë opozitare nga ana e tyre merrnin përsipër detyrimin që qeveria e tyre e re e krijuar mbas fitimit të zgjedhjeve do të përfundonte menjëherë një marrëveshje mbi pozitën e barabartë të Serbisë dhe të Malit të Zi në kuadrin e Republikës Federale Jugosllave dhe do të krijonte kushtet paraprake për përfshirjen e RFJ-së në Paktin e Qëndrueshmërisë (Stabilitetit) për Evropën Juglindore. Kjo qeveri do të respektonte edhe Marrëveshjen e Dejtonit dhe do të përpiqej për pajtimin e serbëve me shqiptarët dhe krijimin e një Kosove demokratike, shumetnike e shumëfetare brenda kufijve të një Republike Federale Jugosllave demokratike.

Millosheviçit nuk i bëri përshtypje as kërkesa për zgjedhje të reja dhe as pikat e tjera të programit të opozitës. Zgjedhjet e reja të parakohshme i hodhi poshtë nëpërmjet Parlamentit. Ashpërsoi zbatimin e ligjeve represive në lëmin e informacionit dhe madje mënjanoi plotësisht edhe autonominë e universiteteve.

Sidoqoftë, akoma më e rëndësishme ishte se dobësia e opozitës shfaqej në faktin që demonstratat e saj në rrugët e Beogradit po bëheshin gjithnjë e më të paefektshme. Së pari, sepse partitë opozitare sërish nuk ishin të një mendimi mbi kohën dhe vendin e demonstratave e, përveç kësaj, edhe sepse qenë të detyruara të bindeshin se nuk kishin mundësi të ngrinin në këmbë masat kundër regjimit në fuqi. Njerëzit në Serbi janë plotësisht të rraskapitur nga lufta e përditshme për ekzistencë dhe pjesa më e madhe e tyre vëmendjen e ka përqëndruar vetëm në drejtim të mbijetesës. Atyre u mungonte tashma energjia për të marrë pjesë në kumtimet e rrugës.

Mirëpo pastaj kundërveproi Millosheviçi me një të rënë daulleje. Ai e detyroi Parlamentin që, me anën e një procedure të rrufeshme, të ndryshojë kushtetutën e Republikës Federative Jugosllave dhe më saktësisht me synimin që presidenti i Jugosllavisë të mos zgjidhej më nga Parlamenti por nga populli dhe të qëndronte në detyrë të paktën për dy periudha. Përveç kësaj, nxiti dekretimin e ligjeve të reja zgjedhore, të cilat duhet të siguronin epërsinë e Serbisë ndaj Malit të Zi në Parlamentin Federal. Ai shpreson të çimentojë kështu pushtetin e tij për katër e

mundësisht tetë vjet të tjera. Pak më vonë caktoi datën 24 shtator 2000 për zhvillimin e zgjedhjeve të reja për zyrën e Presidentit dhe Parlamentin e RFJ-së, si edhe për zgjedhjet komunale në Serbi. Ai shpreson ta befasojë në këtë mënyrë opozitën.

SHTETET E "BALLKANIT PERËNDIMOR"

Kroacia - në rrugën drejt Evropës

Vendimet e marra nëpërmjet zgjedhjeve parlamentare e presidenciale nga kroatët në fillim të njëqindvjeçarit të ri përbëjnë më tepër se një befasim politik. Ata dëshmojnë për një fillim të ri politik në republikën e dytë për nga madhësia, të dalë nga Jugosllavia e dikurshme.

Partia në pushtet Bashkësia Demokratike Kroate (HDZ) e Presidentit themelues Franjo Tuxhman pësoi gjatë zgjedhjeve parlamentare jo vetëm një humbje, por u fshi nga skena politike. Ndërsa në zgjedhjet presidenciale kandidati i HDZ-së nuk pati as edhe gjasën më të vogël në ballafaqimin me konkurentin e opozitës, Stipe Mesiç.

Dhjetë vjet mbas shpalljes së pavarësisë shtetërore të Kroacisë vendi u çlirua prej miteve të viteve të themelimit e të luftës dhe nga nënshtrimi ndaj përfytyrimeve kroatomëdha të Franjo Tuxhmanit, duke marrë rrugën drejt normalitetit. Kjo rrugë është njëkohësisht edhe rruga drejt Evropës.

Ndërkohë nuk mund të mëtohet se në Zagreb i ka ardhur radha në lëmin e politikës një brezi të ri, brezit të mbasluftës. Sigurisht nga pikëpamja e moshës Raçani, Budisha dhe madje edhe Mesiçi dallohen nga Tuxhmani, i cili vdiq në dhjetor të vitit 1999 në moshën 78 vjeçare. Fituesit e zgjedhjeve të janarit 2000 kanë qenë megjithatë të pranishëm politikisht edhe gjatë 10 vjetëve të qeverisjes autoritare të Tuxhmanit dhe të policisë së tij shtetërore HDZ-së. Ndryshimi i vetëm është se ose si opozitarë nuk kanë patur pushtet politik, ose siç është rasti i Mesiçit, i cili fillimisht ishte rrjeshtuar përkrah Tuxhmanit, por më vonë u prish me te, janë tërhequr nga politika.

Si mund të cilësohet koalicioni i tanishëm qeverisës? Gjykuar simbas partive që e kanë krijuar ose mbështetur këtë koalicion ai duhet emërtuar social-nacional-liberal. Shtyllat e tij janë socialdemokratët e Kryeministrit Ivica Raçan, i cili në të kaluarën ka qenë njëherë në krye të udhëheqjes së komunistëve të Kroacisë dhe nacional-liberalët e Drazen Budishës, i cili në vitet e rinisë së tij ka drejtuar në Kroaci revoltën kombëtare të studentëve në fillim të viteve 70-të.

Gjithsesi duhet theksuar se thelbësisht më e rëndësishme sesa struktura partiake, mbi të cilën mbështetet udhëheqja e re, është shpirti tek i cili ajo gjen frymëzim. Ky është një shpirt joideologjik, i frymëzuar prej pragmatizmit, i cili synon ta bëjë Kroacinë një shtet normal të çliruar nga ngarkesat, por edhe nga joshjet e së kaluarës.

Në këtë mënyrë do të krijohen edhe kushtet paraprake për shkëputjen përfundimare të Kroacisë tashma të pavarur nga hija e shtetit fashist ustash të Luftës së Dytë Botërore. Gjatë periudhës së Tuxhmanit, megjithë njëfarë distancimi të Presidentit themelues të shtetit nga regjimi i Paveliçit, kjo hije ka vazhduar të rëndojë mbi shtetin e ri. Ky distancim është zbehur nga përkrahja financiare e politike, e kërkuar dhe edhe e gjetur prej Tunxhmanit në qarqet e emigracionit kroat antikomunist dhe me prirje të skajshme nacionaliste. Ne Perëndim shumë qarqe, jo vetëm të majta, nuk kishin besim tek Kroacia e re e pavarur dhe e e cilësonin atë si fashistoide.

Mbas "kthesës" së fillimit të vitit 2000 të gjitha këto dukuri kanë tashmë vetëm domethënie teorike. Pushtetarët e rinj të Kroacisë kanë njëmendësuar ngjizjen e forcave "socialiste" me ato "nacional-liberale" dhe kanë hapur kështu përfundimisht një kapitull të ri në historinë e vendit të tyre.

Mirëpo mbartja e kësaj kthese në rrafshin e politikës së përditshme përbën një sipërmarrje të guximshme, e cila nuk mund të njëmendësohet në mënyrë të menjëhershme, por që kërkon një periudhë kohe të gjatë. Trashëgimia me të cilën përballet qeveria e re është problematike në shumë pikëpamje.

Në rrafshin e politikës së brendshme i gjithë lëmshi, i lënë trashëgim nga udhëheqja autoritare e Tuxhmanit dhe mbushja e institucioneve shtetërore me njerëzit e partisë-shtet të HDZ-së, duhet shkoklavitur shkallë-shkallë. Ndërkohë udhëheqja e re po ndeshet detyrimisht me qëndresën e rrjetit të funksionarëve me degëzime të largëta, mbartësit e të cilave e konsiderojnë shtetin si zotërim të tyre dhe që kanë lëshuar rrënjë të thella në të.

Ky nuk është vetëm një problem i politikës së kuadrit, i zënies së pozitave kyçe politike me njerëz të rinj. Si pasojë e lidhjes së ngushtë të politikës dhe ekonomisë është krijuar një thurimë që nuk ka asnjë lidhje me rendin e mirëfilltë të ekonomisë së tregut. Në këtë vazhdë do të jetë, para së gjithash, pashmangshmërisht e nevojshme që politika e deritanishme e privatizimeve t'i nënshtrohet një rishqyrtimi dhe të vendoset mbi baza krejtësisht të reja. Veçse kjo do të kërkojë një shpenzim të madh forcash.

Në këto rrethana udhëheqja e re duhet të cënojë detyrimisht ndikimin tej mase të madh që ka ushtruar deri tashti "lobi hercegovinas" - disa e thërrasin madje mafia - mbi ekonominë kroate. Mirëpo, nga ana tjetër, kjo do të vërë në pikëpyetje gjithë çështjen e politikës së Zagrebit ndaj Bosnje-Hercegovinës.

Nuk themi asgjë të panjohur po të kujtojmë se Tuxhmani do të kishte dashur ta ndante Bosnje-Hercegovinën midis vetes dhe Sllobodan Millosheviçit. Mirëpo ai nuk ia doli mbanë kësaj gjëje dhe Bosnje-Hercegovina mbeti një shtet i mëvetësishëm. Nga ana tjetër, Tuxhmani e ka konsideruar praktikisht Hercegovinën si një zotërim të Kroacisë, pavarësisht nga Federata Bosnjako

(Myslimane) - Kroate e krijuar sipas Marrëveshjes së Dejtonit.

Qeveria e re e Zagrebit nuk do ta ketë të lehtë t'i japë fund politikës së dyzuar të Tuxhmanit ndaj Bosnje-Hercegovinës. Për shembull, në qoftë se Mostari do të bëhej sërish një qytet i përbashkët boshnjako-kroat, do të duhej të bindeshin kroatët e Hercegovinës për të hequr dorë nga iluzioni se sektori i tyre i qytetit është kryeqyteti i Hercegovinës. Gjithashtu, po aq e vështirë do të jetë edhe shkoklavitja e pështjellimeve midis ushtrisë së Kroacisë dhe forcave të armatosura kroate në Hercegovinë (HVO), si edhe vendosja e një ndarjeje të qartë midis këtyre të dyve. Veç kësaj do të duhet po ashtu që kroatët e Bosnje-Hercegovinës, të cilët zotërojnë njëkohësisht edhe nënshtetësinë kroate, të heqin dorë nga nënshtetësia e dyfishtë. Të gjitha këto do të jenë të nevojshme, qoftë edhe thjesht për përmirësimin e reputacionit ndërkombëtar të Kroacisë.

Nga ana tjetër, nuk duhet harruar edhe organizimi i ri i mediave, të cilat gjatë sundimit të Tuxhmanit kanë qenë nën një kontroll të rreptë shtetëror.

Së fundi, në trashëgiminë me nam të dyshimtë bën pjesë edhe çështja serbe. Presidenti i mëparshëm i Kroacisë e kishte thjeshtëzuar fare këtë problem. Sipas mendimit të tij ripushtimi i territoreve serbe në hinterlandin dalmatin dhe në Sllavoninë Perëndimore nga forcat e armatosura kroate në verën e vitit 1995, si edhe arratisja dhe përzënia e popullatës së atyshme serbe, e kishin zgjidhur "çështjen serbe". Në dhjetor 1998 ai vazhdonte të thoshte se, po të kishin mbetur nga dymbëdhjetë përqindët e dikurshme të serbëve të Kroacisë qoftë dhe tri ose pesë për qind, kjo nuk përbënte më një kërcënim për shtetin serb. Ai nuk i kushtonte, pra, asnjë rëndësi rikthimit të serbëve të arratisur ose të përzënë.

Stipe Mesiç premtoi menjëherë mbas marrjes së detyrës se do të nxiste rikthimin e serbëve, duke përmbushur kështu edhe njërin prej detyrimeve që Kroacia ka marrë kundrejt bashkësisë ndërkombëtare.

Duhet patur parasysh se rikthimi i popullatës serbe në të ashtuquajturën Krajinë midis Dalmacisë dhe Hercegovinës e në Sllavoninë Perëndimore, si edhe pengimi i zhvendosjes së tyre nga Sllavonia Lindore nuk përbën vetëm një problem politik. Ai është një problem ekonomik e shoqëror, duke filluar nga sigurimi i banesave të nevojshme deri tek vendet e punës.

Në këto rrethana Bashkimi Evropian do të duhej ta shihte në një këndvështrim të ri përfshirjen e Kroacisë në programin e Paktit të Qëndrueshmërisë (Stablilitetit). Kroacia, sigurisht, nuk do të jetë në gjendje të përballojë me forcat e veta shumëllojshmërinë e këtyre problemeve. Në vitin 1999 vendi ka rrëshqitur në një rënie ekonomike. Prodhimi bruto i vendit, që në vitin 1998 kishte arritur gati 84 për qind të vlerës së vitit 1990, ka pësuar rënie të mëtejshme. Prodhimi industrial (më 1998 64,3% të vlerës së vitit 1990) ka rënë edhe dy për qind të tjera dhe deficiti i bilancit tregtar ka arritur një miliardë dollarë amerikanë. Kuota e papunësisë ka arritur tashti në 19,5 për qind dhe borxhi i jashtëm është rritur në 47,6 për qind të prodhimit bruto të vendit. Të ardhurat valutore nga turizmi kanë pësuar një rënie të ndieshme për shkak të luftës së Kosovës.

Brukseli do të duhej t'ia lehtësonte Kroacisë rrugën drejt Evropës, duke qenë se tashma janë krijuar të gjitha kushtet paraprake politike për një lëvizje të mirëfilltë reformash në të gjithë lëmenjtë.

Bosnje-Hercegovina - fli dhe e flijuar

Lufta në Bosnje-Hercegovinë ka nxitur angazhimin ushtarak e politik të bashkësisë ndërkombëtare si në këtë luftë ashtu edhe në luftën e Kosovës. Ky angazhim, sipas të gjitha gjasave, do të vazhdojë edhe për disa dhjetëvjeçarë të tjerë. Në mes të majit 2000 në Bruksel u zhvillua për të pestën herë konferenca mbi zbatimin e marrëveshjes së Dejtonit për Bosnje-Hercegovinën. Përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare të kryesuar nga përfaqësuesi i lartë për Bosnje-Hercegovinën, Volfgang Petriç u thanë me këtë rast politikanëve të Federatës Boshnjako-Kroate dhe të "Republika Srbska-s" afërsisht sa vijon:"Ju po shkapërderdhni kohën tonë dhe paratë tona. Nuk ju kanë mbetur veçse disa muaj kohë për të hedhur një hap përpara në drejtim të zgjidhjes së problemeve kyçe të vendit. Nuk mund të vazhdohet më si deri tashti ..."

Politikanëve të Sarajevës dhe Banja Lukës u është parashtruar me këtë rast edhe një listë e tërë e punëve të pakryera prej tyre. Petriçi tha: "Reformat ekonomike nuk po shënojnë hapa përpara, përsa i takon rikthimit të refugjatëve nuk po shihet ndonjë përparim, organet shtetërore të të dy entiteteve janë të tejmbushura, por nuk funksionojnë. Nuk ka ende një ligj zgjedhor, mungon një ligj për investimet e huaja, integrimi i policisë dhe i sistemeve të komunikimit ndodhet ende në fazën prit të presim e deri tashti nuk është njëmendësuar akoma ngritja e një regjistri qëndror për dokumentet e udhëtimit (pasaportat). Bosnje-Herecegovina ka marrë shumë para - gjithësej pesë miliardë dollarë dhe nuk po shihet ndonjë përftesë (efekt). Epoka e politikanëve të vjetër e të lodhur si edhe e partive të kohës së luftës mund të quhet tashma e kapërcyer".

Këto fjalë përbënin praktikisht një ultimatum. Tashti shtrohet pyetja: çfarë do të bëhet në rast se përsëri brenda një kohe të shkurtër nuk do të shënohen përparime? Në një rast të tillë mbeten në të vërtetë vetëm dy mundësi: ose të dëbohen "politikanët e lodhur" dhe të ngrihet një protektorat i bashkësisë ndërkombëtare, ose konstruksioni i Dejtonit për Bosnje-Hercegovinën t'i nënshtrohet një rishqyrtimi. Në rastin e dytë do të lindte nevoja e një konferencë të re për Bosnje-Hercegovinën. Protektorati i përgjigjet, me sa duket, dëshirës së pjesës më të madhe të popullatës së Bosnje-Hercegovinës, por vetëkuptohet jo asaj të nacionalistëve, të cilët nuk duan të rrezikojnë pozitat e tyre.

Po aq dramatik sa nëntitulli - fli e të flijuar - është në të vërtetë edhe vetë fati i këtij shteti. Ai fitoi mëvetësinë në fillim të dhjetëvjeçarit të fundit të shekullit të

kaluar në vazhdën e shpërbërjes së Jugosllavisë dhe pastaj u bë menjëherë fli, fillimisht e njësive ushtarake e paraushtarake jugosllave e serbe e më pas e atyre kroate. Katër vjet më vonë, me Marrëveshjen e Dejtonit, e cila në bazë të një nisme amerikane i dha fund luftës së tmerrshme, Bosnje-Hercegovina për hir të interesave ndërkombëtare "u flijua" në këmbim të nënshkrimit të Sllobodan Millosheviçit. Përgjithësisht synimi ishte për ta ruajtur Bosnje-Hercegovinën si shtet, por de facto ajo u nda duke u mbështetur në parimet etnike siç kërkohej prej të dyja palëve ndërluftuese, dmth në një Republika Srbska dhe në Federatën myslimano-kroate të de facto Herceg-Bosna-s me kryeqytetin e mbizotëruar prej kroatëve Mostar.

Lufta për Bosnje-Hercegovinën e viteve 1991-1995 solli ndryshimin e qëndrimit të Perëndimit ndaj gjithë Ballkanit, gjë që u dëshmua edhe në kundërveprimin ndaj shkallëzimit në Kosovë dhe solli në raport me Jugosllavinë e dikurshme ndryshime me një shtrirje akoma më të thellë sesa ato që do të buronin vetëm nga zbërthimi i saj në shtete sovrane. Rrëke të tëra emigrantësh u vunë në lëvizje, me rezultate, të cilat do të mund të rishqyrtohen vetëm pjesërisht dhe marrëdhëniet midis njerëzve, popujve e shteteve pësuan çrregullime aq të mëdha, saqë edhe për një kohë të gjatë do të ndikojnë fuqimisht mbi të ardhmen.

Qysh atëhere është botuar një shkulm i vërtetë shkrimesh mbi luftën pabesueshmërisht mizore e brutale të zhvilluar para dyerve të Evropës Perëndimore dhe nën sytë e politikanëve europerëndimorë, të cilët për një kohë të gjatë i hodhën tej vështrimet e tyre. Janë shkruar reportazhe të hollësishme, komente spekulative, analiza politike me karakter apologjik apo kritik që tematizonin qëndrimin e Perëndimit; pra, nuk ka mbetur pa u përmendur pothuajse asnjë aspekt i ngjarjeve. Edhe aktorët kryesorë të "bashkëbisedimeve për paqe" që vazhduan për vite me radhë nuk kanë munguar të japin ndihmesën e tyre nëpërmjet kronikave autobiografike. Për këtë arsye nuk do të përsërisim informacionet, që pak a shumë mund të lexoheshin e dëgjoheshin çdo ditë në mediat evropiane. Megjithatë duhen bërë, sigurisht, përpjekje për shqyrtimin e prapaskenave, dukurive shoqëruese e pasojave. Në fund të fundit Evropa - me ndihmën e luftës së mëvonshme të Kosovës - ka njohur gjatë kohëve të fundit bashkëpërgjegjësinë e saj e, rrjedhimisht, edhe detyrimin e saj për domosdoshmërinë dhe dëshirën e dhënies së një ndihmese për rindërtimin dhe një fillim të ri.

Mirënjohja e thellë e popullit boshnjak për dhënien fund të luftës, po përzihet nga viti në vit gjithnjë e më tepër me një pezmatim në rritje e me ankesa të shumta kundër përfshirjes së shumanshme të gjuhës dhe synimeve të agresorëve në Marrëveshjen e Paqes të Dejtonit. Fjala është për ndarjen "etnike". Një "Republika Srbska" brenda shtetit për serbët dhe një "Herceg-Bosna" de facto për kroatët, pra të dy kanë të drejtë ta quajnë përkatësisht "mëmëdheun" e tyre Kroacinë dhe Serbinë si "atdheun" e tyre të vërtetë, ndërsa boshnjakëve myslimanë, të cilët sot quhen "boshnjakë" e kundër të cilëve kanë qenë drejtuar mësymjet e të dyja palëve, u është rezervuar vetëm një enklavë. Mbrapa tyre nuk ndodhet ndonjë atdhe "tjetër". Në Dejton është përpiluar një kushtetutë, e cila parasheh tri kategori qytetarësh dhe që deri sot nuk është ratifikuar nga Parlamenti boshnjak.

Fakti që shteti është i paqeverisshëm, siç është theksuar edhe në Konferencën e përmendur të Brukselit, mund të shpjegohet në fund të fundit me bazat e ndërlikuara, që janë përcaktuar në Marrëveshjen e Dejtonit. Për të mos u zgjatur shumë po rreshtojmë vetëm disa prej tyre. Kryesia kolektive e shtetit përbëhet nga një serb (nga Republika Srbska) dhe një kroat e një boshnjak prej Federatës Boshnjako-Kroate. Deri sot këta përfaqësues janë të barazvlefshëm me kryetarët ose përkatësisht përfaqësuesit e tri partive nacionaliste, të cilat mbajnë politikisht përgjegjësinë e luftës. Në dikasteret e Federatës çdo shef departamenti ka një zëvendës, i cili nuk mund t'i përkasë së njejtës kombësi. Në rast se njëri është kroat, atëhere tjetri duhet të jetë mysliman ose anasjelltas. Kompetencat e shtetit të përbashkët janë skajshmërisht të kufizuara në dobi të një drejtimi të decentralizuar. Pra, dhjetë kantonet që përbëjnë Federatën gëzojnë të drejtat e një autonomie të skajshme, të cilat i kanë shndërruar pothuajse në shtete brenda shtetit. Në kushtet e një ndërthurjeje të tillë pothuajse të gjitha vendimet e nevojshme mund dhe në fakt edhe bllokohen.

Rishqyrtimi i Marrëveshjes së Dejtonit është kërkuar si nga nacionalistët e të tria palëve, ashtu edhe nga ata që përkrahin barazinë e të gjithë qytetarëve në një shtet të përbashkët. Me anën e kësaj Marrëveshjeje, e cila është nënshkruar nga Millosheviçi, Tunxhmani dhe Izetbegoviçi (Presidenti kroat Tuxhman ka vdekur ndërkohë, ndërsa Izetbegoviçi ka dhënë dorëheqjen), u arrit një punë e paarrritshme, dmth njohja ndërkombëtare e një shteti (të njësishëm) e qysh nga viti 1995 vënia e tij nën protektorat dhe njëkohësisht çimentimi i një ndarjeje etnike që ishte krijuar nëpërmjet luftës. Bash ky ka qenë synimi i shpallur i Millosheviçit dhe Tunxhmanit për të cilin ata ishin marrë vesh midis tyre, dmth shpartallimi i Bosnje-Hercegovinës, krijimi i territoreve kombëtare "etnikisht të pastra", "të pastruara" prej atyre boshnjakëve, të cilët ishin klasifikuar prej tyre si "myslimanë besimtarë" dhe "trajtuar" përkatësisht si të tillë. Serbët dhe kroatët me anën e propagandës së tyre mëtonin të shpëtojnë Evropën e krishterë nga islamizmi.

Dejtoni ka përvetësuar përkufizimet e përdorura gjatë luftës së rajoneve etnike, përveç të tjerash edhe nëpërmjet "kantonizimit" brenda Federatës, pa marrë parasysh ata boshnjakë, të cilët nuk e konsiderojnë veten "vetëm" myslimanë besimtar, të cilët vijnë nga martesa të përzjera apo jetojnë në kushte të këtilla e të cilët nuk duan të jetojnë si myslimanë në një shtet të populluar vetëm prej myslimanëve ose që nuk pranojnë asnjë lloj përkatësie fetare (gjë që mbas 45 vjetësh sundimi komunist ka të bëjë me një numër jo të vogël njerëzish).

Kjo është gjendja e sotme e Bosnje-Hercegovinës e, përkundruall saj, bashkësia ndërkombëtare vazhdon t'i përmbahet parullës: Dejtoni mbetet ashtu siç është.

Në botimet e shumta mbi luftën dhe mbi Dejtonin disa ngjarje nuk janë trajtuar fare ose janë trajtuar pa qartësinë e duhur. Kështu, për shembull, në kuadrin e

zhvillimeve para dhe gjatë fillimit të luftës vendosja e embargos ndërkombëtare të armëve për të gjitha shtetet pasardhëse të Jugosllavisë së dikurshme, fillimisht më 5 qershor nga Bashkimi Evropian dhe pastaj më 25 shtator 1991 nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, përbën edhe sot e kësaj dite një dukuri të pasqaruar. Pra, kjo embargo është vënë në një moment kur veprimet luftarake nga Sllovenia po zhvendoseshin në Kroaci dhe kur në rrafshin ndërkombëtar nuk mund të vihej kurrsesi në dyshim që prapa tyre qëndronin ambiciet serbomëdha. Asokohe dihej po ashtu se Bosnje-Hercegovina përbënte synimin e ardhshëm.

Para së gjithash shërbimet e kundërzbulimit ushtarak të Perëndimit e njihnin gjendjen në të cilën ndodheshin, përsa i takon kapaciteteve të tyre ushtarake, shtetet e reja që u sulmuan, të cilat sapo kishin fituar mëvetësinë. Këto qarqe duhet të kenë ditur gjithashtu deri në hollësitë më të imta se nëpërmjet Ushtrisë Popullore Jugosllave agresorët kishin në dispozicion njësi tepër të organizuara, të pajisura më së miri e që zotëronin rezerva të mjaftueshme. Në rast se embargoja ka synuar - të paktën ky është versioni zyrtar - që nëpërmjet këtij vendimi të ndalonte luftën, tek pala jugosllave kjo nuk duhet të ketë shkaktuar gjë tjetër veç qesëndisjes. Në fakt serbët këtë embargo e kanë vlerësuar si një mbështetje të interesave dhe synimeve të tyre. Megjithatë, në letërsinë e përmendur ku flitet për luftërat e këtyre viteve në Jugosllavinë e shpërbërë nuk diskutohet pothuajse fare sesi ka qenë e mundur që pala perëndimore të merrte një vendim të tillë tmerrësisht të gabuar. Mirëpo në ndërgjegjen e popujve të shteteve që e kanë pësuar në kurrizin e tyre dhe para së gjithash të boshnjakëve, të cilët kanë qenë të detyruar me plot kuptimin e fjalës të luftojnë thjeshtë për ekzistencën e tyre, dyshimet janë ende të pranishme.

Një temë tjetër, të trajtuar në mënyrë të pakënaqshme, përbën edhe terminologjia politike e përdorur publikisht në Perëndim. Kjo ka sjellë një sërë pasojash të rënda.

Sulmi mbi Bosnje-Hercegovinë nga pikëpamja kohore - jo politike - ka përbërë një kundërveprim të menjëhershëm ndaj njohjes ndërkombëtare të këtij shteti pasardhës të Jugosllavisë së dikurshme. Dy rezoluta të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, nr. 752 dhe 757, e damkosin në fakt fare qartazi këtë luftë si një agresion nga jashtë. Megjithatë, politikanët perëndimorë - kryesisht në vendet pritëse të refugjatëve - nuk kanë ngurruar të flasin publikisht për një "luftë civile" (madje në Gjermani kjo ka vazhduar nganjëherë deri në ditët e sotme!). Në këtë mënyrë ata kanë mundur të arrijnë drejtpërsëdrejti dy caqe. Së pari, kanë penguar popullatën vendase që spontanisht t'i identifikojë emocionalisht ata si të flijuar e, madje, ka mbizotëruar më tepër kundërveprimi: "kjo është një çështje e brendshme e Bosnje-Hercegovinës .... me këtë çështje s'kemi punë, ajo nuk na intereson ....". Së dyti, - dhe kjo është më thelbësore - refugjatët e luftrave civile nuk parashihen në Konventën e Gjenevës për Refugjatët e Luftës, e cila ka karakter detyrues për vendet pritëse. Kjo terminologji iu përshtat deri diku njëmendësisë vetëm mbas kalimit të një kohe të gjatë - ndërsa dëmi psikologjik megjithate nuk mund të korrigjohej më.

Para dhe gjatë luftës vëzhguesit e huaj bënë, si të thuash, një mëkat të mosbërjes, në kuptimin e mosmarrjes parasysh në masën e mjaftueshme të mediave, në radhë të parë në Serbi, pastaj në Kroaci e më vonë edhe në Bosnje-Hercegovinë. Metoda ai "u shpreh" dhe arsenali i pabesueshëm i gënjeshtrave që pllakosi mbi publikun e vendit, nuk linte më asnjë dyshim përsa u përket prapaskenave, përmasave dhe metodave të agresionit të planifikuar. Në frymën e mirëkuptimit të sotëm, sipas të cilit lindja e konflikteve duhet vrojtuar me kohë për të mundësuar përkatësisht kundërveprimin në kohën e duhur, do të ishte e nevojshme që prej palës ndërkombëtare të tregohej një interesim më i madh për faktin që në Bosnje-Hercegovinë ka radiostacione, të cilat transmetojnë programe iraniane në gjuhën boshnjake dhe me përmbajtje antiperëndimore.

Ngaqë një pjesë e opinionit publik perëndimor mund t'i kalojë lehtësisht në harresë ngjarjet e krijuara nga situatat para dhe gjatë luftës - në një kohë që kuptimi i thelluar i prapaskenave të saj duhet të vazhdonte të kishte një rëndësi të jashtëzakonshme për qëndrimin që duhet mbajtur aktualisht - e quajmë të rëndësishme , për shembull, të kujtojmë faktin e çuditshëm që Bosnje-Hercegovina u gjet e befasuar para mësymjeve serbe të fundit të marsit e fillimit të prillit 1992 në Bosnjen Veriore e Lindore. Ka të ngjarë që shpjegimi i kësaj dukurie duhet kërkuar më parë në rrafshin psikologjik dhe jo vetëm në atë politik ose, madje, në atë ushtarak.

Mbas vdekjes së Titos në vitit 1980 u krijua një shqetësim i përgjithshëm veçanërisht në radhët e politikanëve udhëheqës, për shkak se në republikat e veçanta u vu re shumë shpejtë rritja e forcave nacionaliste e centrifugale. Gjithkush e dinte po ashtu se bash Bosnje-Hercegovina me tre kombet e saj të vendosura në pozita të barabarta - myslimanët, kroatët e serbët - në rastin e zhvillimeve të tilla do të binte pre e një prove durimi të jashtëzakonshëm dhe se atje mund të ekzistonte rreziku i një "lufte civile". Duke qenë se pritej që ajo të ishte edhe më e përgjakshme, se çdo luftë tjetër e zhvilluar në territorin e Jugosllavisë, shumë vëzhgues - duke na përfshirë edhe ne - besonin, se bash për këtë arsye nuk do të arrinte puna deri aty. Mirëpo, siç thamë, fakti i ekzistencës së rrezikut ishte tepër i dukshëm dhe për këtë arsye me të drejtë duhej pritur që në Bosnje-Hercegovinë të ishin marrë në çfarëdolloj drejtimi masa praprake.

Disa njoftime - pjesërisht të botuara e pjesërisht të pabotuara - të refugjatëve, të cilët kanë përjetuar vitet e para të luftës si ushtarë, japin një përshkrim të habitshëm të faktit, sesi gjatë periudhës, mbasi kishin filluar tashma luftimet, hidheshin hapat e para drejt qëndresës së armatosur. Një shembull: Gjatë një vizite të bërë në Tuzla pak para përfundimit të luftës, patëm rastin të flemë një natë tek një familje, e cila nuk na njihte, por së cilës i ishin lutur disa nga miqtë tanë që të na ofronin një shtrat për një natë. Hotele ende nuk kishte. Ishte një shtrat i mirë me ndërresa shtrati të pastra - edhe sot e kësaj dite për ne ka mbetur enigmë dhe njëkohësisht arsye admirimi, sesi ishte e mundur që amvisat, të cilave çdo ditë u duhej të luftonin me mungesën e ujit e të energjisë elektrike, t'i mbanin kaq të pastra familjet, banesat dhe ndërresat e tyre -, por as ne e as e zonja e shtëpisë së bashku me djalin e saj 20-vjeçar nuk shkuam për të fjetur.

Në dhomën ngjitur ishin strehuar dosido një numër i madh të afërmish, të cilët kishin mbetur pa strehë, ndërsa ne të ulur mbi shtrat, duke pirë një verë që kishim sjellë me vete, dëgjonim të shtangur tregimet e tyre rreth viteve të luftës. "U zgjova si çdo mëngjes në orën gjashtë e gjysmë", filloi tregimin e tij djali, "dhe po përgatitesha për të shkuar në shkollë, kur më tërhoqi vëmendjen një zhurmë jo e rëndomtë për mua; hodha vështrimin jashtë dhe vura re njësi të veshura me uniformë e të armatosura që po marshonin nëpër rrugën tonë drejt qendrës. Pak minuta më vonë tingëlloi telefoni dhe një teze tepër e shqetësuar më kumtoi përmes receptorit: «Serbët po shkojnë në luftë kundër nesh, ata po vijnë nga të gjitha anët .... ç'të bëj unë tashti?» Këtë, vetëkuptohet, nuk mund ta dinte as nëna ime dhe as unë. Mandej ngjarjet rrodhën shpejt e shpejt. Në shkollë nuk ishte paraqitur asnjë bashkënxënës serb, por vetëm kroatët dhe ne myslimanët; na bënë thirrje të paraqiteshin për mbrojtjen e qytetit .... ne nuk kishim ende kurrfarë përgatitje ushtarake, as uniforma e as armë, pra, fillimisht u nisëm me tuta sportive dhe atlete e pastaj gjatë ditëve të mëvonshme prindërit më blenë uniformën, armët dhe municionin - kështu pra ka filluar këtu për ne lufta ...."

Sot disponohen pohime të palës serbe, sipas të cilave pranohet se lufta është kurdisur mirë e mirë dhe se synimet e saj jo vetëm që ishin ushtarakisht të paracaktuara, por edhe politikisht të motivuara. Pikësynimi ishte njësimi në një Serbi të Madhe i të gjitha trevave, ku jetonin serbë.

Ushtria Popullore Jugosllave (JVA) kishte filluar qysh në verën e vitit 1991 çarmatosjen e "njësive territoriale", një lloj milicie qytetare që varej asokohe nga pikëpamja financiare e organizative prej Republikave. Sllovenët i kishin bërë bisht kësaj mase e prandaj dispononin municione dhe qenë në gjendje t'u kundërvihen mësymjeve të filluara në fund të qershorit/fillimit të korrikut 1991. Nga ana tjetër, Kroacia e kishte zbatuar në një masë të madhe urdhërin e çarmatimit e për pasojë u detyrua të ndërtojë nga themelet mbrojtjen e saj vetiake, në një kohë që lufta kishte filluar tashma. Embargoja e armëve, ç'është e vërteta, u arrit të shmangej, por mbrojtja u vështirësua e përmbi të gjitha u shtrenjtua shumë më tepër.

Bosnje-Hercegovina ndodhej në një pozitë të posaçme. Së pari, për arsye se, mbështetur në përvojën e luftës partizane, e cila në faza të caktuara ishte zhvilluar në një mënyrë posaçërisht të rreptë në trevat e kësaj Republike, kapacitetet e JVA-tit ishin përqëndruar në Bosnje-Hercegovinë. Industria e armëve, ndërmarrjet furnizuese të ushtrisë, hangaret e forcave ajrore dhe arsenalët e armëve ishin përqëndruar kryesisht, pjesërisht nën tokë, në Bosnjen Qendrore. Për këtë kishte ndikuar edhe prishja me Stalinin në vitin 1948 dhe udhëheqja jugosllave ishte e detyruar t'u trembej aksioneve ndëshkuese të shteteve anëtare të Paktit të Varshavës e kryesisht atyre përmes Hungarisë e Rumanisë.

Asokohe objektet ushtarake të stacionuara në afërsi të kufirit u zhvendosën në brendësi të vendit. Kjo solli, përveç të tjerash, praninë e përfaqësuesve të ushtrisë, me plot kuptimin e fjalës, në të gjitha ndërmarrjet më të rëndësishme industriale dhe të import-eksportit të Bosnje-Hercegovinës, mbasi pothuajse të gjitha këto ishin të rëndësishme nga pikëpamja ekonomike edhe për JVA-tin. Ky përqendrim i ushtrisë së mbizotëruar prej serbëve e të drejtuar politikisht nga qendra e Beogradit përbënte një kërcënim të veçantë për boshnjakët. Përveç kësaj, mbas luftës së Kroacisë JVA-ti i tërhoqi dhe i zhvendosi në Bosnje njësitë e tij e në radhë të parë njësitë tankiste. Veç kësaj, nuk përbënte më një të fshehtë fakti që pothuajse afro një vit para shpërthimit të luftësm, përreth Sarajevës ishin ndërtuar kolona mbajtëse për artilerinë e rëndë.

Udhëheqja politike e Sarajevës ndihej e rrethuar politikisht e ushtarakisht, si edhe e paaftë për të ndërmarrë vetë masa parapërgatitore ushtarake. Megjithatë, përgatitje të tilla u bënë vetëkuptohet në heshtje të plotë, veç të tjerash me përkrahjen e atyre oficerave të JVA-it që nuk pranuan të ndërhyjnë kundër bashkëvendasve të dikurshëm apo kundër familjeve të tyre, duke u larguar në mënyrë të rregullt ose dezertuar nga ushtria. Kështu u krijuan mundësitë që parapërgatitjet boshnjake të mbështeteshin tek disa ekspertë. Por, të gjitha këto ishin tepër të pakta e tepër të vonuara.

Le të kthehemi shkurtimisht mbrapa tek fillimi i fushatës serbe kundër myslimanëve të Bosnje-Hercegovinës. Zanafilla e saj duhet kërkuar para së gjithash tek procesi kundër Presidentit të mëvonshëm Alija Izetbegoviç, i cili qysh në vitin 1982 së bashku me 12 të paditur të tjerë të besimit mysliman ishte nxjerrë para gjyqit në Sarajevë. Padia mbështetej mbi një memorandum të hartuar prej tij para afro 15 vjetësh për domosdoshmërinë e reformimit të islamizmit. Në të nuk përmendej kurrkund koncepti Bosnje-Hercegovinë. Çdokush që ka lexuar aktpadinë e asokohshme e ka patur të qartë se në këtë rast - gjatë epokës së mbas Titos - duhej të zhvillohej një proces politik për t'i kompromet uar në opinionin publik myslimanët boshnjakë si "fondamentalistë". Ata akuzoheshin se kishin synuar krijimin e një shteti "islamik" të Bosnje-Hercegovinës në bashkëpunim të ngushtë me Iranin, i cili asokohe ndodhej nën rregjimin radikal të Ajatolla Komenit.

Në vitet pasuese janë hedhur në qarkullim fragmente të këtij memorandumi në shumë versione të ndryshme, disa prej të cilave përfshinin vetëm ato pjesë, të cilat duhej të shërbenin për të vërtetuar tezën e shtetit të synuar (aspiruar) islamik. Këto pjesë të tekstit, sipas pohimeve të bëra nga Presidenti Izetbegoviç në mars 1992, ishin falsifikuar prej qendrave serbe. Gjithsesi, ato kanë shërbyer, për të ngjallur, me synime të paracaktuara, tek serbët e kësaj treve ndjenjën e frikës se në një Bosnje-Hercegovinë të tillë nuk do të kishte më "vend për serbët e krishterë ortodoksë". Tek kjo pjesë e popullatës, ç'është e vërteta, u arrit krijimi i panikut. Në verën e vitit 1991, gjatë një udhëtimi të kryer me porosi të Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (Vjenë) në Sarajevë (dhe në Novi Sad të Vojvodinës), shumë boshnjakë - asokohe nuk bëhej fjalë për kroatë, myslimanë apo serb - gjatë bisedave na kumtuan se në disa institucione (p.sh. në universitete) dhe organizata (p.sh. në shoqatat sportive) kolegët serb kishin hedhur papritmas tezën se nuk mund "të punohej më bashkërisht", se duhej

krijuar në miniaturë një ndarje ndërmjet të tre kombeve të këtij shteti shumëpopujsh, dmth një ndarje në një seksion serb, një seksion kroat e një seksion mysliman.

Sado e padrejtë të ketë qenë akuza në procesin kundër Izetbegoviçit e shokëve të tij, si në veçanti, ashtu edhe në përgjithësi, në retrospektivë duhet pranuar, megjithatë, se të paktën disa prej intelektualëve boshnjakë që kishin dalë me këtë rast para gjyqit, mund të cilësoheshin si përfaqësues të nacionalizmit boshnjako-mysliman. Pra, të një nacionalizmi që ka ekzistuar në Bosnje qysh në fillim të shekullit të kaluar, i cili është luftuar prej çdo regjimi të Jugosllavisë së krijuar më 1918, që përkujdeset për martirët e tij dhe të cilit asnjëherë nuk ka qenë e mundur t'ia shtuposin gojën. Ndonëse prirje të tilla nuk kanë lozur ndonjë rol përcaktues gjatë asnjë periudhe në Bosnje-Hercegovinë, duke u nisur nga rrethanat e regjimit jugosllav mbas vdekjes së Titos, syçeltësia e treguar gjatë këtyre viteve ndaj ekstremistëve nacional-myslimanë është plotësisht e kuptueshme.

Mirëpo, nga ana tjetër, është për të dyshuar, nëse duhet përligjur si metodë e goditur procesi politik, gjatë të cilit Izetbegoviçi u dënua me dymbëdhjetë vjet dhe të tjerët po ashtu me dënime të gjata me burg. Fakti që avokati Izetbegoviç deri atëhere pothuajse i panjohur e i respektuar si një figurë e panjollosur, në krye të "Partisë së Veprimit Demokratik" (SDA) të drejtuar prej tij, që doli ngadhnjimtare, arriti të zgjidhej përmes votimeve të lira si Presidenti i parë i vendit, ka shumë gjasa që në fund të fundit t'i dedikohet këtij procesi. Këto zgjedhje, gjatë të cilave për herë të parë partitë me orientim nacionalist kanë patur mundësi të kandidohen dhe u janë imponuar menjëherë partive jonacionaliste, ka përbërë njëkohësisht për shumë boshnjakë fillimin e fundit të një shteti të përbashkët.

Fushata, tashma e përmendur, tinzare yshtëse kundër myslimanëve të Bosnjes ka gjetur shprehje me anën e një numri të pafund variantesh: nëpërmjet njoftimeve për mësymje të hamendësuara kundër serbëve dhe kishave e varrezave serbe, por, para së gjithash, për përdhunime grash e vajzash serbe. Në këtë mënyrë u bëhej thirrje instinkteve më elementare të popullatës serbe e kryesisht të pjesës së saj mashkullore. Ata përpunoheshin në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Përpara se të vinte puna me të vërtetë tek veprimet e dhunshme në Bosnjen Veriore e Lindore, filloi terrorizimi i popullatës myslimane të qyteteve të vogla dhe fshatrave të kësaj treve.

Në fillim u vendos ndalimqarkullimi natën, mandej u dha urdhri për dorëzimin e armëve, tek i cili u vu theksi përmes bastisjeve të përsëritura të banesave dhe kështu u desh të kalojë një farë kohe deri sa myslimanët të vinin re, se këto masa nuk kishin të bënin me serbët, por vetëm me ta. Më vonë atyre iu ndalua të shkonin në disa pjesë të caktuara të qytetit dhe u lejohej të blinin vetëm në tregtoret "myslimane", furnizimi i të cilave përkeqësohej gjithnjë e më tepër. Njerëzit të tronditur e që nuk u vinte në ndihmë as policia e as organet e tjera, po shtyheshin gjithnjë e më tepër drejt izolimit. Së fundi, burrave iu ndalua të shkonin në punë.

Mandej ngjarjet u rrokullisën drejt vrasjeve të para të myslimanëve, përdhunimit të grave para syve të burrave dhe fëmijve të tyre dhe, tekembramja, njerëzve iu bë thirrje që të largoheshin menjëherë nga vendi. Skenari funkiononte në mënyrë të përkryer. Para largimit kërkohej nënshkrimi i dokumenteve, me anën e të cilave vërtetohej se personi përkatës hiqte dorë vullnetarisht nga të gjitha pronat e tij, duke ia kaluar ato komunës. Mbi këto formularë - që dukej fare qartazi se ishin përgatitur me kohë - ishte vendosur një vulë e "Republika Srbska" (pra as e "Bosnjes" dhe as e "Jugosllavisë"), gjobat, po ashtu, ishin parapërgatitur, secili kishte të drejtë të merrte me vete vetëm një minimum bagazhesh dhe shpenzimet e transportit duheshin përballuar prej vetë viktimave. Atyre u kumtohej se do të dërgoheshin në Vojvodinë, jo larg kufirit hungarez, ku do të pajiseshin me dokumente udhëtimi dhe do të vazhdonin me tren rrugën në drejtim të Hungarisë.

Njoftimet që vinin prej njerëzve tejet të tronditur të kësaj vale të parë refugjatësh mbi brutalitetin, mizoritë, plaçkitjet e paturpshme të banesave të tyre prej njësive paraushtarake serbe (shpeshherë ata kanë patur rast të shohin me sytë e tyre sesi plaçkat e grabitura mbarteshin me kamiona të Ushtrisë Popullore Jugosllave), grabitjet e tanivonshme, dëbimi i organizuar dhe, së fundi, tmerret dhe pështjellimet në pikat e kalimit kufitar (vetëkuptohet që policitë kufitare hungareze e austriake nga ana e tyre kanë qenë plotësisht të papërgatitura e të mbingarkuara në kushtet e kësaj situate të krijuar fare papritmas), ishin rrëqethëse. Ata të kujtonin me një ngjashmëri rrëqethëse metodat e Rajhut të Tretë gjatë dëbimit të planifikuar deri në hollësitë më të imta të çifutëve gjermanë. Edhe ata gjatë fazës së parë veçoheshin dhe terrorizoheshin psikikisht, sa kohë që kishin ende para, për t'i paguar shtetit gjerman për emigrimin dhe shpëtimin e tyre.

Mbetet për t'u analizuar edhe një element tjetër. Të gjithë ata që kanë arritur të mbijetojnë mbas luftës së Bosnjes ose që jetojnë në diasporë, kanë humbur identitetin e tyre. Fillimisht kanë humbur identitetin jugosllav, gjë që në rastin boshnjak nuk ka të bëjë vetëm me shpërbërjen e Jugosllavisë së Titos, por kryesisht me shpërbërjen e Bosnje-Hercegovinës. Në një kohë që shtetet e dala nga Jugosllavia e dikurshme në saje të sovranitetit u kanë siguruar qytetarëve të tyre një nënshtetësi e për pasojë identitetin kombëtar, boshnjakët kanë humbur shtetin, i cili u kishte dhënë mundësinë a) për të patur një identitet kombëtar si serb, kroatë apo myslimanë në Bosnje-Hercegovinën e përbashkët dhe për të qenë njëkohësisht "nënshtetas jugosllavë" ose b) pa pranuar një përkatësi të caktuar kombëtare të zgjidhnin "jugosllavizmin" dhe gjatë regjistrimit të popullatës të deklarohen si "jugosllav", sërish në bazë të pasaportës jugosllave. Kjo është një mundësi që është shfrytëzuar nga shumë njerëz të moshuar, të cilët gjatë Luftës së Dytë Botërore kanë ushqyer bindjen se luftonin për një Jugosllavi të përbashkët, si edhe nga njerëz të rinj me prejardhje nga martesa të përziera.

Po të pyetet sot një boshnjak kroat për identitetin e tij, ai në kuadrin e Federatës do të zgjedhë detyrimisht opcionin kroat, mbasi kështu atij i krijohet përparësia të

gëzojë në Kroaci të drejtën e votimit, si edhe të marrë një pasaporte kroate, gjë që i ofron atij në rrafshin ndërkombëtar një sërë lehtësirash. E njëjta gjë vlen edhe në rastin e një boshnjaku serb, me të vetmin ndryshim që një pasaportë serbe sot për sot nuk përbën ndonjë përparësi.

Nga ana tjetër, një boshnjak nga Bosnja duhet të jetë a priori mysliman, i cili quhet tashti zyrtarisht boshnjak e si i këtillë është i detyruar të kërkojë vizë pranë ambasadës përkatëse për çdo udhëtim jashtë shtetit, të presë miratimin e saj, të paguajë një taksë dhe të shkojë vetëm në këtë vend për një periudhë kohe të kufizuar paraprakisht. Praktikisht kjo do të thotë, për shembull, që nëse në një institucion të Federatës, bie fjala në një ministri, ku në bazë të rregullores në të njëjtën zyrë punojnë një kroat dhe një boshnjak e këta të dy duhet të shkojnë me shërbim jashtë shtetit, atëhere trajtimi i boshnjakut do të jetë ai i një qytetari të dorës së dytë. Vallë a është e mundur që një gjendje e tillë, e krijuar si pasojë e rregullave të caktuara në Dejton, të shërbejë për nxitjen e "bashkëjetesës"? Karrierë, madje një vend pune ose një banesë mund të presë vetëm ai që pranon rregullat e lojës së partisë përkatëse kombëtare ose që është në pushtet apo të drejtuesve të saj lokalë, pra, ai që bën një pohim politik apo fetar, madje më mirë ai që i bën të dyja së bashku. Kohët e fundit në këtë drejtim po bëhen, gjithsesi me hapa shumë të vegjël, përpjekje për ndryshime.

Gjendja e sotme në Bosnje-Hercegovinë, po të kundrohet me vëmendje dhe të përkufizohet në një mënyrë paksa të ngurtë, mund të cilësohet "skajshmërisht e rrezikshme e dramatike"; ndonëse në dukje nuk ngjet asgjë dhe kurrkush nuk të lë përshtypjen se dëshiron të provokojë një luftë të re apo ndonjë grindje tjetër të dhunshme. Mirëpo, bash sepse nuk po ngjet gjë, sepse në radhët e popullatës po shpaloset një apati me një shtrirje gjithnjë e më të thellë - mungesë perspektive dhe mungesë përparimi ekonomik - dhe sepse në të njëjtën kohë po gjen zbatim një proces i nëndheshëm islamizimi, i cili po frikon së tepërmi, pjesërisht, vetë pjesëmarrësit e këtij procesi, por, kryesisht, ata që po i ndjekin me pasivitet këto ngjarje. Gjendja, siç na tha kohët e fundit gjatë një bisede një i ri boshnjak mysliman, është aq e brishtë sa duket "sikur po na marrin ajrin e frymëmarrjes".

Përse bëhet fjalë? Për rritjen e ndikimit arabo-saudit në rrafshin fetar e financiar. Embargoja e armëve, e vendosur në fillim të luftës, kishte mobilizuar gatishmërinë e shteteve arabe për të ndihmuar "vëllezërit dhe motrat myslimane" të Bosnje-Hercegovinës, ekzistenca, besimi fetar dhe kultura e të cilëve kërcënohej, por vetëkuptohet që u kishte krijuar edhe një mundësi për rritjen e ndikimit të tyre. Ushtria mbrojtëse boshnjake vështirë se do të ishte armatosur aq shpejt pa përkrahjen arabo-saudite. Dhe tashti në rrethin e ngushtë të këshilltarëve të Presidentit përfshihen edhe disa fondamentalistë fetarë.

Myslimanët boshnjakë kanë qenë të njohur në botën arabe si tepër liberalë e tepër të shkujdesur në raportet e tyre ndaj fesë, jo vetëm qysh nga periudha e komunizmit, por tradicionalisht. Mirëpo, nga ana tjetër, Bosnje-Hercegovina përbën për shtetet arabe portën e islamit drejt Evropës, dmth të një islami antievropian, i cili i shmanget çdo pikë takimi me botën perëndimore joislamike. Gjatë viteve 70-të Jugosllavia e Titos bash për këtë arsye - të kthyer së prapthi - kishte ngritur në Sarajevë një Fakultet Teologjik Islamik, i cili synonte, së pari, të pengonte kryerjen e shkollimit teologjik të imamëve të ardhshëm në Kajro dhe në universitetet e tjera "fondamentaliste" arabe dhe, së dyti, që t'i ushtronte ata në drejtim të dialogut me kulturën, filosofinë dhe fenë perëndimore. Lufta dhe pasojat e saj i asgjësuan këto pikësynime.

Fakti që numri i grave dhe vajzave me çarçaf po rritet vazhdimisht, që burrat po përkujdesen për të mbajtur një lloj të caktuar mjekre, që fëmijtë po arsimohen në shkollat e kuranit dhe që në të gjithë vendin po ndërtohen vazhdimisht xhami të reja e madhështore - të gjitha këto dukuri i trembin boshnjakët. Tablo të tilla i largojnë ata nga atdheu i tyre edhe më tepër sesa varfëria dhe etnizimet politike të kushtëzuara nga lufta. Në Bosnje-Hercegovinë shtrohet pyetja: vallë a i sheh dhe analizon bashkësia ndërkombëtare këto zhvillime? Po ta bënte këtë gjë, atëhere ajo do ta kuptonte se çdo izolim etnik i shërben izolimit të kësaj rryme myslimano-radikale. Kjo përbën njërën anë.

Ana tjetër, dmth gatishmëria e shtresave të gjëra të popullatës për të filluar sërish bashkëjetesën e së kaluarës, siç duket, gjithashtu nuk po pikaset nga vëzhguesit ndërkombëtarë. Jo në të njëjtën formë, jo sepse harrohet ajo që ka ngjarë, por thjesht për shkak të njohjes së qartë të njëmendësisë, dmth të faktit që njerëzit janë të varur ekonomikisht nga njëri-tjetri. Në rrafshin lokal do të ishte arritur prej kohësh një zhvillim i përbashkët tejkufitar, në rast se do të ishin krijuar e mbështetur kushtet paraprake ekonomike, për shembull në formën e një sigurimi financiar, për projektet e vogla dhe tepër të vogla për komunat.

Në vargun e masave të ndryshme konstruktive të marra gjatë viteve të kaluara nga Përfaqësuesi i Lartë përfshihet edhe rregulli i targave të njësuara të automobilave; nëpërmjet tyre u mundësua qarkullimi i lirë, i cili, veç të tjerash, u pasua nga një numër i madh vizitash tek fqinjët e dikurshëm, të shndërruar më vonë në hasëm, si edhe vizitash në "atdheun" e vjetër, të cilat shpeshherë patën një ecuri shumë më paqësore nga sa pritej prej protagonistëve të tyre. Këto vizita mund të përbëjnë sinjale për të ardhmen.

Tek këto masa pozitive bën pjesë edhe krijimi i një policie "të përzierë", e cila gjithsesi është ende shumë larg funksionimit në kuptimin e dëshiruar. Po ashtu edhe aksioni me të cilin u shkarkuan rreth dy duzina kryetarë bashkie të kantoneve të ndryshme, mbasi kishin penguar për shkaqe nacionaliste, për shembull, rikthimin e banorëve të dëbuar të vendit, duke sabotuar, siç thuhet zyrtarisht, implementimin e Dejtonit. Gjithsesi, ky ndërrim në mjaft raste nuk do të thotë se kryetarët e rinj të bashkive janë "më të mirë" dhe se problemet lokale kanë gjetur tashma zgjidhje.

Pengimi (obstruksionizmi) ka të ngjarë të jetë tepër i fuqishëm, mbasi udhëzimi ishte dhënë nga "fare lartë". Atëhere, çfarë duhet të bëjnë në këto rrethana autoritetet ndërkombëtare? Një shembull shumë domethënës për paaftësinë dhe

mungesën e gatishmërisë për bashkëpunim përbën përvoja e bashkërenditësit (koordinatorit) të Paktit të Qëndrueshmërisë (Stabilitetit). Mjafton të kujtojmë që institucionet e Bosnje-Hercegovinës nuk kanë qenë në gjendje të zbatojnë në kohën e duhur dhe në një formë cilësisht të përshtatshme projektet e një rëndësie jetike për zhvillimin e vendit. Një nga shkaqet e kësaj dukurie duhet kërkuar padyshim tek fakti që sot shumë poste të një rëndësie vendimtare mbulohen nga njerëz pa asnjë lloj aftësie profesionale, merita e vetme e të cilëve është pjesëmarrja në luftë dhe besnikëria ndaj partisë nacionaliste në pushtet.

Jeta në Bosnje-Hercegovinë, me sa duket, zhvillohet në tre rrafshe që nuk komunikojnë pothuajse fare ndërmjet tyre. Në krye qëndron Përfaqësuesi i Lartë me shtabin e tij gjigand, me IFOR-in, OSBE-në e organizma të tjera të këtij lloji dhe përgjatë gjurmëve të lëna prej tij janë vendosur një numër i madh institucionesh humanitare ndërkombëtare dhe OJQ-sh. Ka të ngjarë që të gjithë, papërjashtimisht, të kenë qëllimet më të mira, megjithatë shumë prej tyre paraqesin mangësi në drejtim të njohjes së prapaskenave dhe ndërrohen me ritme herë më të shkurtra e herë më të gjata, kështu që gjithnjë përvojat dhe mirëkuptimi duhet të përvetësohen duke u nisur rishtas nga e para. Në qendër - kështu mund të thuhet - vepron një numër i madh intelektualësh boshnjakë me prirje kritike, që kërkojnë fare haptazi e nëpërmjet mediave të shumta pak a shumë "të pavarura", rishqyrtimin e Marrëveshjes së Dejtonit dhe që synojnë një Bosnje-Hercegovinë multikulturore e multifetare të përbërë nga qytetarë me të drejta të barabarta. Dhe së fundi, si të thuash "poshtë" ndodhen masat e gjera të popullit që rrojnë në zgrip të minimumit jetik, që ndihen të lëna pas dore dhe të shitura e të poshtëruaras në të gjitha drejtimet nga trysnia e radikalizmave politikë.

Në Bosnje-Hercegovinë gjatë pesë vjetëve të kaluara, sipas mendimit të shumë vrojtuesve të brendshëm e të jashtëm, ka vetëm një instancë, e cila edhe me ndihmën e OSBE-së u është përmbajtur me të vërtetë besnikërisht direktivave të dhëna në Dejton; këta janë tre juristat e shkëlqyer, të cilët në cilësinë e ombudsmenëve të Federatës, mbrojnë dhe përkrahin të drejtat e njeriut e që duhet të nxisin mirëkuptimin për demokracinë, kryesisht tek organet shtetërore. Kjo është, siç thonë ata vetë, një punë jashtëzakonisht e vështirë. Ndarja midis politikës shtetërore dhe asaj partiake, megjithë fjalët e shumta të bukura të politikanëve, ende nuk ka mundur të gjejë zbatim në praktikë. Në këto qarqe interesat nacionaliste vlerësohen shumë më tepër sesa të drejtat e njeriut. Megjithatë, palët, të cilave u cënohen të drejtat e tyre, po u drejtohen gjithnjë e më shpesh ombudsmenëve. Kjo përbën, në fund të fundit, një arsye për të shpresuar, por edhe vetë të drejtat e njeriut nuk mund të krijojnë kushtet paraprake ekonomike të një jetese dinjitoze. Në raportin e fundit të ombudsmenëve për vitin 1999 vihet në dukje që plot 50 për qind e rasteve të cënimit të të drejtave të njeriut që u janë parashtruar janë ndjekur prej tyre në rrugë zyrtare.

Edhe sot e kësaj dite mbetet e pashpjegueshme, pse qysh nga përfundimi i luftës kanë munguar nismat e huaja për nxitjen e zhvillimit të ekonomisë së këtij vendi të shkretuar nga lufta, kryesisht në drejtim të ndërmarrjeve të vogla e të mesme prodhuese. Nëpërmjet investimeve qoftë dhe minimale, pa pritur në rrafshin politik krijimin e kushteve paraprake teorike e ligjore, do të mund të arriheshin - kryesisht në vështrimin psikologjik - përftesa maksimale. Ekzistojnë lista të gjata të këtyre lloj projekteve , për të cilat nuk është interesuar askush. Kështu do të ishin krijuar vende pune për banorët vendas, të cilët e kanë përjetuar dhe mbijetuar luftën, si edhe për ata që janë rikthyer në atdhe. Mirëpo, duke qenë se vendet e punës mungonin për të gjithë, të rikthyerit e, kryesisht ata që vinin nga vendet e Evropës Perëndimore, kanë qenë posaçërisht të padëshiruar. Po të kishte patur projekte të përbashkëta, do të ishin kapërcyer me shpejt dukuri të tilla si smira, paragjykimet, drojet dhe nervozizmi agresiv.

Investitorët e huaj kanë munguar mbasi a) shtetet e tyre nuk u kanë dhënë garanci për humbjet eventuale, b) mbasi vazhdojnë të mungojnë kushtet paraprake juridike për kontrollimin e pozicionit ekonomik të partnerëve dhe c) mbasi mungon besimi në qëndrueshmërinë politike të Bosnje-Hercegovinës. Për këtë gjë ata, si të thuash, nuk mund të qortohen. Por gjithsesi duhet theksuar se ndërsa, nga njëra anë, vendosja e e protektoratit ka synuar krijimin e mundësive të rindërtimit, nga ana tjetër, është harruar të hartohet një program për këtë qëllim. Po ashtu, askush nuk po ndërmerr ndonjë hap, qoftë edhe tashti mbas luftës, kundër zhvendosjes (lëvizjes) së pandalshme të "kokave më të mira" nga vendi. Në të vërtetë ata po dëbohen, mbasi dijhet e tyre profesionale nuk kanë rëndësi; rëndësi ka vetëm feja e tyre. Veç kësaj, nuk duhet harruar se çdo kanton mund të ketë universitetin e tij autonom, dmth me mjete mësimore vetiake dhe me një plan mësimor vetiak.

Është e vërtetë se prania ndërkombëtare u siguron qytetarëve të shumë shteteve nga të gjitha kontinentet vende pune fitimprurëse, por megjithatë në vetë Bosnje-Hercegovinë sot ka ende treva ku papunësia është pothuajse 80 për qind dhe zyrtarisht, si Federatë, kuota e saj qëndron afër 50 përqindshit. Kush ka dhënë me qira në Sarajevë dhe në disa qytete provinciale një dhomë ose një banesë, kush flet një gjuhë të huaj dhe është punësuar si përkthyes ose si shofer pranë institucioneve ndërkombëtare - dhe të tilla ka rreth 400 në gjithë vendin - mund ta quajë veten fatlum dhe ta shtyjë disi me familjen e vet. Mirëpo, punësime të tilla nuk i sjellin dobi ndërtimit të vendit. E njëjta gjë mund të thuhet edhe për valutën që sjellin të huajt.

Në gjirin e bashkësisë ndërkombëtare po përhapet gjithnjë e më tepër pikëpamja: "Bosnje-Hercegovina është një rast i pashpresë. Njerëzit nuk duan, njerëzit nuk munden .... Një ditë do të vërsulen sërish kundër njeri-tjetrit ...." Për këtë arsye u përpoqëm të hedhim edhe njëherë dritë "nga brenda" mbi prapaskenat, fillimet dhe rrethanat e luftës. Kuptimi i këtyre lidhjeve të ndërsjellta është i domosdoshëm për kuptimin e të tashmes e të synimeve për të ardhmen.

Maqedonia - shtet mbi një kreshtë të ngushtë

Maqedonia, shteti i pestë i pavarur i dalë nga Jugosllavia e dikurshme, po t'a shohësh hollë, nuk është ngritur mbi themele të forta, as në vështrim të politikës së jashtme dhe as asaj të brendshme, për të mos përmendur fare anën ekonomike. Megjithatë, ajo ka një përparësi të jashtëzakonshme; ajo ndodhet nga pikëpamja strategjiko-politike në një pozitë skajshmërisht nevralgjike të Ballkanit. Vënia në dyshim e ekzistencës së saj nga jashtë apo nga brenda do të përbënte një kërcënim të drejtpeshimit të brishtë në zemër të Ballkanit e, për pasojë, do të ftonte për ndërhyrje gjithë shtetet fqinje, si Serbinë ashtu edhe Bullgarinë, si Greqinë ashtu edhe Shqipërinë dhe madje në prapaskenë edhe Turqinë. Dhe ajo që është akoma më e rëndësishme: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, apo, po të dëshirojmë të shprehemi ndryshe, Nato-ja, kurrsesi nuk do të qëndronte në pozitat e shikuesit, për të parë sesi do të krijohej në këtë pikë-ndodhje të Evropës një vatër e re krize. Kjo përbën, në fund të fundit, një mbështetje të fuqishme për ekzistencën e këtij shteti me plot dy milionë banorë, rrënjët e mëvetësisë së të cilit janë ende tejet të brishta.

Maqedonia ka patur një përparësi të madhe në krahasim me shtetet e tjera që fituan mëvetësinë si pasojë e shpërbërjes së Jugosllavisë: konstituimi i saj si shtet i pavarur u bë pa luftë. Ushtria Popullore Jugosllave u tërhoq në vitin 1992 pa luftë, por duke marrë gjithsesi me vete të gjitha pajisjet e saj ushtarake deri tek gozhda e fundit, kështu që në duart e shtetit të ri e të forcave të tij të armatosura mbetën vetëm armët e zjarrit.

Vënia paqësore e themeleve të një Maqedonie të pavarur i detyrohet në radhë të parë shkathtësisë së treguar gjatë bashkëbisedimeve nga Presidenti i saj i parë Kiro Gligorov, i cili kishte patur poste drejtuese edhe në Jugosllavinë e dikurshme. Mirëpo, nga ana tjetër, edhe Presidenti serb Sllobodan Millosheviç dhe Ushtria Popullore Jugosllave, të cilët gjatë asaj periudhe po zhvillonin luftime si në Kroaci ashtu edhe në Bosnje, duhet t'a kenë patur të qartë që një vatër e re lufte bash në këtë zonë do të kishte sjellë me vete rreziqe të pallogaritshme në rrafshin e politikës së jashtme dhe atë ushtarak. Më vonë Millosheviçi i propozoi Qeverisë Greke ndarjen e Maqedonisë midis Serbisë dhe Greqisë, por Athina e hodhi poshtë këtë propozim, duke patur parasysh, ndoshta, partneren e saj të Natos-s, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, të cilat qysh asokohe ishin treguar tejet të interesuara për ekzistencën e një Maqedonie të pavarur. Me nismën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës gjatë viteve 1993 deri 1998 në Republikën pranë Vardarit ishte vendosur një kontigjent ushtarak e policor prej 1'000 vetësh me mandatin e OKB-së. Gjithsesi, kur Qeveria e Shkupit njohu Tajvanin dhe Pekini ndërpreu marrëdhëniet me Maqedoninë, Këshilli i Sigurimit të OKB-së nuk mundi t'a ripërsërisë këtë mandat për shkak të vetos kineze.

Në pranverën e vitit 1999 gjatë ndërhyrjes së tyre ushtarake në Kosovë u shpalos interesimi shumë i madh i Nato-s dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Maqedoninë. Ky vend i vogël u shndërrua në një bazë për marshimin e trupave të Kfor-it, dmth Trupave Mbrojtëse të Kombeve të Bashkuara për Kosovën, atëhere kur policia serbe dhe ushtria jugosllave nën trysninë e sulmeve ajrore të Nato-s u detyruan të tërhiqen prej kësaj province.

Fakti që Maqedonia qysh më përpara ka qenë streha kryesore e shqiptarëve të dëbuar apo të arratisur nga Kosova prej serbëve, përbënte një barrë të rëndë për këtë vend me një ekonomi të dobët. Por, nga ana tjetër, fushatat për ndihma të organizatave ndërkombëtare humanitare, si edhe kalimi i trupave të huaja gjatë rrugës për apo nga Kosova, i kanë siguruar vendit të ardhura në valutë. Shqiptarët e dëbuar dhe refugjatët, ndërkohë janë kthyer sërish në Kosovë, por Maqedonia vazhdon megjithatë të përbëjë ende një nyjë ushtarake dhe një qendër këmbimesh për trupat ndërkombëtare të vendosura në Kosovë. Dhe kjo, me sa duket, do të vazhdojë edhe për shumë vite të tjera.

Në këto rrethana është madje groteske që Maqedonia nuk ka ende një emër të njohur në rrafshin ndërkombëtar. Nuk ka dyshim se pothuajse gjithë bota përdor emërtimin "Republika e Maqedonisë" të shënuar në kushtetutën e vendit, por, për të qenë korrekt, duhet përdorur formulimi "Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë", me shkurtimin në anglisht "FYROM", me të cilin kjo Republikë, që fitoi mëvetësinë më 1993, është pranuar në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Shkaktare për këtë është Greqia, e cila nuhat tek emërtimi Maqedoni rrezikun e mëtimeve për provincën greke të Maqedonisë së Egjeut. Bashkësia ndërkombëtare i ka kërkuar Shkupit dhe Athinës që të bien në ujdi për një emër, gjë që nuk ka ndodhur deri tani. Mirëpo kjo nuk ka patur as ndikime negative mbi pozitën ndërkombëtare të Maqedonisë dhe as ka penguar gjatë kohëve të fundit Greqinë për t'u angazhuar ekonomikisht në mënyrë intensive në Maqedoni.

Në fund të vitit 1999 është shënuar edhe konsolidimi i marrëdhënieve midis Shkupit dhe Sofjes, të cilat për një kohë të gjatë kanë qenë të rënduara historikisht. Gjatë një vizite në Sofje të kryetarit të qeverisë maqedonase, Ljupçe Gjeorgjevski, të dyja palët kanë hequr dorë nga mëtimet territoriale kundrejt njeri-tjetrës dhe deklaratat e tyre të përbashkëta janë përpiluar dhe botuar edhe "në gjuhët zyrtare të të dy shteteve - bullgarisht, në përputhje me kushtetutën e Bullgarisë dhe maqedonisht në përputhje me kushtetutën e Republikës së Maqedonisë". Në këtë mënyrë marrëdhëniet midis Shkupit dhe Sofjes janë çliruar nga një hipotekë pesëdhjetë vjeçare, mbasi deri atëhere bullgarët kanë kundërshtuar me këmbëngulje njohjen e maqedonishtes si një gjuhë të veçantë. Për ta maqedonishtja përbënte vetëm një dialekt bullgaroperëndimor. Megjithatë, në këtë mënyrë asnjëra prej të dyja palëve nuk detyrohet të heqë dorë nga pikëpamja e vet parimore, mbasi bullgarët e kanë pranuar maqedonishten, si të thuash, vetëm si gjuhën zyrtare të Republikës së Maqedonisë, ndërsa në Shkup mund të mëtohet se në këtë mënyrë nga ana e Sofjes është njohur ekzistenca e një bashkësie maqedonase.

Gjatë vizitës së Gjeorgjevskit në Sofje është kapërcyer gjithashtu një problem delikat që ka ekzistuar midis Shkupit dhe Sofjes: problemi i maqedonasve të Pirinit. Në deklaratën e përbashkët të të dy kryetarëve të qeverive theksohet se asnjë nen i kushtetutës së Maqedonisë nuk krijon mundësinë e përzierjes në

çështjet e brendshme të Bullgarisë. Kjo ka vlerë edhe për të drejtat e atyre nënshtetasve të Bullgarisë, të cilët vetë nuk pranojnë të jenë bullgarë. Këtu është fjala bash për ata maqedonas të Pirinit në perëndim të Bullgarisë, të cilët si të thuash qysh nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore cilësohen prej Shkupit si maqedonas. Numri i tyre përbën një temë të kontestuar: në Shkup llogaritet që numri i "pakicës" që jeton në rrethinat e Bllagoevgradit kap 200'000 njerëz, ndërsa në Sofje mëtohet të mos jenë më tepër se 10'000.

Së fundi, midis dy vendeve është rënë njëkohësisht në ujdi për një bashkëpunim të ngushtë ushtarak, gjë që përbën një risi në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Bullgaria i vuri menjëherë falas në dispozicion Maqedonisë 150 tanke dhe të njëjtën sasi grykash zjarri; për forcat e armatosura maqedonase, të pajisura në mënyrë të pamjaftueshme, kjo zhvendosje ka një rëndësi shumë të madhe, edhe pse bëhet fjalë më tepër për materiale të vjetruara. Kjo marrëveshje nuk duhet të jetë arritur pa ndikimin e matur e me takt të Shteteve të Bashkuara të Amerikës e përkatësisht të Nato-s. Nuk duhet harruar, se gjatë mësymjeve ajrore të Natos-s kundër Republikës Federative Jugosllave, Bullgaria është treguar e gatshme për bashkëpunim, duke vënë në dispozicion hapësirën e saj ajrore.

Edhe marrëdhëniet me Greqinë, të cilat kanë qenë rënduar së tepërmi si pasojë e sanksioneve greke të viteve nëntëdhjetë, kanë fituar ndërkohë qëndrueshmëri. Është e vërtetë, siç përmendëm edhe më lart, se emri zyrtar i Maqedonisë vazhdon të jetë i diskutueshëm, por ato kohëra, kur fqinji i saj jugor kishte vendosur kundër Maqedonisë një bllokadë të përgjithshme, i përkasin tashma së kaluarës. Sot Greqia ndodhet në krye të listës së investitorëve të huaj të fqinjit të saj të ri, duke qenë njëkohësisht njëri prej partnerëve të saj tregtarë më të rëndësishëm.

Shenja konsolidimi vihen re edhe në rrafshin e politikës së brendshme. Këmbimi i qeverisjes nga partitë e qendrës së majtë tek opozita e deritanishme e djathtë mbas zgjedhjeve parlamentare të vjeshtës së vitit 1998, u krye pa shqetësime. I riu Ljubçe Gjeorgjevski, udhëheqës i partisë VMRO, radikalizmit nacionalist të të cilit shumëkush i druhej, u dëshmua, në cilësinë e Kryeministrit, si përsa i përket politikës së jashtme ashtu edhe asaj të brendshme, një politikan i matur. Ai, jo vetëm që zbuti në politikën e jashtme marrëdhëniet e brishta ndaj Sofjes, por i kushtoi rëndësi përfaqësimit të kombësisë shqiptare, si në qeveritë e mëparshme, ashtu edhe në qeverinë e re. Kjo kombësi vazhdon të përfaqësohet nga pesë ministra. Gjatë qeverisjes së Branko Cervenkovskit këta ishin përfaqësues të Partisë së Prosperitetit Demokratik (PPD), ndërsa tani janë të Partisë Demokratike Shqiptare (PDSH).

Zgjedhjet parlamentare të një viti më vonë u zhvilluan gjithashtu pa shqetësime thelbësore. "Babai i mëvetësisë" Kiro Gligorov, pavarësisht nga mosha (83), nuk kishte më të drejtë të kandidonte mbas dy periudhash qeverisjeje. Duhej vendosur, pra, për njërin nga kandidatët e dy blloqeve të mëdha politike. Me këtë rast Boris Trajkovski (43) i kampit nacionalist arriti të fitojë kundrejt Tito Petrovskit (54) të socialdemokratëve, duke njëmendësuar kështu edhe ripërtëritjen e kreut të shtetit.

Megjithatë, problemi kryesor i politikës së brendshme të shtetit të ri, dmth çështja shqiptare, nuk është zgjidhur ende. Simbas regjistrimit të popullatës të vitit 1994 Maqedonia ka 2'106'664 banorë, nga të cilët 440'000, dmth 23 për qind, janë shqiptarë. Sidoqoftë, shqiptarët nga ana e tyre pohojnë sidoqoftë se janë shumë më tepër dhe përbëjnë, të paktën, një të tretën e popullatës e, duke u nisur nga kjo kërkojnë të njihen si "komb shtetformues" e të mos cilësohen si pakicë kombëtare. Ata shohin, pra, tek Maqedonia një shtet shumëkombësh dhe jo një shtet kombëtar të popullit maqedonas, siç është përcaktuar në kushtetutë. Që këtu buron kërkesa e tyre për autonomi kulturore, përfshirë këtu pjesën shqiptare të Universitetit të Shkupit. Meqë kjo u është mohuar deri tani, ata kanë themeluar, si të thuash ilegalisht, një universitet të tyrin në Tetovë të Maqedonisë Perëndimore, gjë që nga ana e saj pati për pasojë masa të dhunshme shtetërore.

Në viset me shumicë shqiptare të Maqedonisë Perëndimore, si Tetovë, Gostivar e Dibër, edhe për "çështjen e Flamurit" lindin herë pas here fërkime. Ligji lejon ngritjen e flamurit të kuq shqiptar me shqiponjën e zezë dykrenore vetëm në banesat private dhe jo në ndërtesat shtetërore, siç e bëjnë ngandonjëherë kryetarët e bashkive shqiptare. Mandej, kur ndërhyn policia, demonstratat, rrahjet dhe arrestimet bëhen të pashmangshme. Megjithatë, deri tashti në Maqedoni ndikimi i nacionalistëve radikal shqiptaromëdhenj mbi bashkatdhetarët e tyre nuk është mbizotërues.

Deri sot flamuri shqiptar nuk është shndërruar ende në një ngarkesë eksplozive për shtetin e ri. Po ashtu edhe vërshimi i përkohshëm i dhjetëra mijëra të dëbuarve dhe refugjatëve nga Kosova në pranverën e vitit 1999 nuk e ka acaruar më tej gjendjen. Gjithsesi qetësimi i tendosjeve ndërmaqedonase, me sa duket, do të arrihet vetëm mbasi të jetë sqaruar në rrafsh ndërkombëtar statusi i Kosovës.

Si paraqitet gjendja ekonomike e Maqedonisë? Jo aq keq sa mund të druhej me të drejtë, duke patur parasysh rrëmujat e shkaktuara prej vërshimeve të papritura nga Kosova dhe kalimi i trupave të Nato-s. Deficiti buxhetor është rritur, ç'është e vërteta, kryesisht si pasojë e shpenzimeve për refugjatët, por nga ana tjetër fushatat e ndryshme ndërkombëtare të ndihmave dhe, edhe vetë trupat e Nato-s, i kanë sjellë vendit të ardhura në valutë.

Ndërprerja me pasoja shumëfishe e marrëdhënieve tregtare me Serbinë e, përkatësisht, me Republikën Federale Jugosllave kompensohet me faktin që Maqedonia është shndërruar ndërkohë në furnitorin më të rëndësishëm të Kosovës, KFOR-it, UNMIKU-t, administratës civile rajonale dhe të shumë institucioneve të tjera ndërkombëtare. Maqedonia përfiton njëkohësisht edhe nga furnizimi i popullatës civile të Kosovës me mallra të konsumit të gjerë në rrugë zyrtare e jozyrtare.

Gjendja afatgjatë e industrisë nuk është kaq optimiste. Për kohët e ardhshme

ekspertët parashikojnë mbylljen ose shitjen e një numri ndërmarrjesh prodhuese, gjë që do të rrisë edhe më tepër kuotën e papunësisë, e cila tani për tani është 32,5%. Megjithatë shpresohet që kjo prirje negative të barazohet nëpërmjet krijimit të ndërmarrjeve të vogla industriale, por, para së gjithash, nëpërmjet lulëzimit të vrullshëm të sektorit të ndërtimtarisë që filloi mbas krizës së Kosovës dhe po vazhdon ende, si në sektorin privat ashtu edhe në atë publik.

Në qoftë se në vendet fqinje nuk do të lindin konflikte të reja - për çështjen e enklavave shqiptare të Serbisë Jugore ose ndërmjet Serbisë dhe Malit të Zi - atëhere ekonomia e Maqedonisë duhet të shënojë, edhe pse shkallë-shkallë, një konsolidim të mëtejshëm. Përveç kësaj ka mundësi që afrimi me Evropën i vendit më jugor midis vendeve të dala nga Jugosllavia e dikurshme të kryhet më shpejt sesa ai i shteteve të tjera të reja. Midis vendeve të të ashtuquajturit Ballkan Perëndimor - kjo është terminologjia e Paktit të Qëndrueshmërisë (Stabilitetit) - dmth Shqipërisë, Maqedonisë, Bosnje-Hercegovinës dhe Kroacisë, deri tashti Maqedonia është e vetmja që ka vendosur të fillojë bashkëbisedimet me Bashkimin Evropian për një marrëveshje sigurie dhe bashkëshoqërimi (asociimi).

Shqipëria - rrëmujë dhe shpresë

Mund të mendohet se nga Shqipëria nuk ka "asgjë të re", mbasi tek mediat nuk gjen pothuajse asnjë "njuz" (në tekst: news) dhe vetëm në raste tepër të rralla ndonjë kronikë të përditësuar. Dihet se edhe Shqipëria është përfshirë në projektin e Paktit të Qëndrueshmërisë (Stabilitetit), ndonëse nuk është e lehtë të mos krijosh përshtypjen se ne këtë vështrim nga ana e institucionit të Hombahut nuk tregohet ndonjë angazhim i posaçëm. Të paktën deri tashti janë paraparë vetëm projekte infrastrukturale, të cilat kanë, padyshim, rëndësinë e tyre, por nuk janë të domosdoshme nga pikëpamja jetike për këtë vend të rrezikuar nga brenda.

Shqipëria ka kufij të përbashkët me Greqinë, që është anëtare e Nato-s dhe kufizohet me zonën e krizave të Maqedonisë, ku jeton pakica e saj e fuqishme shqiptare si edhe me Malin e Zi, i cili ka krijuar një raport të rrezikshëm acarimi, nga njera anë, me Serbinë dhe, nga ana tjetër, brenda vendit ndërmjet grupeve proserbe dhe atyre kundërserbe. Shqipëria ndan, së fundi, edhe një pjesë të kufirit me Kosovën, e cila në fakt qeveriset nga bashkësia ndërkombëtare, por e ardhmja e së cilës vazhdon të jetë, prapëseprapë, krejtësisht e papërcaktuar. Qëndrueshmëria në Shqipëri përbën gjithsesi një faktor të paktën po aq të rëndësishëm për zhvillimet në gjithë trevën e Evropës Juglindore sa edhe për ato tek fqinjët e saj në veri e në lindje. Bash prandaj do të ishte më se i nevojshëm një angazhim "i posaçëm" ndërkombëtar.

Për dhjetëra vite me radhë në Evropën Perëndimore - me përjashtim të lexuesve të librave të Karl Majit (Karl May)- nuk dihej pothuajse asgjë për Shqipërinë. Më vonë, kur në media filloi të përmendej ndonjë fjalë për këtë vend ballkanik me male të larta e me plazhe të mrekullueshme pranë brigjeve të Adriatikut e të Detit Jon, në shumicën e rasteve bëhej fjalë vetëm për "bad news" (lajme të këqija).

Madje edhe në vitet 1990/1991, kur në Perëndim mbërritën lajmet që kishin të bënin me rënien përfundimtare të regjimit të Enver Hoxhës dhe me festimet e gëzimit për "lirinë" e porsafituar, në to flitej njëkohësisht për një pështjellim të plotë, për klishetë e gjakmarrjes e për ikje masive. Më vonë, gjatë gjysmës së dytë të viteve nëntëdhjetë, Shqipëria pushtoi rishtas titujt kryesorë, përsëri flitej për pështjellim të përgjithshëm, madje këtë herë për luftë civile si edhe për ikje masive. Pastaj, për një vit të tërë me radhë, zotëroi prapë heshtja e plotë. E mandej, papritmas, filluan të dëgjoheshin vetëm fjalë të mira - pra, fjalë që kishin të bënin me masën e refugjatëve të dëbuar apo të arratisur nga Kosova.

Plot 450'000 kosovarë që kishin marrë arratinë për shkak të përndjekjeve serbe dhe bombave të Nato-s - shifër kjo që i përgjigjet një të pestës së popullsisë së Shqipërisë - kishin nevojë të ngutshme për t'u strehuar dhe ushqyer; pra, bëhej fjalë për dyfishin e numrit të refugjatëve të pranuar nga Maqedonia që është po ashtu një ndër vendet më të varfra. Në të dy këto vende organizatat ndërkombëtare humanitare u ndodhën para detyrash të jashtëzakonshme dhe u përpoqën me të gjitha forcat për të sjellë sa më shpejt që të ishte e mundur ndihma, gjë që synohej njëkohësisht edhe nga popullsia vendase e Shqipërisë. Pothuajse 75 për qind e refugjatëve gjetën strehim tek familjet mikpritëse, dukuri kjo që shtroi kërkesa të posaçme para organizatave të përmendura, mbasi këta refugjatë, të strehuar në mënyrë të decentralizuar, si edhe strehuesit e tyre, duhet të furnizoheshin individualisht në mënyrë të rregullt me ushqime. Në prill të vitit 1999, sipas të dhënave të UNHCR-s, në të ashtuquajturat streha kolektive ishin vendosur gjithashtu rreth 70'000 njerëz dhe rreth 30'000 të tjerë në kampingje. Mjekë, të ardhur nga shumë vende të ndryshme, luftonin çdo ditë kundër rrezikut të epidemive, posaçërisht për shkak të pajisjeve të këqia sanitare. Këto ishin arritje madhështore.

Fakti që kaq shumë kosovarë gjetën strehë tek familjet mikëpritse, i detyrohet, natyrisht, para së gjithash, rrethanës se shumë prej tyre kishin në Shqipëri të afërmit e tyre. Nga ana tjetër, fakti që këta të afërm, ndonëse vetë tejet të varfër, nuk ngurruan t'i pranojnë të pastrehët zgjoi admirimin e gjithë botës.

Puna nuk mbeti vetëm tek admirimi; nga ana e ndërkombëtarëve u premtuan para dhe shpërblime në natyrë, që do t'u jepeshin familjeve mikpritëse - duke qenë se pjesës dërrmuese të refugjatëve gjatë verës së vitit 1999 u ishin krijuar mundësitë e rikthimit në shtëpitë e tyre - si një kompensim, qoftë edhe modest, për skamjen dhe flijimet e bëra në kushtet e një ngushtice të tejskajshme. Gjithsesi, deri sa mbërritën mallrat dhe paratë e premtuara, të cilat prapëseprapë qenë më të pakta se premtimet e bëra, u desh të kalojë një kohë e gjatë. Nato-ja, e cila qysh nga dita e parë deri ditën e fundit të krizës, u morr me mbartjen e njerëzve e të mallrave me mjetet e saj të panumërta të transportit, nëpër rrugë të rrënuara, të cilat u dëmtuan kështu edhe më tepër, kishte premtuar gjithashtu se do të merrte

përsipër rregullimin e tyre. Këto para priten edhe sot e kësaj dite në Shqipëri, ndonëse nga drama e refugjatëve ka kaluar më tepër se një vit.

Megjithatë, sot mund të thuhet se në fund të fundit kriza e Kosovës është shoqëruar me një zhvillim ekonomik pozitiv në Shqipëri. Gjatë vitit 1999 u shënua një rritje ekonomike reale në masën tetë për qind, meqë vetë organizatat ndërkombëtare humanitare i blenin në Shqipëri artikujt ushqimorë dhe materjalet e tjera të nevojshme, duke dhënë kështu ndihmesën e tyre për një lulëzim të konsiderueshëm të ekonomisë vendëse, i cili do të ketë gjithsesi vetëm karakterin e një përftese të përkohshme.

Siç pohojnë Sabine Ridel dhe Mihael Kalman në studimin e tyre të hollësishëm me temë "Destabilizimi i Evropës Juglindore nëpërmjet luftës së Jugosllavisë", Shqipëria me të ardhurat e saj mesatare mujore prej 41 dollarë amerikanë (1997) bën pjesë jo vetëm në vendet më të varfra të Evropës, por edhe të të gjithë botës. Qysh nga viti 1989, kur u shemb përfundimisht regjimi i Enver Hoxhës, prodhimi, i cili edhe më parë nuk shquhej për ndonjë efikasitet të posaçëm, është ndërprerë pothuajse krejtësisht. Mbizotëron papunësia, e cila gjatë dhjetë vjetëve të fundit ka shënuar një rritje të vazhdueshme dhe sot ka mbërritur në rreth 50 për qind. Gjatë gjithë ditës nëpër rrugët e Tiranës e të shumë qyteteve të tjera më të vogla të rrok syri një numër të pambarim njerëzish, kryesisht burrash, tek sorrollaten kot ose qëndrojnë të ngulur në lokalet e shumta të kumarit, duke shpresuar që me anën e një fitimi të përmirësojnë, qoftë edhe për një ditë të vetme, gjendjen e tyre.

Në vitin 1996/97, kur u shemben të ashtuquajturat sisteme piramidale dhe një pjesë e mirë e popullit shqiptar humbi gjithë pasuritë e kursyera, përfshirë shtëpitë, kafshët shtëpijake, veturat, makinat, etj., të ardhurat e shtetit u përgjysmuan dhe në vitin 1998 kapnin vetëm 245 milionë dollarë amerikanë. Kjo shumë - të paktën kësaj i druhen - do të pakësohet akoma më tepër, mbasi si pasojë e luftës së Jugosllavisë nuk mund të pritet më një rritje ekonomike prej tetë për qind si në vitin 1999. Banka Evropiane për Rindërtim ka arritur në përfundimin se Shqipëria do të jetë e detyruar të përballojë pjesën më të madhe të humbjeve të shkaktuara nga kriza e Kosovës, në krahasim me shtetet e tjera të përfshira në te. Tirana ka kërkuar nga bashkësia ndërkombëtare një ndihmë ekonomike që kap shumën prej 800 milionë dollarësh. Kjo kërkesë, për mendimin e ekspertëve e tepruar, tregon se edhe Qeveria shqiptare - ashtu si ajo maqedonase - përpiqet t'a shfrytëzojë katastrofën e refugjatëve si një lloj pengu, për t'i hapur shtegun burimeve monetare të reja evropiane.

Gjithsesi prapa shifrave të tilla qëndrojnë gjithashtu edhe probleme të tjera madhore të rrafshit shoqëror, politik e psikologjik. Udha e "tranzicionit", të cilën bashkësia ndërkombëtare e në radhë të parë Bashkimi Evropian, e kërkojnë dhe e presin edhe prej këtij vendi, këtu është posaçërisht e gjatë dhe e vështirë. Shqipëria vërtet nuk është përfshirë drejtpërsëdrejti në ndonjë luftë, por ajo i krijoi vetes vështirësi që sollën pothuajse një agoni të plotë të shtetit. Trashëgimia e komunizmit rëndon tej mase mbi njerëzit, të cilët u shndërruan pothuajse të gjithë në viktima të një tirani, të Enver Hoxhës së vdekur në vitin 1985. Vetëm me kalimin e kohës ata filluan të kuptojnë dalngadalë, se nën çfarë pushteti kishin jetuar dhe vuajtur dhe se viktima e fajtorë kishte patur në gjirin e gjithë popullit. Njëra palë - disa dhjetëra mijëra - u dënuan nga gjykatat ose u futën pa asnjë proces gjyqësor në burgje pabesueshmërisht brutale dhe në shumë raste mbetën atje për dhjetëra vjet me radhë. Të afërmit e tyre u internuan në vise të humbura, ku edhe ata në fakt vetëm mund të vegjetonin, si të dëbuar e të flakur tej nga shoqëria. Pala tjetër, duke qenë ndihmëse e bindur e regjimit, i kishte paditur këto bashkëqytetarë dhe kishte pranuar të shndërrohej në bashkëfajtore të padrejtësisë.

Veçantia e kësaj trashëgimie qëndron në faktin, se siguria në vetvete e shqiptarëve, si pasojë e njohjes së fajësisë së tyre, është tronditur në mënyrë të tejskajshme. Nga ana tjetër, dhjetëvjeçarët e epokës së Enver Hoxhës kanë mbjellë në gjirin e njerëzve një mosbesim të thellë.

Edukata tradicionale e shqiptarëve kërkonte prej secilit, pavarësisht nëse ishte apo jo mysliman, mbajtjen e një qëndrimi moral e social, thjesht si detyrim kombëtar: të ashtuquajturin shqiptarizëm.

Qyshkur u krijua shteti shqiptar, këtij i është shtuar edhe një patriotizëm i pakushtëzuar, i cili u shfrytëzua dhe predikua pa u lodhur nga Enver Hoxha. Ky patriotizëm ka qenë i pranishëm gjithkund: në shkolla, në letërsi, në mbishkrimet e gdhendura mbi shpatet e maleve, në banderolat e vendosura në fabrika e në rrugë, në të gjitha parrullat dhe thirrjet e partisë për aksione pune. Të dy këto elemente, në çastin kur tmerri i sundimit komunist u fshi papritmas nga faqja e dheut, çliruan në rrafshin psikologjik disa kundërveprime dramatike: një urrejtje pothuajse të egër ndaj vetvetes dhe një tërbim arkaik shkatërrimtar kundrejt çdo gjëje që mund të përcaktohej si "shtet" ose "shtetërore".

Një nga pasojat më të skajshme ka qenë ikja masive torruahumbur. Italia përbënte pikësynimin e parapëlqyer, ndonëse shumë shpejt u saktësua se ajo nuk ishte një parajsë për refugjatët dhe ndonëse kontrabandistët e njerëzve jo vetëm që fitonin shumë para, por në raste të shumta vinin në rrezik vetë jetën e pasagjerëve të varkave të tyre. Megjithatë shembulli i të paktëve, që prapëseprapë "ia kishin dalë në krye" të ndërtonin një jetë të re në Perëndim, përbënte njëmendësinë e vetme në sytë e këtyre njerëzve të dëshpëruar. Një pasojë tjetër qenë grabitjet e spitaleve, shkollave e fabrikave të ndërtuara nga shteti, të cilat si simbole të së keqes u shndërruan tashti në pluhur e hi. Njerëzit, të shastisur plotësisht, nuk e kishin të qartë, se në këtë mënyrë dëmtonin veten.

Një diplomat perëndimor me një përvojë të ngjeshur shumëvjeçare nga Ballkani ka

thënë tash së fundi gjatë një bisede: "Shqiptarët ndryshojnë nga serbët e nga maqedonasit. Atje dëgjohen vazhdimisht ankesa se askush nuk i kupton, se askush nuk i ndihmon .... Ndërsa shqiptarët thonë: Ne jemi një popull mjeran, ne jemi vetë fajtorë për të gjitha gjërat ....".

Ky kundrim jo sentimental i fatit vetiak mund të cilësohet pozitiv, duke patur parasysh se atje gjendet edhe pohimi i tërthortë se për t'u ngritur rishtas në këmbë është e nevojshme të ndihmohet vetvetja. Megjithatë ky qëndrim thelbësor vështirësohet nëpërmjet mohimit të shtetit në përgjithësi. Nga ana tjetër, në vitet e mëvonshme filloi të spikasë shtegtimi i "kokave më të mira", një dukuri që vazhdon edhe sot e kësaj dite.

Dhe kështu mbërritëm, pra, tek një dukuri, të cilën e kemi trajtuar tashmë në mënyrë të përsëritur në këtë libër. Ne perëndimorët flasim një tjetër gjuhë politike. Deri tashti nuk jemi marrë vesh pothuajse fare jo vetëm përsa i takon "të drejtave të njeriut" e "demokracisë", por as në drejtim të asaj që ne e quajmë kulturë politike.

Në njëmendësinë politike të dhjetë vjetëve të fundit kjo dukuri është shfaqur qysh atëherë në mënyrë shumë të qartë gjatë ndërrimit të raporteve të pushtetit. Zgjedhjet "demokratike" sjellin në krye të vendit një parti, për shëmbull "Partinë Demokratike" (PD) dhe për pasojë ajo e quan veten parti shtetërore dhe uzurpon legjislacionin, politikën e mediave, shpërndarjen e posteve. Kështu ndodhi në vitin 1992, kur Kryetari i Partisë, Sali Berisha, u bë President. Ai kishte qenë më parë Dekan i Fakultetit të Mjekësisë dhe sekretar i Organizatës së Partisë Komuniste të Universitetit të Tiranës si edhe njëri nga pedagogët e parë që ishte shprehur me studentët në mënyrë kritike mbi regjimin komunist dhe kishte diskutuar me ta mbi demokracinë. Ai largoi nga puna, sapo erdhi në "pushtet", pothuajse të gjithë nëpunësit e kohës së komunizmit dhe i zëvëndësoi me njerëz të përkushtuar ndaj tij, të cilët gjithsesi vetëm në raste të ralla qenë kompetentë nga pikëpamja profesionale. Ai urdhëroi përgatitjen e "juristëve" të rinj në shumicën e rasteve pa arsim universitar në kurse të përshpejtuara prej të shumtën gjashtë muajsh, toleroi sulmimin e gazetarëve dhe redaksive që mbanin qëndrime kritike dhe lejoi arrestimin e Kryetarit të "Partisë Socialiste" (PS; më parë komuniste), Fatos Nanos, kundërshtarit të tij më të fuqishëm politik. Megjithatë, këto nuk e penguan që të gëzonte përkrahjen e partive demokristiane të Evropës e, para së gjithash, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Berisha ishte ngatërruar në çështjen "e piramidave" të vendit të tij, përmes së cilës, siç kemi përmendur edhe më lart, qindra mijëra shqiptarë humbën kursimet e tyre. Kjo solli për pasojë që në pjesë të ndryshme të vendit të mbërrinte puna deri në përleshje të dhunshme midis populsisë së zemëruar dhe forcave të sigurimit të Berishës. U plaçkitën depot e armëve të ushtrisë dhe policisë së shpërbërë shqiptare dhe u krijua një pështjellim i plotë i përgjithshëm, pra një gjendje që nxiti ndërhyrjen e bashkësisë ndërkombëtare. Si ndërmjetës u dërgua kancelari i dikurshëm austriak, Franc Vranicki dhe socialdemokratët e Evropës mbështetën partinë e Fatos Nanos. Mbas zgjedhjeve të vitit 1997 që sollën në pushtet PS-në dhe mbas caktimit të Fatos Nanos si Kryeministër, u përsërit në një masë të madhe gjithçka kishte ndodhur gjatë periudhës së Berishës. Sidoqoftë, Shqipëria ndodhej tashti nën mbikëqyrjen ndërkombëtare dhe kështu u krijuan dalngadalë mundësitë për kapërcimin e pjesshëm të këtij pështjellimi të plotë. Filloi përgatitja e ligjeve për legalizimin e proceseve të privatizimit e për joshjen e investimeve të huaja. Ligjet e reja mbi shtypin pranojnë kritikën, partitë e tjera gëzojnë tashma mundësitë për t'u profiluar në media dhe partive opozitare u është lejuar zhvillimi i tubimeve publike. Raste vrasjesh të pasqaruara vazhdon të ketë ende dhe partitë politike akuzojnë njera-tjetrën si organizatorë që qëndrojnë në prapaskenë. Policia bën fjalë vetëm për viktima "kriminale". Gjithsesi strukturat e shtetit po përmirësohen dalngadalë, ndërsa ndryshimi i mendësisë do të kërkojë një kohë më të gjatë.

Kriminaliteti ka marrë përmasa të llahtarshme. Në këtë drejtim pozitat kyçe i zenë tregtia e grave, e drogave dhe e fëmijëve. Këto janë dukuri karakteristike të vendeve të varfra dhe për luftimin e tyre nuk mjaftojnë vetëm ligjet dhe masat policore. Së pari, duhet përmirësuar baza ekonomike. I duhet dhënë hov prodhimit, duhen nxitur ose marrë nisma për ndërmarrjet e vogla dhe tepër të vogla. Në këtë lëmë gjatë dhjetë vjetëve të fundit kanë patur arritje çuditërisht të mira nismat private nga jashtë, të cilat mundën t'u bëjnë ballë madje edhe trazirave të mëdha të viteve nëntëdhjetë. Nga pikëpamja numerike këtu kemi të bëjmë në fakt me shembuj tepër të pakët, por njëkohësisht me shenja shpresëdhënëse dhe perspektiva të tilla të ekzistencës individuale përbëjnë një bazë të shëndoshë për zhvillimet e mëtejshme në drejtim të demokracisë, përgjegjësisë qytetare, shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut.

Kosova - nga qëndresa pasive tek ajo aktive

Shpërbërja e Jugosllavisë filloi në Kosovë. Shfuqizimi i autonomisë së kësaj province të banuar në 90 për qind prej shqiptarëve dhe nënshtrimi i saj prej një regjimi policor serb u tregoi popujve të tjerë të Jugosllavisë, se çfarë duhej të prisnin nga hegjemonia e Beogradit. Republikat e tyre zgjodhën udhën e pavarësisë.

Kosova nuk pati mundësi t'a ndiqte këtë rrugë, mbasi bashkësia ndërkombëtare nuk ia njihte një "province autonome" këtë të drejtë për vetëvendosje. A kemi të bëjmë këtu me një qëndrim të luhatur të Perëndimit? Sido që të jetë, bash shpërfillja e këtij problemi pati më vonë pasoja katastrofike.

Më 7 qershor 1990, nën një trysni masive të kushtëzuar nga prania policore e ushtarake serbe brenda dhe jashtë Parlamentit të Prishtinës, kryeqytetit të Kosovës, si edhe nëpërmjet manipulimit të përbërjes kombëtare të këtij

institucioni, u vendos shfuqizimi i autonomisë së kësaj province. Kjo përbënte një çast dramatik e të trishtueshëm në historinë e marrëdhënieve serbo-shqiptare dhe njëkohësisht edhe të atyre jugosllave. Nëpërmjet këtij vendimi prapësohej kushtetuta federative e Jugosllavisë e vitit 1974, në të cilën - qysh gjatë periudhës së Titos - të dyja "provincat autonome" që bënin pjesë në Serbi, Kosova në jug dhe Vojvodina në veri, ishin ngritur në nivelin e anëtaëve "kostitutiv" të Federatës, pra, de facto brenda institucioneve në të gjitha rrafshet federale ishin vënë në pozita thuajse të barabarta me gjashtë republikat. Asokohe nuk bëhej fjalë për protesta serbe kundër kësaj "fyerje", kundër këtij dobësimi faktik të Serbisë brenda Federatës. Mirëpo, sapo mbylli sytë Tito në vitin 1980, rishqyrtimi i kësaj pike të kushtetutës u shndërrua në një synim përparësor të udhëheqjes serbe, madje edhe para ardhjes në pushtet të Millosheviçit në vitin 1987.

Pothuajse menjëhere mbas shfuqizimit të së drejtës për autonomi, disa politikanë kosovarë, midis të cilëve dhe Ibrahim Rugova, kërkuan mendimin e ekspertit austriak të të drejtave të njeriut dhe të drejtës ndërkombëtare, Feliks Ermakora (Felix Ermacora). Ata donin të dinin se cilat ishin mundësitë në rrafshin e së drejtës ndërkombëtare për një përkrahje ndërkombëtare të "luftës" së tyre kundër pushtimit serb. Ata i referoheshin gjithashtu një takimi "ilegal" të deputetëve shqiptarë të Parlamentit zyrtarisht të shpërndarë të Kosovës në qytezën e vogël Kaçanik në afërsi të kufirit me Maqedoninë, ku më 7 shtator 1990 Kosova ishte shpallur si "Republika e Pavarur e Kosovës". Ndërkohë pushtimi serb shpalosej haptazi me shkeljet e përditshme të të drejtave të njeriut të popullatës me shumicë shqiptare. Feliks Ermakorës iu bënë të ditura të gjitha hollësirat e këtyre zhvillimeve. Mbas një shoshitjeje të thelluar dhe shfletimit të materialeve të ndryshme, ai u përgjigj me keqardhje: "Sa kohë që në Kosovë nuk do të derdhet gjaku, në rrafshin ndërkombëtar nuk do të angazhohet askush ...."

Për të mënjanuar këtë gjakderdhje Rugova, i zgjedhur më 24 maj 1992 President nga popullsia shqiptare e Kosovës, shpalli qëndresën pa përdorimin e dhunës. Kjo qëndresë pasive ishte një arritje shumë e madhe morale dhe tepër e disiplinuar e shqiptarëve, mbasi provokimet e palës serbe ishin të pafundme. Në qoftë se shqiptarët, falë prirjeve të tyre natyrore, do të kishin qenë kaq "luftarakë" e "hakmarrës", siç janë paraqitur herëpashere nga masmediat perëndimore qysh nga fundi i ndërhjyrjes së NATO-s në verën e vitit 1999, atëhere ata sigurisht do t'a kishin dëshmuar një gjë të tillë edhe tetë apo dhjetë vjetë më parë.

Rreth 100'000 njerëz humbën vendet e tyre të punës; në institucionet dhe organet shtetërore shqiptarët u zëvëndësuan me serbë, malazezë dhe një numër të vogël shqiptarësh të gatshëm për bashkëveprim (në radhë të parë, me sa duket, rom (ciganë) të shqiptarizuar, të cilët edhe në Kosovë, duke mos gëzuar ndihmën dhe përkrahjen e askujt në botë, ndodheshin në një pozitë aspak të lakmueshme, gjë që u shfrytëzua me këtë rast nga serbët). U mbyllën të gjitha organizatat shqiptare me karakter politik, kulturor e sportiv, nuk kishte më shtypshkronja shqiptare dhe as media shqipfolëse. Mbas një periudhe kalimtare relativisht të shkurtër, serbët vunë në punë një program radiofonik shqipfolës që përgatitej në fakt në Beograd dhe i cili nuk ndiqej pothuajse fare nga kosovarët; ata mbështeteshin, me aq sa ishte e mundur, në emisionet perëndimore dhe në radiostacionet shqiptare. Me kalimin e viteve mediat, kryesisht gazetat dhe shtëpitë botuese, mërguan në drejtim të Shqipërisë dhe edhe të Maqedonisë e përherë gjeheshin udhë për të sjellë botimet e tyre ilegalisht në Kosovë.

Për të përftuar një tablo të njëmendësisë së atyre viteve, na duhet të kujtojmë se pushimet nga puna, dmth largimi i punëtorëve shqiptarë nga vendet e tyre të punës në shumicën e rasteve nuk bëhej në mënyrë të qytetëruar me shkrim dhe në një datë të caktuar - por shumë shpesh nëpërmjet përdorimit të dhunës. Kush nuk nënshkruante "hic et nunc" (?) se njihte sovranitetin e Republikës së Serbisë dhe se pranonte për pasojë si gjuhë të vetme zyrtare serbishten, shumë shpesh dëbohej nga policia serbe. Mjekët, profesorët dhe gjykatësit përbënin prenë kryesore të këtyre përndjekjeve.

Mbyllja e shkollave dhe universiteteve ka qenë për popullatën përjetimi më i hidhur; kështu, jo vetëm hidheshin në rrugë pa kurrfarë perspektive dhjetëra mijëra të rinj, por shkatërrohej edhe ëndrra e të gjithë prindërve shqiptar, për t'i pajisur fëmijtë e tyre me një arsim më të mirë e, për pasojë, për t'u krijuar atyre mundësi më të mira për jetën.

Këto mundësi u ishin krijuar mbas vitit 1974, nëpërmjet zgjerimit dhe përforcimit - siç e kemi përmendur tashmë - të statusit të autonomisë së provincës. Atëhere filloi vërshimi i të rinjve e, kryesisht i atyre që vinin nga fshatrat, në drejtim të shkollave të reja të mesme e të larta, mirëpo një mësymje të përmasave të këtilla nuk ishin në gjendje t'a përballonin as vetë shkollat dhe as konviktet e studentëve. Kushtet përnjëmend të papërshtatshme u jepnin shkas herëpashere trazirave studentore. Këto manifestime nxisnin kundërveprime të atypëratyshme në Kosovë në dy kampe politike diametralisht të kundërta, pra, tek nacionalistët ekstremistë, qofshin këta me prirje antikomuniste apo idhtarë të Enver Hoxhës, të cilët përpiqeshin të përcillnin parullat e tyre të "Shqipërisë së Madhe", si edhe tek udhëheqja zyrtare politike e provincës dhe anëtarët e Partisë Komuniste të Jugosllavisë. Udhëheqja politike e provincës ishte tepër e interesuar që këto trazira të mos bëheshin të njohura, mbasi kushti paraprak për ndryshimet kushtetuese të vitit 1974 patii qenë parashikimi, se nëpërmjet tyre do të arrihej qëllimi i synuar, dmth shndërrimi i kosovarëve në shtetas të kënaqur të Jugosllavisë.

Një gjë e tillë mund të arrihej vetëm nëpërmjet distancimit më të madh nga qendra e pushtetit serb në Beograd dhe hapjes së rrugëve drejt institucioneve arsimore. Prandaj duhej shmangur gjithashtu, dhe me çdo çmim, përcjellja e njoftimeve mbi trazirat dhe parullat antikomuniste të Kosovës tek mediat jugosllave e në radhë të parë tek ato serbe; bash për këtë arsye policia shqiptare e Kosovës ishte e para që përpiqej t'i mbyste këto lloj lëvizjesh që në djep, ndërsa

politikanët vendorë të shembnin me rrena kur bëhej fjalë për këto ngjarje. Andaj gazetarët e huaj shpeshherë e kanë patur të vështirë të kuptonin, pse "burime të besueshme" mund të njoftonin për demostrata, duke saktësuar vendet, datat si edhe numrin e të plagosurve 0e të arrestuarve, ndërsa zyrtarët mohonin në mënyrë të prerë se mund të kishin ndodhur "gjëra të tilla".

Si pasojë e ndërhyrjeve serbe në shkolla, segregacioni ka filluar qysh në gjysmën e dytë të viteve tetëdhjetë. Në oborret e shkollave u ngritën mure për ndarjen e fëmijëve, në mes të nevojtoreve u ndërtuan faqe muri të larta, mësimet zhvilloheshin veças paradite dhe mbasdite, ndërsa mësuesve dhe fëmijëve shqiptarë iu ndalua hyrja në biblioteka, në salla gjimnastike e në salla leksionesh si edhe përdorimi i mjeteve mësimore. Fëmijëve, të cilët deri atëhere kishin qenë të miqësuar fare normalisht midis tyre, tashti nuk u lejohej më të bisedonin me njëri-tjetrin. Shumë fëmijë të të dyja palëve nuk ishin në gjendje të kuptonin ç'po ndodhte. Të shpjeguarit e kësaj armiqësie të re nuk duhet të ketë qenë tepër e kollajshme as për prindërit.

Më 1990, kur u mbyllën përgjithësisht shkollat dhe automjete të blinduara me ushtarë të armatosur të Ushtrisë Popullore Jugosllave rrethuan ndërtesat shkollore (ka fotografi amatoriale të dëshmitarëve evropianoperëndimorë) në mënyrë që asnjë këmbë shqiptari të mos shkelte në shkollë, kjo ka qenë një ditë zie për popullatën. Në shumë qytete u zhvilluan manifestime proteste, gjatë të cilave shqiptarë të të gjithë brezave vërtiteshin të heshtur për orë të tëra përreth sipërfaqeve të bllokuara. Shumë të moshuar derdhnin lotë, ndërsa fëmijët qëndronin krejtësisht të heshtur. Madje, të krijohej përshtypja, se gjatë këtij aksioni as ushtarët serb nuk ndjeheshin bash mirë.

Në spitale mjekët serb zëvendësonin kolegët shqiptarë të dëbuar, ndërsa pacientët mungonin pothuajse krejtësisht. Shqiptarët u ndruheshin atyre dhe shtëpitë e lindjeve ishin thuajse të zbrazura; vizitorëve të huaj mosbesues u tregoheshin "pacientë shqiptarë", në fakt romë të vetmuar, të cilët shërbenin këtu thjesht si një zbukurim. Sistemi i përkujdesit shëndetësor, i organizuar në mënyrë shembullore (siç kanë patur rast të theksojnë ekspertët perëndimorë) kryesisht prej mjekëve shqiptarë, por edhe me ndihmën e kolegëve serb, u shpartallua plotësisht.

Këto dy lëmenjë - arsimi dhe shëndetësia - u rindërtuan sërish në "ilegalitet" mbas një periudhe të shkurtër tronditjeje të thellë e shastisjeje të specialistëve e të popullatës. Pa ndihmën e organizatave ndërkombëtare, të cilat furnizuan Kosovën me ilaçe dhe ambulanca kryesisht nëpërmjet organizatës bamirëse "Nënë Teresa", përballimi i këtyre detyrave do të kishte qenë thuajse i pamundur. Megjithatë, bazën financiare e përbënin në radhë të parë ndihmesat financiare të kosovarëve që jetonin në botën e jashtme. Për vite të tëra me radhë mësuesit, mjekët, farmacistët dhe infermierët shqiptarë, të shndërruar në të papunë kanë kryer pa pagë një veprimtari përnjimend të pabesueshme. Mandej, së fundi, filluan të shpërbleheshin me 40 dhe më në fund me 100 marka gjermane në muaj. Në qoftë se nuk do të kishte patur një bashkëpunim kaq të përsosur midis gjithë organizatave bamirëse e nismave private, kjo detyrë madhore, padyshim, nuk do të ishte njëmendësuar kaq mirë. Gjithsesi, në kushtet e dhëna nuk mund të mëtohet arritja e rezultave të përkryera. Pasojat e shkollimit të mangët të shumë brezave të nxënësve e studentëve si edhe mangësitë në sistemin e përkujdesjes shëndetësore do të jenë të ndjeshme edhe për një kohë të gjatë.

Mjaft herët, në fillim të viteve nëntëdhjetë, u krijua në Prishtinë "Komiteti për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut në Kosovë", kryetar i të cilit u bë shkrimtari Adem Demaçi, i quajtur "Mandela i Kosovës", ngaqë kishte kaluar 28 vjet në burgjet serbe. Me një shtab të zgjeruar bashkëpunëtorësh të shpërndarë në të gjithë Kosovën, mblidheshin fakte që kishin të bënin me shkeljet e papërligjura që "forcat serbe të rendit" bënin ndaj popullatës shqiptare. Njoftime të tilla, të hetuara saktësisht, botoheshin në buletine të rregullta në disa gjuhë dhe u dërgoheshim mediave dhe institucioneve të botës perëndimore. Marrësit e këtyre njoftimeve, me sa duket, nuk ishin shumë të interesuar dhe brenda një kohe të shkurtër "u ngopën" me keqtrajtimet e fëmijëve, grave, të rinjve e burrave, me grabitjet e dhunshme të tregjeve, shtëpive dhe dyqaneve, si edhe me bastisjet e kryera prej të afërmve të njësive ushtarake e paraushtarake serbe.

Për të kuptuar zhvillimet e mëvonshme të Kosovës është e rëndësishme të dihet se në këtë trevë të rinjtë gjatë gjithë jetës së tyre kanë përjetuar vetëm përvoja negative me serbët. Mbas trazirave të bujshme studentore të vitit 1981, të cilat u zvetënuan në përleshje të rënda të armatosura midis popullsisë së zemëruar shqiptare dhe forcave serbe të sigurimit, nën trysninë serbe me mijëra të rinj shqiptarë u dënuan me burgime drakoniane, ndonëse nuk qe e mundur t'u dëshmohej ndonjë përbetim apo veprimtari "terroriste". Shumë prej tyre kaluan tetë, madje edhe me tepër, vjet në burgjet serbe. Për pasojë, për t'i shpëtuar shtypjes dhe mungesës së perspektivës, qindra mijëra të rinj shqiptarë u arratisën në vendet evroperëndimore. Ata nuk ishin "refugjatë ekonomikë" në kuptimin klasik të kësaj fjale, ata nuk kërkonin kryesisht një jetë më të mirë, por ushqenin thjesht dëshirën për të mbijetuar. Përveç kësaj, ata e dinin mirëfilli se edhe familjeve dhe bashkatdhetarëve të tyre, po ashtu, për mbijetesën e tyre, u nevojiteshin para nga bota e jashtme perëndimore.

Mbi këtë gjendje hedhin dritë disa shifra; ato i janë parashtruar në qershor të vitit 1995 Komisionit për Emigracionin, Çështjet e Refugjatëve dhe Demografinë në Parlamentin Evropian nga profesori i Prishtinës Rifat Bllaku. Gjatë vitit 1994 janë zhvilluar, veç të tjerash, 5'407 kontrolle dhe bastisje shtëpish të ndërlidhura me keqtrajtime, fyerje, poshtërime e tortura, 777 shqiptarëve u janë marrë pasaportat, 4'008 njerëz janë rrahur me kërbaç. Është penguar rikthimi dhe riatdhesimi i një numri të papërcaktuar njerëzish, të cilët ishin punësuar përkohësisht në botën e jashtme dhe u është hequr e drejta e sigurimeve shoqërore fëmijëve; familje të tëra janë flakur prej shtëpive të tyre për të strehuar

atje serb dhe malazez. Serbët dhe malazezët janë armatosur në mënyrë të planifikuar për të mbjellë frikë e pasiguri dhe 2'868 njerëz janë mbajtur në paraburgim treditor.

Sipas të dhënave statistikore të pavërtetuara, gjatë mesit të viteve nëntëdhjetë në botën e jashtme jetonin rreth 500'000 kosovarë. Duhet hamendësuar se që atëherë kjo shifër është rritur qoftë edhe përkohësisht në mënyrë të ndjeshme. Pjesa më e madhe e vendeve evroperëndimore nuk u kishin njohur kosovarëve statusin e refugjatëve, mbasi politikanët qenë marrë vesh midis tyre për të mos e ligjësuar gjendjen në Kosovë si "spastrim etnik". Për pasojë, azilkërkuesve që vinin nga kjo trevë, në shumicën e rasteve përgjigjja negative u arsyetohej me pohimin se në vendin e tyre "nuk ekzistonin shkaqe për t'u arratisur" dhe se pasojat - shpeshherë të dëshmuara - të keqtrajtimeve mund të cilësoheshin si "normale". Madje, në mënyrë të nënndërgjegjshme dyshohej se qëndrimi i policisë mund të ishte kushtëzuar nga shkaqe "politike". Vendime të tilla të Ministrive të Punëve të Brendshme, në pjesën më të madhe të rasteve, mbështetshin në informata të siguruara në "mëmëdheun Serbi".

Pra, disa qindra mijëra të rinj kosovarë, të shpërndarë në botën e jashtme, jetonin kështu në kushte ilegaliteti, nën trysninë e kërcënimit të vazhdueshëm për t'u kapur nga policia e për t'u kthyer mbrapsht - në Beograd (!). Edhe për vetë rrethanat e tyre ata bënin një jetesë të mjerueshme, ushqeheshin keq, shpesh flinin edhe me dhjetë persona të tjerë në një dhomë duke u ndërruar me turne, shoqëroheshin vetëm me njëri-tjetrin, kishin kontakte fare të pakta me popullatën vendase dhe, prandaj, nuk mësonin as gjuhën e vendit. Nga ana tjetër shumica e të rinjve ishin myslimanë dhe prandaj përdorimi i alkoolit nuk luante ndonjë rol të posaçëm. Edhe seksionet e jashtme të LDK-së (Lidhjes Demokratike të Kosovës) kontaktet e tyre me këta refugjatë i kishin përqëndruar vetëm në drejtim të mbledhjes së tre përqindshit të të ardhurave të tyre, nëpërmjet të cilit duhej të financoheshin "institucionet hije" në atdhe. Këto të ardhura në një masë të madhe mund të siguroheshin vetëm përmes punës në të zezë.

Personat që mund të siguronin të ardhura më të mëdha, ose që punonin prej kohësh legalisht, i dërgonin vetë paret, shpeshherë në rrethana aventureske, në Kosovë për t'ia dorëzuar atje në dorë familjeve të tyre. Kjo ndodhte mbasi aty mungonte si Banka e Kosovës, depozitat e së cilës ishin hequr që andej qysh më 1990, ashtu edhe një postë, tek e cila popullata shqiptare do të mund të kishte besim. Të gjithë nëpunësit shqiptarë të administratës së postave të Kosovës ishin zëvëndësuar me serb menjëherë mbas pushtimit. Për popullsinë shqiptare mungonin institucionet sociale si ndihma për të papunët, nuk kryheshin pagesat e pensioneve e të invalidetit, nuk kishte më autoritete zyrtare, të cilat duhet të merreshin me nevojat, kërkesat e saj, etj. Madje, as vjedhjet apo grabitjet nuk mund të ndiqeshin më penalisht.

Në mënyrë të ndërgjegjshme apo të pandërgjegjshme disa media të caktuara të vendeve pritëse, ku ndodhej një numër më i madh kosovarësh, kanë mbështetur qëndrimin shtrëngues të Ministrave të Brendshëm të vendeve të Bashkimit Evropian - si edhe makinerinë propagandistike antishqipare serbe - duke vënë tellallin për veprimet kriminale të të rinjve nga Kosova dhe duke krijuar kështu në radhët e opinionit publik përshtypjen se shumica dërrmuese e kosovarëve janë kriminelë. Thënë me fjalë të tjera: askush (me përjashtim të disa nismave humanitare private tepër të rralla) nuk është përkujdesur për ta, për t'i ndihmuar ata në një mjedis të huaj. Askush në Perëndim nuk është përpjekur t'a shkoqisë imtësisht problemin e Kosovës e prandaj nuk është përpiluar ndonjë plan, për shembull, sesi do të ishte e mundur që, nëpërmjet shkollimit, këta të rinj të përgatiteshin për t'u rikthyer në atdheun e tyre.

Pra, për këta kosovarë nuk kishte alternativë. Ata - në shumicën e rasteve duke patur një shkallë arsimi mi tepër të kufizuar, ngase vetë arsimi në Kosovë, siç e kemi përmendur tashmë, ishte gjymtuar rëndë qysh gjatë viteve tetëdhjetë - ishin shkëputur në mënyrë të dhunshme prej lidhjeve të tyre të ngushta familjare që bënin pjesë në traditën e Kosovës dhe nuk qenë përgatitur paraprakisht për të bërë në rrethana të panjohura një jetesë të pavarur e duke marrë mbi vete përgjegjësitë përkatëse. Përpjekjet e agjitatorëve të qarqeve politike ekstremiste të Kosovës e të Shqipërisë, në shumicën e rasteve idhtarë të Shqipërisë së Madhe, u lehtësuan së tepërmi atëherë kur, në marrëveshje me Qeverinë Serbe të Beogradit, edhe Zvicra iu bashkangjit aksionit të një rikthimi pak a shumë kolektiv, të vendosur nga Ministrat e Brendshëm të vendeve të Bashkimit Evropian në kuadrin e Marrëveshjes së Shengenit. "Desperadove" të rinj iu krijua mundësia që me UÇK-në (Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës) të luftonin me armë në dorë për "lirinë" e për një të ardhme më të mirë të atdheut të tyre. Ideali i heroit patriot dhe i vdekjes therorizuese i ngulitet çdo shqiptari qysh në fëmijërinë e tij. Po ashtu, si edhe çdo serbi.

Presidenti Ibrahim Rugova - që kishte qenë President i PEN-Klubit të Kosovës deri kur filloi të angazhohej politikisht - dhe Qeveria në mërgim, e kryesuar nga urologu Bujar Bukoshi dhe e krijuar në vitin 1992, u përpoqën për vite me radhë - jo gjithnjë bashkërisht - të bindin Perëndimin për rrezikun e ndrydhur në "fuçinë e barutit Kosovë". Këtë gjë ata e bënin me mënyrën e tyre, dmth me përzemërsi, me zë të ulët dhe pa patur një koncept të qartë politik se çfarë duhej të bënte në fakt Perëndimi për të mbështetur një zgjidhje paqësore të problemit kosovar, i cili edhe ligjërisht ishte i ndërlikuar. Atyre iu mungonte, po ashtu, çdo lloj përvoje përsa u përket qëndrimeve që duheshin mbajtur ndaj mediave e metodave të veprimtarisë propagandistike (Public Relations) dhe prandaj popullsia vendase mbeti pak a shumë e painformuar mbi veprimtarinë e zhvilluar prej politikanëve të saj në rrafshin ndërkombëtar, dukuri kjo që, me përjashtim të disa lajmeve të thata lidhur me "vizitën e Ibrahim Rugovës në ....", spikaste edhe tek opinioni publik perëndimor.

Këtu nuk mund të shqyrtojmë imtësisht gabimet e bëra nga të dyja palët, pa të cilat nuk do të kishte arritur puna deri tek shkallëzimi i ngjarjeve. Po mjaftohemi me kaq: përgjithësisht politikanët kosovarë si edhe kosovarët, pësuan një zhgënjim të hidhur kur vunë re se "Perëndimi" fare hapur nuk ishte i prirur të vlerësonte në mënyrë të merituar kundërveprimet e padhunshme të shqiptarëve ndaj provokimeve serbe. Dhe, për pasojë, nuk çmonte se në ç'përmasa i dedikohet bash këtij qëndrimi të njerëzve në Kosovë fakti që zhvillimet e atyshme nuk u futën në hullinë "boshnjake". Përkundrazi, në qendrat vendimmarrëse të Perëndimit qetësia fiktive në Kosovë përshëndetej vetëm për aq sa lejonte krijimin e përshtypjes se ndërmarrja e një përçapjeje - qoftë edhe kundrejt Beogradit - ishte e panevojshme. Çfarë gabimi me pasoja të rënda!

Në periudhën 1997-1998 u dhanë shenjat e para që tregonin se në Kosovë fuçia ishte gati në të derdhur. Pati veprime të dhunshme të shkëputura - me sa duket ende të paorganizuara - kundrejt policëve serb. Mandej, brenda një kohe të shkurtër, në vitin 1998, përfaqësuesit e UÇK-së u paraqitën në skenën publike dhe pohuan hapur synimet e tyre, asokohe ende shqiptaromëdha. Nuk ka dyshim që ata kishin një nuhatje të hollë për veprimtarinë propagandistike (Public Relations), mbasi për ta shumë shpejt filloi të flitej gjithnjë e më shpesh në mediat ndërkombëtare.

Në mars të vitit 1999, mbas luftërave të brendshme për pushtet në drejtim të udhëheqjes dhe strategjisë së UÇK-së, si drejtues i Drejtorisë Politike të UÇK-së u emërua Hashim Thaçi, i cili nuk kishte mbushur ende 30 vjeç. Miqtë e tij parashikonin që ai do të bëhej kryetari i qeverisë së ardhshme të Kosovës. Mendohej se ishte "i moderuar". Fillimisht u shfaq si drejtues i delegacionit shqiptar në bisedimet e Rambujesë, të cilat synonin një zgjidhje politike të konfliktit që po merrte përmasa gjithnjë e më të përgjakshme në Kosovë. Thaçi u përkrah fuqimisht kryesisht prej Ministres së Jashtme të SHBA-ve, Madlen Ollbrajt dhe ambasadorit Volfgang Petriç, anëtarit austriak të "trojkës", e cila ishte ngarkuar prej Bashkimit Evropian dhe OSBE-së për drejtimin e bisedimeve për paqe. Prandaj u krijuan mundësitë që brenda vetë delegacionit shqiptar Thaçi të përjashtonte politikisht Rugovën "ende" President dhe anëtarët e qeverisë së tij në mërgim. Pra, UÇK-ja u shndërrua nga "terroriste" e "rebele" në "ushtri çlirimtare" dhe u bë kështu përfundimisht një faktor politik i njohur në rrafsh ndërkombëtar.

Në janar të vitit 1999 për gjendjen humanitare në Kosovë - e cila nxiti vendimin e Nato-s - njiheshin shifrat e mëposhtme. Qysh në fillim të muajit ishin vrarë 151 njerëz, midis të cilëve 28 fëmijë, 28 gra dhe 36 të moshuar. Si pasojë e shpërthimit të luftimeve të tanivonshme vetëm gjatë këtij muaji 45'000 njerëz u detyruan të braktisin shtëpitë dhe banesat e tyre, duke rritur numrin e refugjatëve në gjithsej 350'000 vetë. Pra, në fund të janarit nga arratisjet dhe dëbimet ishte prekur drejtpërsëdrejti rreth 20 për qind e popullatës së Kosovës dhe tërthorazi një numër dy herë më i madh njerëzish.

Përsa i përket rrjedhës me të vërtetë dramatike të bisedimeve të Rambujesë, pushimit dyjavor deri në vazhdimin e tyre më 15 mars në Paris, ku delegacioni shqiptar, mbas një ngurrimi të gjatë, nënshkroi marrëveshjen, ndërsa ai serbo-jugosllav jo, duke mbartur kështu përgjegjësinë për pasojat ogurzeza, janë dhënë njoftime të hollësishme nga të gjitha mediat, ndërsa ndërhyrjen e Nato-s e kemi trajtuar tashmë në një kapitull më vete. Prandaj këtu më poshtë do t'a përqëndrojmë vëmendjen tek marrëdhëniet midis përfaqësuesve ndërkombëtar të "paqës" dhe popullsisë shqiptare, përfshirë edhe politikanët e saj që ndryshojnë shumë nga njeri-tjetri.

Fakti që, në kuadrin e bisedimeve mbi përfundimin e luftës në Bosnje-Hercegovinë dhe vendosjen e piketave për arritjen e paqes, të zhvilluara më 1994/1995 në bazën ushtarake ajrore të SHBA-ve në Dejton, nuk u trajtua njëkohësisht edhe problemi i Kosovës - ky ishte çmimi për nënshkrimin e domosdoshëm të Presidentit të asokohshëm serb Sllobodan Millosheviç - përbën një problem në vete. Ndërsa fakti që bashkësia ndërkombëtare nuk nxori asnjë mësim nga përvoja e Marrëveshjes së Dejtonit, është një problem tjetër. Në Bosnje-Hercegovinë po ashtu si edhe në Kosovë mungon një koncept i qartë për hedhjen e themeleve të një zhvillimi paqësor në të ardhmen. Këto themele duhet të kenë parasysh si problemet e shkaktuara prej përplasjeve ushtarake, ashtu edhe shkaqet e tyre të periudhës së paraluftës. Politikanët perëndimorë nisen me të drejtë nga një "urrejtje e rrënjosur thellë" midis serbëve dhe shqiptarëve. Mirëpo përsa i përket të ardhmes së Kosovës mungojnë analizat për të përcaktuar, sesi mund të kapërcehet, apo të paktën, të zbutet kjo urrejtje.

Mësymjet ajrore të Nato-s në territorin jugosllav filluan më 24 mars 1999 dhe u ndërprenë më 10 qershor, kur udhëheqja jugosllave filloi tërheqjen - për të cilën ishte rënë në ujdi - të njësive të saj ushtarake nga Kosova. Deri atëhere 800'000 njerëz të dëbuar apo të larguar për shkak të frikës së përligjur kishin marrë arratinë nga Kosova, mbasi kishin përjetuar më parë një dhunë të papërfytyrueshme. Gjatë zhvillimeve të mëtejshme "mrekullia" e madhe ishte se menjëherë mbas ndërprerjes së veprimeve luftarake 700'000 shqiptarë të arratisur u rikthyen menjëherë në fshatrat dhe qytetet e tyre. Në fakt shumë prej tyre nuk kishin më qoftë edhe një çati mbi kokë, por kishin shpresën, dhe për pasojë edhe forcën - në kundërshtim me boshnjakët e rikthyer - për të filluar rindërtimin e shtëpive dhe në këtë mënyrë edhe të së ardhmes së tyre. Mirënjohja e tyre kundrejt Nato-s dhe në përgjithësi ndaj krejt Perëndimit ishte shumë, shumë e madhe dhe që këndej filluan edhe problemet.

Askush nuk duhet të befasohet që njerëzit e ndodhur në gjendjen e këtyre refugjatëve nuk kundërveprojnë dhe mendojnë në mënyrë të arsyeshme, por emocionale. Kosovarët besonin se Nato-ja dhe bashkësia ndërkombëtare i kishin

ndihmuar kundër serbëve, në mënyrë që ata, dmth shqiptarët e Kosovës, të mund të bëheshin më së fundi "zotër në shtëpinë e tyre", siç e formuloi në shtator 1999 gjatë një bisede private në Prishtinë Rugova "ende" President. Entusiazmi i skajshëm i verës së vitit 1999, menjëherë mbas ndërprerjes së veprimeve luftarake, e kishte burimin tek ndjenja e mirënjohjes, por edhe tek kjo shpresë. Fakti që kjo shpresë ishte krejtësisht e papërligjur, mbasi bisedimet për paqe nuk synonin një "Republikë të pavarur të Kosovës", por gjetjen e një "modus vivendi" midis serbëve dhe shqiptarëve në këtë trevë, u kuptua prej shqiptarëve me vonesë. Kosova formalisht do të vazhdonte të bënte pjesë në Serbi dhe Jugosllavi, të paktën deri sa të zhvillohej mbas tre vjetësh një referendum për të ardhmen e mëtejshme. Gjithsesi Millosheviçi, duke pranuar protektoratin ndërkombëtar, kishte hequr dorë tashmë "de facto" nga sovraniteti mbi këtë provincë. Ai e mohonte politikisht këtë fakt dhe përpiqej herëpashere me anën e protestave dhe kërkesave të mbante në fuqi mëtime të ligjshme, deri tashti në mënyrë të pasuksesshme.

Domethënia konkrete e marrëveshjes së përfunduar me bashkësinë ndërkombëtare mbi kompetencat e UNMIKU-t dhe KFOR-it - një protektorat "de facto" për kohëzgjatjen e ndërtimit të një rendi shoqëror demokratik në Kosovë - u dëshmua menjëherë falë pranisë së dukshme të automjeteve ushtarake të të gjitha përmasave, me ushtarë nga pjesët më të ndryshme të Botës, në rrugicat e ngushta dhe rrugët e rrënuara të këtij rajoni. Kosova u nda në sektorë administrativë, të cilët ndodhen nën komandën e eprorëve të lartë nga radhët e trupave të Natos-s. Kontaktet me vendasit ishin të vështira për shkak të problemeve gjuhësore.

Esëllimi i opinionit publik shqiptar ndodhi për shumë arsye. Njëra prej tyre ishte terminologjia e përdorur prej shefit të UNMIK-ut, mjekut francez të fëmijëve Bernar Kushner. Ai bënte fjalë, midis të tjerash, për synimin e ndërtimit të një shoqërie "multietnike". Ai kërkonte që serbët dhe shqiptarët të organizonin bashkërisht rindërtimin e universiteteve dhe shkollave. Ai lëshoi një urdhër, sipas të cilit nëpunësit e dikurshëm shqiptarë duhej të rikthehesin bashkërisht me kolegët e tyre serb në vendet e tyre të punës pranë organeve shtetërore. Nevojën e ngutshme për një trupë policore - duke patur parasysh pështjellimin e përgjithshëm në rritje si edhe aktet e hakmarrjes ndaj serbëve e romëve dhe pronave serbe - ai e zgjidhi nëpërmjet angazhimit të përkohshëm të një policie të njësive të KFOR-it, deri sa të sigurohej numri i nevojshëm i njerëzve për ngritjen e një policie profesioniste. Fakti që disa njësi ushtarake serbe nuk u tërhoqën, siç ishte përcaktuar në marrëveshjen e arritur midis Nato-s dhe Millosheviçit, në një vijë që duhet të ndodhej 25 km larg kufirit serbo-kosovar, por u ngujuan në qytetin kufitar të Mitrovicës (Kosovosko Mitrovica) që gjendet në sektorin francez, u pranua heshturazi. Shqiptarët u befasuan. Brenda disa muajve ky befasim u shndërrua në zemërim.

Përsa i takon problemit të Universitetit të Kosovës, shqiptarët duhet të kenë patur përshtypjen se shefi i UNMIK-ut bashkë me këshilltarët dhe bashkëpuntorët e tij, nuk kishin fare haber nga e kaluara, kur ata filluan të kërkojnë bashkëpunimin "multietnik" në këtë lëmë. Kushneri priste që 15'000 studentë serb dhe 17'000 studentë shqiptarë të punonin në paqe pranë njëri-tjetrit. Së pari, në të kaluarën nuk ka patur kurrë një numër kaq të madh studentësh serb në Kosovë, ndonëse më 1992 serbët kishin mbledhur studentë edhe nga pjesët e tjera të Serbisë dhe, së dyti, këta studentë, sapo filloi konflikti i armatosur, nuk munguan të japin ndihmesën e tyre për shpartallimin e plotë të të gjithë inventarit të Universitetit.

Një juriste shqiptare, e cila kishte punuar para pushtimit në administratën shtetërore të Prishtinës në seksionin e regjistrimit të qytetarëve, e përshkruan kështu ditën e parë të punës në verën e vonshme të vitit 1999: "Ne ishim gjashtë shqiptarë dhe shqiptare e dy serb që sipas rregullave duhej të rikthehesim në zyrat tona e të vazhdonim atje punën. Organet ndërkombëtare ndofta nuk ishin në dijeni, mirëpo ne e dinim mirëfilli se kishin qenë bash këta serb, të ardhur atje mbas flakjes sonë nga puna në vitin 1991, të cilët, kur u erdhi atyre radha për t'u larguar, shkatërruan gjithë inventarin, duke asgjësuar çdo fije letër e çdo dokument të veçantë .... Dhe ne tashti duhej ....? Ne nuk u thamë asgjë serbëve, por ata nuk erdhën më ditën tjetër ...."

Përsa i përket çështjes së policisë, policët shqiptarë të mbetur pa punë qysh nga pushtimi, të cilësuar parimisht nga UNMIK-u si të papërshtatshëm për përballimin e detyrave aktuale, pyesin vetveten, vallë a nuk e dijnë përfaqësuesit ndërkombëtarë, së pari, se qindra prej tyre kanë dalë mbas vitit 1992 para gjykatave serbe dhe në kushtet e një procesi të montuar janë dënuar me afate të gjata burgimi e, së dyti, se shkollimi profesional, që ata kanë marrë para vitit 1990 ka patur vlera më se të qëndrueshme dhe prandaj e ndiejnë veten plotësisht në lartësinë e kërkesave të sotme. Gjithsesi ata do të kishin qenë më të përshtatshëm sesa kolegët e huaj, mbasi në fund të fundit secili shqiptar e di menjëherë, kur bëhet fjalë për një të dyshuar, se nga ç'fshat dhe ç'familje vjen ai. Të huajt, përkundrazi, që në krye, rrezikohen të bien pre e keqkuptimeve dhe dështimeve e, rrjedhimisht, të vënë në diskutim autoritetin dhe aftësitë e tyre. Ato nuk ndihmohen vetëm me anën e përkthyesve .... dhe, së treti, policët e pakët shqiptarë të punësuar tashmë së fundi së bashku me policinë ndërkombëtare, fyhen së tepërmi nga fakti që marrin një pagë qesharake në marka gjermane, në një kohë që kolegët e tyre të huaj paguhen me një shumëfish në dollarë. Nga radhët e tyre dëgjohen zëra, që thonë: "Na trajtojnë sikur të ishim diletantë dhe sikur t'a kishim humbur ne luftën ...."

Përsa i përket tashti gjendjes në Mitrovicë (Kosovska Mitrovica) duhet thënë se mosbesimi i palës shqiptare përsa u përket qëllimeve të mira të KFOR-it është përqëndruar tek rusët dhe francezët. Shqiptarët nuhasin rrezikun e përkrahjes së fshehtë të planit serb për t'a ndarë Kosovën dhe për t'a miratuar vetëm pastaj marrëveshjen përfundimtare për një "republikë të pavarur".

Mbas rreth një gjysmë viti vetë Kushneri ka pranuar haptazi, se gjatë periudhës fillestare kishte bërë marrëzira dhe u kishte besuar këshilltarëve të rremë. Një pohim i këtillë në fakt është mjaft i pëlqyeshëm, por dëmi tashma ishte shkaktuar.

Nga ana tjetër, vetë pala shqiptare nga ana e saj ka bërë gabime parimore dhe ka treguar dobësi, të cilat nuk i kanë ndihmuar punonjësit e UNMIK-ut e të KFOR-it, për të gjetur një rrugë më të mirë. Në radhë të parë politikanët shqiptarë kanë patur midis tyre grindje kaq të mëdha, saqë nuk kanë qenë në gjendje të ndiqnin në mënyrë këmbëngulëse të vetmen detyrë të rëndësishme, dmth arritjen e një marrëveshjeje mbi një të ardhme më të mirë të Kosovës; po ashtu nuk kanë qenë në gjendje të përpilonin një platformë të përbashkët politike, e cil do t'u lejonte të paraqiteshin si partnerë bashkëbisedimesh me Kushnerin dhe bashkëpunëtorët e tij. Ngjarjet rrodhën pastaj për të mbërritur tek "këshilltarët e rremë" dhe u humbën shumë mundësi për të ruajtur apo fituar dashamirësinë e Perëndimit. Opinioni publik perëndimor është i indinjuar sot kryesisht për faktin që shqiptarët po bëjnë tashti kundrejt serbëve dhe romëve po ato krime që ka kryer më parë ndaj tyre pala serbe. Këta shqiptarë kërkojnë haptazi një Kosovë "të pastër etnikisht". Nuk është për t'u çuditur që tashmë edhe partnerët ndërkombëtar të bashkëbisedimeve janë zhgënjyer prej shqiptarëve.

Parlamenti i Kosovës, Qeveria në mërgim dhe Presidenti Rugova dhanë dorëheqjen në fund të vitit 1999. Qysh atëhere qeveris një "Këshill i Përkohshëm", i caktuar nga UNMIK-u, ku shqiptarët nuk kanë kompetenca, por vetëm funksione këshillëdhënëse.

Zgjedhjet janë parashikuar të zhvillohen në vjeshtë 2000.

Sidoqoftë në kushtet e kësaj gjendje që ka marrë për ters, fakti që zhvillimet në Kosovë ndryshojnë nga sektori në sektor, duhet cilësuar si fatmirësi. Në sektorin gjerman e ate austriak - për të përmendur vetëm këta të dy -, me sa duket, pothuajse çdo gjë ecën në udhë të mbarë dhe po punohet bashkërisht në projekte që kanë perspektivë, ndëra nga sektorët e tjerë dëgjohen ankesa për korrupsion, prostitucion dhe përdorim të tepëruar alkooli. Edhe popullsisë shqiptare nuk i ka shpëtuar pa vënë re se bashkëpunimi ndërmjet organizatave të ndryshme ndërkombëtare, që konkurojnë dhe intrigojnë kundër njëra-tjetrës, nuk është aspak i mirë dhe se deri sot nuk mund të bëhet fjalë për një koncept të njësuar.

Me fjalë të tjera: pamja e së ardhmes së Kosovës përbën ende një çështje plotësisht të hapur. Mirëpo qysh tashti dihet mirëfilli të paktën një gjë: brenda Serbisë, Kosova nuk ka të ardhme. Shqiptarët e Kosovës, duke patur parasysh përvojën e tyre të dhjetëvjeçarëve të fundit me regjimin serb, nuk do të pranojnë kurrsesi një zgjidhje të tillë. Po kështu edhe mbas rrëzimit të regjimit të Millosheviçit.

Megjithatë shqiptarët e Kosovës duhet t'a pranojnë se nuk mund të ketë një Kosovë "etnikisht të pastër shqiptare". Ata duhet t'a kuptojnë se duhet të krijojnë një shtet që t'u përgjigjet normave ndërkombëtare, në të cilin të gjithë qytetarët gëzojnë të drejta të barabarta. Kjo do të thotë që përfshin edhe serbët, të cilët do të dëshirojnë të jetojnë atje.

Një krijese të tillë shtetërore i nevojitet përkrahja ndërkombëtare për të përcaktuar, midis të tjerash, sesi dhe ku do të nxirren para gjyqit kriminelët e luftës të të dyja palëve. Kjo përbën kushtin paraprak të domosdoshëm për krijimin e një baze të re mirëkuptimi midis të dy popujve. Kushti tjetër paraprak qëndron në faktin se kjo trevë ka një të ardhme ekonomike.

SA ËSHTË "PJEKUR PËR EVROPËN" "BALLKANI LINDOR"?

Rumania e dyzuar - ndërmjet Evropës Qëndrore dhe Detit të Zi

Sidoqoftë, që të vlerësohen rezultatet e Konferencës së Parë të Dhuruesve, dmth të konferencës së financuesve të Paktit të Qëndrueshmërisë (Stabilitetit) të pranverës së vitit 2000, me plotësisht të drejtë një njeri duhet të ketë mbetur i kënaqur prej saj dhe ky është Kryetari i Bashkisë së Kalafatit, një vendi të humbur buzë Danubit në Rumaninë Perëndimore. Në fakt, shtetet dhe institucionet financiare që duhet t'i japin frymën jetëdhënëse marrëveshjes për konsolidimin e Ballkanit, vendosën të financojnë ndërtimin e planifikuar tashma prej kohësh të një ure, e cila lidh Kalafatin me Vidinin në skajin veriperëndimor të Bullgarisë.

Kjo urë nuk përbën një çështje thjesht lokale, ajo është gjymtyra lidhëse e të ashtuquajturit korridor i katërt, që në zbatim të qëllimit këmbëngulës të Bashkimit Evropian duhet të krijojë ndërlidhjen e re nga Evropa Qëndrore në drejtim të juglindjes deri në Turqi. Kjo udhë, në qoftë se Serbia do të vazhdojë edhe në të ardhmen të mbajë një qëndrim të mënjanuar ndaj Evropës Qëndrore e Perëndimore, do t'i bjerë përqark këtij vendi, por do të përbëjë gjithsesi një lehtësim të ndërlidhjes veri-jug që kalon nëpër Jugosllavinë e dikurshme.

Megjithatë, derisa të vihet në përdorim të plotë ura e re, do të duhet të kalojë edhe një farë kohe, edhe sikur Rumania e Bullgaria të tregohen tepër të zellshme për ndërtimin e saj, mbasi, si pala rumune, ashtu edhe ajo bullgare, më parë duhet të zgjerojnë e përmirësojnë rrugët që të shpijen tek ura. Kryesisht në Rumani, rruga që të shpie nga kufiri hungarez në Oradea mbi Debën dhe Grajovën në drejtim të Danubit, tani për tani është pothuajse krejtësisht e papërshtatshme për përballimin e një trafiku të dendur kamionash. Ajo gjarpëron përmes luginave të ngushta dhe qafave të Karpateve, gjë vërtetë shumë joshëse nga pikëpamja e peisazhit, por ajo duhet zgjeruar e përmirësuar në mënyrë të ngutshme.

Bashkërenditësi i Paktit të Qëndrueshmërisë (Stabilitetit), Bodo Hombah, ka premtuar tashma për këtë qëllim 300 milionë euro. Qeveria rumune shpreson, para së gjithash, të përmirësojë kështu infrastrukturën në luginën e Shillit (luginën Jiu), duke krijuar njëkohësisht vende të reja pune për minatorët e mbetur

pa punë të Petroshanit e të rrethinave të tij, një trevë, e cila si pasojë e ndërprerjes së veprimtarisë së minierave të atyshme, është shndërruar në zonën më të mjeruar të të gjithë Rumanisë. Duke përmirësuar infrastrukturën e kësaj treve, Qeveria e Bukureshtit ndjek dy pikësynime: mëkëmbjen e gjendjes ekonomike e sociale të luginës së Shillit dhe krijimin e një rrjeti rrugor modern në drejtim të urës së re, mbasi - siç është shprehur kryeministri rumun Mugur Isaresh - " përndryshe ajo do të mbetet vetëm një përmendore".

Ura Kalafat-Vidin përbën, megjithatë, vetëm njërën nga temat e marrëdhënieve midis Rumanisë dhe Bashkimit Evropian dhe, madje, jo më të rëndësishmen. Rumania, së bashku me Bullgarinë, Sllovakinë, Lituaninë e Letoninë bën pjesë në grupin e dytë të vendeve me të cilat, në vazhdën e zgjerimit të Bashkimit Evropian në drejtim të Lindjes, duhen zhvilluar bashkëbisedime për përfshirjen e tyre në këtë Bashkim. Këto bashkëbisedime me Rumaninë kanë filluar tashma dhe në Bukuresht janë tejet të kënaqur me rrjedhën e tyre të deritanishme. Sidoqoftë deri tashti nuk janë cekur ende temat me të vërtetë të vështira si përshtatja e ligjeve dhe institucioneve të Rumanisë ndaj atyre të Bashkimit Evropian, apo bujqësia dhe ekologjia.

Në fakt tabloja që ofron Rumania është e dyzuar: midis të ashtuquajturve vende në tranzicion, dmth të shteteve të qeverisura në të kaluarën nga komunistët, ajo ka filluar ndjekjen e pakushtëzuar të kursit të reformave në një periudhë relativisht të vonshme. Qeveria e Bukureshtit nën drejtimin e Jon Ilieskut, një funksionari të lartë të periudhës së Çausheskut, mbas përmbysjes dhe ekzekutimit të "kondukatorit" (Conducator = prijës) deri në vitin 1992, ka mbajtur një qëndrim antidemokratik e antiperëndimor. Në Bukuresht spekullohej me idenë e një brezi shtetesh komuniste moderne, me shtrirje nga Baltiku deri në Detin e Zi, një lloj "zone tampon" midis shteteve të Nato-s dhe Rusisë, të qeverisura në frymën e Gorbaçovit.

Mbas shkrirjes së Paktit të Varshavës, Rumania qe i vetmi prej vendeve të Bllokut Lindor që lidhi me Bashkimin Sovjetik - asokohe ende ekzistues - një marrëveshje dypalëshe për "Bashkëpunimin, Fqinjësinë e Mirë dhe Miqësinë". Iliesku filloi të ndjekë një kurs të matur reformash dhe t'i afrohej në mënyrë të kujdesshme Perëndimit, vetëm atëhere kur u pa qartazi se këto ide nuk tejkalonin cakun e iluzioneve. Megjithatë, deri në vitin 1996, kur atë nuk e zgjodhën sërish, ngjarjet rrodhën si gjatë një valleje, ku dy hapa të hedhura përpara ndiqen nga një hap prapa. Kjo gjë shfaqet qartazi, veç të tjerash, edhe në faktin që, nga njëra anë, Rumania ishte shteti i parë evropianolindor i përfshirë në Partneritetin për Paqe të Nato-s dhe i anëtarësuar qysh më 1993 në Këshillin e Evropës. Por, në anën tjetër, strukturat e brendshme mbetën të pacënuara, duke e shtyrë kështu eksperten për çështjet e Rumanisë pranë Institutit të Evropës Juglindore në Mynik, Aneli Ute Gabonij, të arrinte në përfundimin se "Për shtatë vjet Rumania do të mbetet e përjashtuar nga përpjekjet që do të ndërmirren në të gjitha vendet e Evropës Lindore në drejtim të lirisë individuale, normalitetit ekonomik, rindërgjegjësimit për vlerat e qytetërimit dhe riafrimit të vendit ndaj sistemeve perëndimore të ekonomisë, politikës e sigurisë kombëtare".

Kjo ishte përkatësisht trashëgimia, me të cilën u përballën Presidenti i ri Emil Konstadinesku dhe Qeveria e qendrës së djathtë, kur morën përsipër në vitin 1996 përgjegjësinë e qeverisjes së vendit. Rumania qe izoluar nga tregjet financiare ndërkombëtare, rezervat e saj valutore ishin minimale, privatizimet ishin të ngadalshme dhe zhvilloheshin në forma të dyshimta e, rrjedhimisht, edhe interesimi i botës së jashtme për investime ishte tejet i pakët. Në lëmin e ekonomisë mbizotëronte ndikimi shtetëror, kurse njohja e mekanizmave të ekonomisë së tregut ishte në një shkallë tejet të ulët. Të gjithë këto rrethana patën për pasojë që deri në vitin 1997 Komisioni i Bashkimit Evropian të qe i mendimit, se Rumania nuk ishte pjekur ende për fillimin e bashkëbisedimeve për anëtarësimin në BE.

Ndërkohë në Bruksel qëndrimi në fjalë i është nënshtruar një rishyrtimi dhe në pranverën e vitit 2000 bashkëbisedimet e anëtarësimit janë vënë gjithsesi në lëvizje. Presidenti Konstandinesku dhe Qeveria kanë bërë përpjekje të dukshme për të bindur Bashkimin Evropian dhe institucionet financiare ndërkombëtare mbi qëllimin këmbëngulës për kryerjen e reformave dhe displinën financiare të Bukureshtit, ndonëse politika e ndjekur për kryerjen e reformave kushtëzohet nga fërkime të brendshme sociale.

Problemet e mëdha të Rumanisë, siç duket, mund të zgjidhen vetëm me etapa. Kjo ka të bëjë, në radhë të parë, me mbrojtjen e mjedisit, çështje për të cilën gjatë periudhës së komunizmit dhe në vitet që pasuan përmbysjen nuk është brengosur askush. U desh katastrofa e fundjanarit të vitit 2000, kur nga një minierë ari në Rumaninë Veriperëndimore u derdhën disa mijëra metra kub solucion cianuri dhe ujëra me përmbajtje metalesh të rënda në lumin e Teisit, duke asgjësuar atje, si edhe në ujrat e Danubit që kalojnë në Hungari dhe Serbi, çdo qenie të gjallë, për të kuptuar çfarë pasojash mund t'i sjellin vendit dhe mjedisit pajisjet industriale të vjetëruara e të lëna pas dore. Ajo u pasua në mars nga një çarje dige në minierën Jasa të rrethit të Kluzhit. Kjo çarje i solli dëme më të pakta mjedisit, por, si këmbanë alarmi, ajo kurrsesi nuk duhet shpërfillur.

Në Rumani, siç kemi përmendur tashma më lart, edhe bujqësia, ku punojnë ende 40 për qind e punonjësve (për krahasim: në Sllovaki numri i tyre ka mbetur vetëm 10 për qind), ka nevojë për një rregullim të ri; mbas përmbysjes, reforma bujqësore ka krijuar shumë miniferma, të cilat me vështirësi mjaftojnë për t'u siguruar jetesën bujqve, e jo më për një prodhim tej këtyre caqeve. Pushtetarëve të Bukureshtit, cilido qoftë orientimi i tyre politik, krahas këtyre dy problemeve të mëdha, u duhet të përballen edhe me domosdoshmërinë e reformave të mëtejshme. Këtu gjejmë aparatin e harlisur të institucioneve zyrtare, i cili shquhet për ekzistencën e qortuar në mënyrë të përsëritur nga ana e ndërkombëtarve të një numri të madh të të ashtuquajturave agjensi kombëtare me kompetenca të posaçme, por që në fakt nuk përbëjnë gjë tjetër veç ministrive paralele e, rrjedhimisht, dyfishojnë vetëm burokracinë. Sistemi i taksave e tatimeve deri tashti ka qenë i pazbërthyeshëm; duheshin shlyer afro 80 taksa e tatime, gjë që

në fund të vitit 1999 solli si rezultat që dy të tretat e të gjitha ndërmarrjeve të shpallnin humbjen apo një fitim të barabartë me zero. Qysh më 1 janar 2000 ka hyrë në fuqi një sistem i reformuar taksash, i cili duhet të thjeshtëzojë urdhëresat e taksave, të nxisë zhvillimin e ekonomisë dhe të sigurojë një përllogaritje të ndershme të taksave.

Mirëpo, siç është shprehur edhe Presidenti Konstandinesku, para së gjithash lind nevoja e "ndryshimit të mentaliteteve". Në Rumani ekziston ende një mosbesim i madh ndaj ekonomisë së tregut, njerëzit në fund të fundit duan t'i ruajnë ndërmarrjet shtetërore, e konsiderojnë shtetin si një mbrojtës që u garanton vendet e punës dhe mbajnë një qëndrim mosbesues ndaj politikanëve, që shprehen në favor të reformave.

Prandaj nuk është për t'u çuditur që në pranverën e vitit 2000 Kryeministri Isaresku theksonte se: "Tashti për tashti Rumania nuk ka një ekonomi tregu funksionale, por një surrogat ekonomie tregu me shumë funksione të gabuara." Mirëpo ekonomia moderne parakupton tregje të integruara, të cilat nuk mund të funksionojnë pa institucione dhe ndërlidhje. "Ne nuk kemi as institucione dhe as ndërlidhje, por në vend të tyre ligje të shumta e të harbuara."

Në Rumani pushtetarëve, tekembramja, u duhet të përballen edhe me dy probleme të tjera, të cilat, ç'është e vërteta, qëndrojnë jashtë lëmenjve të reformave të mirëfillta politike e ekonomike. Fjala është për pozitën që zënë romët (ciganët endacakë) në vend dhe zgjidhjen e çështjes, se çfarë duhet bërë me numrin e madh të fëmijëve bredharakë e pa prindër, të cilët, duke lypur e vjedhur, si edhe të organizuar në banda kriminale, përbëjnë një problem të rëndësisë parësore në rrafshin social e të politikës së sigurisë, kryesisht në kryeqytet, dmth në Bukuresht. Sipas regjistrimit të fundit të popullatës, romët përbëjnë 1,8 për qind të 22,8 milionë banorëve të Rumanisë, dmth, përllogaritur në vija të trasha, plot 450'000. Megjithatë, askush nuk e quan korrekte këtë shifër.

Njohësit e rrethanave të Rumanisë dhe kryesisht të rretheve bujqësore, nisen nga një shifër e përgjithshme që vërtitet midis 1,8 dhe 2,5 milionë romëve. Në një rast të tillë numri i tyre do të kapërcente atë të hungarezëve (zyrtarisht plot 1,62 milionë) dhe do të përbënte pakicën më të fuqishme në Rumani. Vetëkuptohet që mbi bazën e këtyre zhvillimeve zëdhënësit e tyre po u kundërvihen gjithnjë e më me vendosmëri diskriminimeve të vazhdueshme kryesisht në komunat bujqësore dhe po kërkojnë vënien në pozita të barabarta qytetare me popullatën shumicë, si edhe mbrojtjen nga ana e institucioneve zyrtare. Mirëpo, edhe sikur institucionet zyrtare të ishin gjithkund të gatshme për t'i trajtuar romët si qytetarë me të drejta të barabarta, do të ishte prapëseprapë e nevojshme që vetë popullata të kapërcente druajtjet dhe ngurrimet tejet të lashta kundrejt "arixhinjve".

Udhëheqja e Rumanisë dhe Presidenti Konstandinesku kanë arritur, mbas grindjesh dhjetëvjeçare etniko-politike, një pajtim me pakicën hungareze mbi bazën e një vetadministrimi lokal. Ky pajtim u vulos solemnisht më 1998 gjatë një vizite shtetërore në Budapest. (Një vërejtje anësore mbi temën e pakicave: pakica gjermane e saksëve të Transilvanisë dhe e shvabëve të Banatit, dikur më e fuqishmja në juglindje, e cila para fillimit të Luftës së Dytë Botërore numëronte ende 800'000 vetë dhe gjatë periudhës së sundimit komunist akoma 400'000, është rrudhur tashma në 70'000.)

Pavarësisht nga problemet e ndërlikuara etnike, politike e sociale Presidenti Konstandinesku dhe qeveria e qendrës së djathtë janë futur në qindvjeçarin e ri jo pa shpresa. Mbas goditjeve prapësuese të viteve 1997/98 dhe stanjacionit më 1999, pritet që viti 2000 të mbyllet me një bilanc tregtar të drejtpeshuar, një rritje ekonomike prej 1,3 për qind të prodhimit të përgjithshëm kombëtar (më 1999 ishte ende -4%) dhe me një pakësim të inflacionit nga 27 për qind në 12,5 për qind. Qeveria shpreson gjithashtu të përfitojë nga hovi koniuktural në Bashkimin Evropian, duke qenë se kuota e eksportit prej 66 për qind dëshmon për një ndërthurrje tregtare tejet të fuqishme me BE-në.

Politika e kursimeve dhe kufizimeve ekonomike (Austerity-Politik ?), e ndjekur prej qeverisë, ka kërkuar sidoqoftë nga popullata flijime të mëdha. Shkurtimet e ndërmarra detyrimisht nga qeveria në sektorët social, kanë patur për pasojë uljen e standardit të jetesës dhe krijimin e gjendjeve të acaruara sociale, të cilat janë shndërruar në mënyrë të përsëritur në demonstrata dhe greva. Në Rumani është krijuar një shoqëri dy klasash; në njërën anë qëndron masa e madhe e atyre që jetojnë në kufijtë e minimumit jetësor, ndërsa në anën tjetër një shtresë e hollë pasanikësh të rinj, të cilët kanë grumbulluar pasuri të mëdha në sektorët ekonomik ende shtetëror nëpërmjet korrupsionit dhe ndërthurrjeve me politikën. Ndërkohë që këta funksionarë ekonomik sigurojnë paga mujore që arrijnë deri në 70 milionë lei (rreth 12'000 marka gjermane (DM) - shumë kjo e jashtëzakonshme për kushtet e Rumanisë), minatorët e papunë të luginës së Shilit lyejnë trupat e tyre me benzinë dhe përpiqen të djegin vetveten, për të tërhequr vëmendjen në drejtim të gjendjes së tyre të mjeruar.

Qeveria në fakt duhet të mbajë një drejtpeshim të vështirë ndërmjet manovrimit me borxhet e mëdha të jashtme (në fund të 1999: 6,2 miliarë dollarë amerikan), reformave strukturore, kushteve të vëna prej Fondit Monetar Ndërkombëtar për politikën buxhetore dhe masave të politikës së kursimeve dhe kufizimeve ekonomike që rrjedhin prej tyre. Fundi i vitit 2000 do të tregojë si është vlerësuar kjo nga popullata. Atëhere do të zhvillohen si zgjedhjet presidenciale, ashtu edhe ato parlamentare; rikthimi në pushtet i Jon Ilieskut e i partive nacionaliste dhe atyre të majta që e mbështesin atë, gjë që nuk përjashtohet nga disa vëzhgues, do të shoqërohet së paku me vonimin e përpjekjeve të udhëheqjes së tanishme për përfshirjen e Rumanisë në strukturat e Perëndimit.

Bullgaria e zellshme - midis shpresës për anëtarësim në Bashkimin Evropian dhe nostalgjisë

_

Sofja është sot një qytet shumëngjyrësh e plot gjallëri. Kryeqyteti i Bullgarisë me elementet e tij arkitektonik të borgjezisë së madhe, të trashëguara nga shekulli XIX dhe XX, ka qenë i hijshëm dhe i këndshëm qysh më parë, madje edhe gjatë periudhës së komunizmit. Mirëpo sot, falë pranisë tregtare ndërkombëtare dhe mbajtjes së një qëndrimi tejet të hapur ndaj shoqërisë perëndimore të konsumit, ky qytet ka hedhur edhe një hap tjetër përpara në këtë drejtim. Përgjatë rrugëve kryesore kanë hapur filialet e tyre firmat më emërmëdha të Francës, Italisë e Gjermanisë. Sikur vitrinat të ishin tregues i fuqisë blerëse, do të mund të mendohej se gratë e Sofjes veshin çdo natë fustane të gjata elegante dhe parapelqejnë këpucët, që në të vërtetë nuk i shkojnë për shtat gjendjes së trotuarëve të qytetit të tyre. Por, po të kundrojmë më me vëmendje, do të vëmë re se dyqanet janë fare bosh e shitësit dhe shitëset çuditen kur afrohet ndonjë klient i rrallë, i cili në fund të fundit del të jetë i huaj ose i lidhur me mafian vendase.

"Qeveria jonë gënjen dhe populli e di këtë gjë", na shpjegon gjatë bisedës një gazetar bullgar, i cili është i mendimit se të dhënat zyrtare mbi zhvillimin pozitiv të shoqërisë e mbi gjendjen sociale, i shërbejnë vetëm kujdesit për krijimin e imazhit kundrejt BE-së. Mirëpo, realish, vazhdon të mbizotërojë varfëria e madhe, një papunësi e jashtëzakonshme dhe ngecja në vend e ekonomisë, kryesisht në sektorin e bujqësisë.

Në fakt, nga njëra anë, duke qenë njëri prej shteteve kandidate të Evropës Juglindore për t'u lidhur më ngushtësisht me Bashkimin Evropian, Bullgaria është njëkohësisht vendi që ka përmbushur në masën më të madhe kushtet paraprake sociale e ekonomike të kërkuara nga Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMI). Mirëpo, bash kjo rrethanë e ka detyruar këtë popull, i cili qysh nga "përmbysja" ka përjetuar krizat më të këqija ekonomike të historisë së tij të kohëve të fundit, të bëjë flijime të jashtëzakonshme. Nga një studim i Institutit të Krahasimeve Ekonomike Ndërkombëtare të Vjenës mbi zhvillimet e pritshme në vendet e tranzicionit gjatë periudhës 1998/99, në rastin e Bullgarisë nuk spikat ndonjë gjasë e atypëratyshme për përmirësime.

Viti 1999, si pasojë e bombardimeve të rrugëve të transportit dhe kryesisht të urave të Danubit nga Nato-ja, solli një keqësim të mëtejshëm të gjendjes. Për këtë arsye u ndërprenë në radhë të parë eksportet e mallrave në drejtim të Jugosllavisë së cunguar dhe në një masë më të vogël edhe në drejtim të vendeve të BE-së. Gjatë vitit 1999 u shënua një pakësim i eksporteve në masën 15 për qind, gjë që solli, nga ana tjetër, një rritje të ndjeshme të deficitit në bilancin tregtar dhe të pagesave. Kështu lindi nevoja e mbylljes së disa fabrikave dhe edhe turizmi, veçanërisht ai në Danub, por edhe ai në Detin e Zi, u cënua rëndë. Po ashtu si vendet e tjera, që ishin fqinjë të vatrave të krizës, edhe Qeveria Bullgare kërkon kompensime për qëndrimin e saj properëndimor në këtë konflikt. Kostoja përkatëse përllogaritet nga 800 milionë deri në një miliardë dollarë.

Mirëpo, nëpërmjet luftës së Kosovës, Bullgaria - po ashtu si Rumania - i kanë siguruar vetes përparësi në rrafshin politik. Bullgaria - si edhe Rumania - i dhanë Nato-s të drejtën e fluturimeve mbi territoret e tyre dhe nuk pranuan të përkrahin Rusinë e prandaj Perëndimi ka detyrime morale dhe financiare ndaj tyre. Në këtë sfond, në rrafshin moralo-politik pala bullgare po parashtron kërkesa që pranimi në Nato dhe në Bashkimin Evropian të njëmendësohet më shpejt sesa parashikimet e deritanishme. Kjo përbën, padyshim, në radhë të parë një çështje, që paraqet interes jetësor për Qeverinë e tanishme të "Bashkimit të Forcave Demokratike" (SDS), ngaqë popullariteti i kryeministri Ivan Kostov po pëson aktualisht humbje të ndjeshme. Në këtë rast faji nuk rëndon vetëm mbi problemet ekonomike dhe akuzat për korrupsion, të ngritura kundër të gjitha qeverive qysh nga viti 1992 - dhe tashti edhe kundër asaj që ushtron funksionet e saj prej vitit 1997 -, por sërish edhe mbi ngjarjet e luftës.

Ndërhyrja e Nato-s i ka ashpërsuar më tej pikëpamjet alternative politike; në radhët e socialistëve (BSP - komunistët e dikurshëm) edhe sot e kësaj dite ekzistojnë përfytyrime nostalgjike për një bashkëpunim më të ngushtë me Rusinë, ndërsa, nga ana tjetër, nuk mungon përmallimi jo më pak tradicional për një lidhje të ngushtë me Perëndimin evropian. Bullgaria, e cila gjatë periudhës komuniste është quajtur vasali më besnik i Bashkimit Sovjetik - "Kur në Moskë bie epidemia e gripit, Todor Zhivkovi zë shtratin", bëhej shaka asokohe në Sofje -, kishte lejuar megjithatë edhe gjatë asaj periudhe shkolla gjermane dhe franceze në Sofje e madje edhe në qytetet provinciale. Shkrimtarët dhe artistët përfitonin nga miqësia me BRSS e, rrjedhimisht, mundësitë e mëdha të shitjes së veprave të tyre, por edhe bursistët bullgarë të institucioneve europerëndimore mund të luanin një farë roli në jetën kulturore bullgare. Artet figurative kanë gëzuar një hapësirë të pranueshme edhe gjatë periudhës së komunizmit. Sot, afro dhjetë vjet mbas përmbysjes, jetës kulturore nuk i dëgjohet zëri. Shteti bullgar nuk ka para për kulturën dhe aq më pak konsumatorët potencial.

Midis kushteve që iu janë vënë kandidatëve të BE-së - si edhe vendeve pritëse në kuadrin e Paktit të Qëndrueshmërisë (Stabilitetit) - bën pjesë, veç të tjerash, edhe bashkëpunimi më i ngushtë rajonal për çështjet e politikës së sigurimit. Në këtë vazhdë Bullgaria ka përfunduar një pakt sigurimi me Rumaninë, është marrë vesh në një farë mase me Turqinë përsa i përket çështjes së brishtë të pakicës turke në Bullgari dhe ka ndërmarrë disa përçapje për të rënë në ujdi me Republikën e pavarur të Maqedonisë. Gjithsesi kjo është bërë vetëm në mënyrë sipërfaqësore, mbasi njohja e hamendësuar e kësaj Republike nuk përfshin njëkohësisht njohjen e plotë të gjuhës maqedonase e të kombit maqedonas. Në rrafsh qeveritar është kumtuar vetëm respektimi i rrethanës që kushtetuta e Republikës së Maqedonisë shpall si gjuhë zyrtare maqedonishten - dhe jo bullgarishten që ka afëri të madhe me te. Përveç kësaj, në një kumtesë të shkurtit 1999, të dyja palët sigurojnë se nuk do të ngrenë kurrfarë pretendimesh territoriale kundrejt njëra-tjetrës. Sot pakica maqedonase në Bullgari nuk ndodhet më nën trysninë politike të Sofjes.

Probleme të një natyre krejtësisht tjetër shtrohen nga një pakicë tjetër - romët (ciganët). Në këtë grup të popullatës papunësia është tej mase më e lartë se mesatarja bullgare. Për këtë, si gjithkund, bashkëpërgjegjës janë pjesërisht

zakonet e ngulitura të romëve, por në radhë të parë qëndrimi përgjithësisht mospranues i shumicës bullgare. Në fakt edhe këtu kemi të bëjmë me një problem, virulenca e të cilit spikat në shumicën e vendeve të tjera të kësaj hapësire.

Në Bullgari janë ndërmarrë një sërë nismash me bazë ndërkombëtare, por edhe kombëtare, për të çrrënjosur konceptet klishe të "vjedhësve dhe cubave" e të "ciganëve dembelë". Ky është një proces, i cili, sigurisht, nuk mund të japë menjëherë frytet e tij dhe kjo ndodh, kryesisht, mbasi varfëria dramatike e romëve - me përjashtim të disa njerëzve me xhep të ngrohtë nga radhët e tyre - nuk u krijon atyre asnjë mundësi ekzistence "legale" në një Bullgari, e cila në fund të fundit ndodhet vetë nën trysninë e problemeve të saj ekonomike. Ndërkohë janë ndërmarrë një sërë nismash për forcimin e pavarësisë kulturore të romëve dhe problemi në fjalë është trajtuar edhe në disa studime e botime sociale mbi këtë temë. Përveç këtyre, nëpërmjet shkollave ditore, po bëhen përpjekje për të pakësuar deficitin kulturor të këtij grupi të popullatës dhe për të përkrahur integrimin e tyre. Sidoqoftë projektet e këtij lloji përbëjnë ende raste të rralla.

Në periudhën parakomuniste, por edhe gjatë kohës së qeverisjes komuniste, bullgarët kanë gëzuar namin e "kopshtarëve të Ballkanit". Megjithë kolektivizimin komunist të bujqësisë dhe dobësitë që ishin pjesë e këtij sistemi, disa ferma shtetërore prodhonin mallra të mira. Automjetet e mëdha frigoriferike me mbishkrimin "Bulgaria" kanë qenë pjesë përbërëse e tablosë së përditshme të autostradave evropiane deri në periudhën e "përmbysjes". Ato transportonin kryesisht domate bullgare me një shije tejet pikante, të cilat kishin zënë një vend të qëndrueshëm në tregjet perëndimore - po ashtu si edhe ato të konkurentëve të tyre shqiptarë. Sot këto tregje furnizohen kryesisht me fruta e perime të prodhuesve nga Bashkimi Evropian, dmth nga Italia, Portugalia e Spanja. Bujqësia bullgare nuk është më në gjendje të konkurojë, fshatarët dhe bujqit fitojnë aq pak, saqë atyre u mungon çdo lloj joshjeje; nga ana tjetër atyre u mungon edhe përkrahja. Në të njëjtën kohë, deri sot në Bullgari nuk janë bërë pothuajse fare investime të huaja. Qeveria e mëparshme, po ashtu si e tanishmja, i ka përmbushur në mënyrë tepër të ngadalshme kërkesat për ligjet e nevojshme përkatëse, ndërsa privatizimi po zhvillohet edhe këtu, si në vendet e tjera të varfra, me mefshtësi dhe jo rrallë në "rrugë të shtrembëra".

Në analizat kritike mbi proceset e zhvillimeve të brendshme bullgare, për shembull në të përkohshmen në gjuhën gjermane "Fletorja Ekonomike Bullgare/Bashkëbisedim me Evropën Juglindore", është theksuar në mënyrë të përsëritur se korrupsioni i përhapur gjerësisht lidhet, veç të tjerash, me rrogat e këqija të nëpunësve. Ai shpjegohet, po ashtu, me mëritë e ministrive dhe institucioneve zyrtare ndaj "sipërmarrësve privat". Takimet me ta shquhen nga mungesa e besimit, kundrejt tyre si "kapitalist" - sipas koncepteve të trashëguara nga epoka komuniste - mbahet qëndrim refuzues dhe, gjithsesi, përkrahen pa ndonjë dëshirë të posaçme. Ky qëndrim i përgjithshëm ka gjetur shprehje edhe në ligjet dhe rregullat ligjore mbi taksat dhe tatimet për ndërmarrjet e vogla private. Kritikët pohojnë se, po të përmbusheshin me të vërtetë të gjitha detyrimet e pagesave, asnjë ndërmarrje nuk do të ishte në gjendje të mbijetonte. Mirëpo duke iu shmangur këtyre detyrimeve, këto ndërmarrje jo vetëm japin ndihmesën e tyre për krijimin e deficitit financiar të shtetit, por, ngaqë nuk i regjistrojnë të gjithë bashkëpuntorët e tyre, të cilët shënohen mandej në statistikë si të "papunë", ndikojnë tërthorazi edhe në përpilimin e një statistike të falsifikuar. Një numër relativisht i madh njerëzish ka dy punë, por nuk paguan taksat përkatëse. Po ashtu, krahas skamjes së madhe, ka edhe shumë njerëz, që i përmbushin nevojat e tyre për artikuj ushqimorë bazë nëpërmjet ekonomive të vogla bujqësore vetiake apo të të tjerëve. Në këtë mënyrë mjegullohet tabloja e përgjithshme disi më pozitive e situatës bullgare.

Nuk është për t'u çuditur që Bullgaria - po ashtu si Rumania - në pozicionin e saj të tanishëm të partnerit në bashkëbisedimet për anëtarësimin në BE, ushqen shpresa të mëdha për një anëtarësim të përshpejtuar. Fondi Monetar Ndërkombëtar e ka lavdëruar Bullgarinë për pagesat e saj të rregullta të kredive. Bullgaria është e mendimit se i ka njëmendësuar në një masë të madhe kushtet paraprake të caktuara për pranimin në BE, të paktën në krahasim me vendet e tjera kandidate për anëtarësim. Këto shpresa përbëjnë një detyrim për Bashkimin Evropian dhe Paktin e Qëndrueshmërisë (Stabilitetit), duke qenë se ato ushqehen nga qëndrimi i vetë këtyre institucioneve evropiane. Edhe në këtë vështrim vlen ajo që kemi theksuar në mënyrë të përsëritur në këtë libër, dmth se lulëzimin e ekonomisë nuk mund t'a sjellin vetëm projektet e mëdha në lëmin e infrastrukturës, sado të rëndësishme qofshin ato. Sukseset pozitive të projekteve të tilla janë afatgjata. Mirëpo në këto shtete njerëzit kanë nevojë të shohin përparime të shpejta, atyre u nevojiten perspektiva të kapshme.

VËSHTRIM PERSPEKTIV: QËNDRUESHMËRI - PREMTIM APO ILUZION?

Vendet nga trevat e Jugosllavisë së dikurshme, para së gjithash Bosnje-Hercegovina dhe Kosova, ndodhen ende shumë larg një qëndrueshmërie "të vetëmbajtur" (që mbahet në këmbë me forcat e veta). Pra, trupat ndërkombëtarë nën udhëheqjen e Nato-s, do të duhet të qëndrojnë atje edhe për një periudhë kohe të paparashikueshme.

Madje nuk përjashtohet as nevoja e zgjerimit të mëtejshëm të zonës së dislokimit të tyre, në qoftë se në Republikën Federale të Jugosllavisë do të shpërthente një konflikt i armatosur midis Serbisë dhe Malit të Zi ose në rast se acarimet midis regjimit të Millosheviçit dhe opozitës serbe do të shpinin në situata të përafërta me luftën civile. Nato-ja ka ndërhyrë tashma dy herë në përleshje të armatosura brenda Jugosllavisë së dikurshme. Nato-ja nuk mund të pranojë e të qëndrojë dorëjashtë një pështjellimi të atyshëm të përgjithshëm, thjesht duke patur parasysh pozicionin qendror të Serbisë në Ballkan e pasojat e tij të mundshme mbi shtetet fqinje.

Në zonën e Jugosllavisë së dikurshme ekzistojnë tri çështje, të cilat duhet të vihen

në qendër të vëmendjes, në rast se kërkohet që Pakti i Qëndrueshmërisë (Stabilitetit) të japë ndihmesën e tij për konsolidimin e Ballkanit. Njëra prej tyre lidhet me Bosnje-Hercegovinën: a do të ngulet këmbë në njëmendësimin konsekuent të Marrëveshjes së Dejtonit apo, për të ruajtur njësinë e vendit, duhet bërë rishqyrtimi i saj? E dyta ka të bëjë me Kosovën; pa arritjen e një marrëveshjeje brenda vetë bashkësisë ndërkombëtare dhe me shqiptarët e Kosovës mbi statusin e ardhshëm të kësaj province të banuar nga shumica shqiptare, është e pamundur që atje të krijohen struktura të qëndrueshme politike e administrative. Dhe e treta, por jo e fundit; pa përfshirjen e Serbisë dhe Malit të Zi në Paktin e Qëndrueshmërisë (Stabilitetit) nuk mund të arrihet konsolidimi politik e ekonomik i Ballkanit. Mirëpo kjo nuk mund të ngjasë, sa kohë që Sllobodan Millosheviçi të gëzojë pushtet të pakushtëzuar në Jugosllavinë e cunguar. Pra, fati i regjimit të Millosheviçit nuk është vetëm një çështje e politikës së brendshme serbe, por edhe e politikës ndërkombëtare.

Përsa i takon Kosovës, do të jetë e nevojshme të shoshitet sërish e famshmja rezolutë 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Kjo rezolutë parasheh, nga njëra anë, autonominë e zgjeruar të Kosovës brenda Republikës Federale të Jugosllavisë, duke krijuar, nga ana tjetër, rrethana, të cilat të çojnë de fakto në drejtim të mëvetësisë shtetërore të kësaj province. Kjo, sipas mendimit të një vëzhguesi britanik, është njëlloj sikur të kërkohet nga një vajzë e re të mbesë e virgjër, por duke shpresuar njëkohësisht se ajo do të presë me interesim gëzimet e të qenurit nënë.

Në këndvështrimin afatgjatë, pavarësisht nga rregullimi i çështjes së Kosovës, "çështja shqiptare" nuk mund të lihet thjesht e hapur në zemër të Ballkanit. Në Maqedoni duhet që, përmes një pajtimi midis "popullit shtetbërës" sllavo-maqedonas dhe etnisë së fuqishme shqiptare në perëndim të vendit, të arrihet forcimi i shtetit të përbashkët. Në Shqipëri komisioneve ndërkombëtare do t'u duhet të përkujdesen për një rend të brendshëm të qëndrueshëm. Përndryshe dy grupimet më të fuqishme politike të vendit, ai "qytetar" dhe ai "socialist", do të luftojnë me të gjitha mjetet njëri-tjetrin, ashtu siç përlesheshin dikur klanet më të fuqishme për sundimin e vendit. Vetëm zgjedhjet parlamentare nuk përbëjnë rrugëdalje, mbasi partia fituese do të shihte rishtas në suksesin e saj një ligjësim të gllabërimit të pushtetit në të gjithë lëmenjtë e shtetit.

Së fundi, Pakti i Qëndrueshmërisë (Stabilitetit) nuk do t'i përmbushë detyrat dhe nuk do të ushtrojë ndikimin e tij, në qoftë se nuk do të ketë parasysh në radhë të parë domosdoshmërinë për të nxitur e për t'i dhënë hov prodhimit në vendet e prekura. Vendet e punës duhen krijuar para së gjithash në ekonominë e "vogël". Sepse kështu u krijohen edhe njerëzve perspektiva individuale.

Rëndësi jetike për arritjen e sukseseve kanë, më së fundi, edhe marrëdhëniet midis vendeve marrëse e atyre dhuruese. Bashkësia ndërkombëtare e ka humbur tashma në një masë të madhe paradhënien e shpresave dhe mirëbesimit në popullatën e vendeve të qeverisura në të kaluarën nga komunistët. Prandaj, të gjitha përpjekjet e Paktit të Qëndrueshmërisë (Stabilitetit) - të kësaj "ideje të shkëlqyeshme" - nuk do të jenë të frytdhënëse pa krijuar rishtas një mirëbesim të ri.

E përktheu: Pjetër RODIQI

Basel (Zvicër) 2003 / E përktheu: **Pjetër RODIQI**

"Pakti i Qëndrueshmërisë (Stabilitetit) për Evropën Juglindore", i shpallur mbi bazën e "planit Joshka Fisher", duhet të përkujdeset për vendosjen e një paqeje të qëndrueshme dhe të demokracisë në vendet e Ballkanit, madje në gjithë Evropën.

Përmes këtij shkrimi Libali dhe fon Koli nxjerrin në pah synimet e mirëfillta dhe metodat mbizotëruese të kësaj nisme ndërkombëtare, si edhe përcaktojnë kushtet paraprake faktike dhe masat që duhen marrë për njëmendësimin (realizimin) e kësaj marrëveshje.

DY FJALË RRETH AUTORËVE:

Volfgang Libal (Wolfgang Libal) ka qenë për shumë vite me radhë drejtuesi **i** DPA-së (Agjensisë Gjermane të Lajmeve) në Vjenë dhe korrespondent i kësaj agjensie në Beograd. Ai trajton rregullisht qysh prej vitit 1978 për masmediat e hapësirës gjermanofolëse temën e Ballkanit. Midis të tjerash është edhe autor i veprave "Fundi i Jugosllavisë" dhe "Serbët".

Kristinë fon Kol (Christine von Kohl) gjatë periudhës 1968-1985 ka qenë korrespondente e organeve "Die Presse" ("Shtypi", gazetë ditore austriake) dhe "NZZ" ("Gazeta e Re e Cyrihut", gazetë ditore zvicerane) në Jugosllavi. Qysh prej vitit 1999 është botuese e gazetës "Ballkani Dialogu evropianojuglindor".

Kostenlose Homepage erstellen bei Beepworld

Verantwortlich für den Inhalt dieser Seite ist ausschließlich der Autor dieser Homepage, kontaktierbar über dieses Formular!